



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 08/24


Rahovec, 14.8.2024

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e **tetë (8)**, e cila do të mbahet më:
23 gusht 2024 (e premte), me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), Shoqatës “Zona e Pashtrikut”;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien e pronës me qira 1-15 vjet P-05058-0 ZK – Rahovec;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-05058-0 ZK Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien e pronës me qira 1-40 vjet P-00772-10 ZK – Xërxë;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P – 00772-10 ZK- Xërxë;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, P – 02680-1 ZK- Rahovec;
9. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2023;
10. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023;
11. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale për vitin 2023;
12. Shqyrtimi i Raportit 6-mujor të punës së Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.

KRYESUESI I KUVENDIT

Arbër Zenuni





PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **25.07.2024**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 25.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkyetar **z. Fatmir Iska**, i nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-i medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **shtatë** të vitit 2024, së bashku me kryetarin kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale Nr. 00889-0, ZK- Çifllak, në sipërfaqe prej 11765m²;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-00889-0 ZK, Çifllak, në sipërfaqe prej 11765m²;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale Nr. 00889-0, ZK- Çifllak, në sipërfaqe prej 860.00 m²;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00889-0 ZK, Çifllak, në sipërfaqe prej 860.00 m²;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për faljen e borxhit të papaguar për taksën komunale, respektivisht - qiranë e shfrytëzimit të hapësirës publike;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, P-00041-1, ZK-Drenoc;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik ndërtesë P-00644-0, ZK-Rahovec;
10. Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar – qershor 2024;
11. Shqyrtimi i Informatës të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
12. Shqyrtimi i Informatës të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
13. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Arsime rreth përfundimit të vitit mësimor 2023/2024;
14. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit të Punës së Zyrës së Prokurimit, janar-qershor 2024;
15. Shqyrtimi i Informatës mbi parcelat publike të dhëna në shfrytëzim nga Kuvendi Komunal!
16. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike në Komunën e Rahovecit;

Kryesuesi: Këto janë pikat e rendit të ditës të parapara për sot. E vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (22) votohet rendi i ditës i paraparë për mbledhje të shtatë të kuvendit komunal.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: A kemi ndonjë koment apo diskutim nga anëtarët e kuvendit rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimisht aprovet pika e parë e rendit të ditës.

2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, të nderuar të pranishëm. Grupi i interesit të “KF. Rahovecit”, vazhdimisht po parashtronë pyetje rreth gjendjes së punimeve të kompleksi sportiv të epopeja. Kur do të përfundojë dhe a do të jetë i gatshëm për zhvillimin e lojërave kampionale gjatë muajit gusht.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për ekzekutivin, kolegë asambleistë, monitorues dhe të gjithë që jeni këtu. I kam tri pyetje: E para, te projekti i sheshit qëndror. Drejtor, a ka projekt detal projekti i sheshit qëndror, apo ka vetëm ideor dhe paramasë?... Nëse ka, e bëj kërkesën publike dhe zyrtare për qasje në dokumente zyrtare për ta parë projektin detal të sheshit qëndror. E dyta, te kompleksi sportiv të Epopeja e UÇK-së, ka qenë një kompleks multifunksional për disa lloje të sporteve. Kompleksi është modifikuar vetëm në një fushë. A ka ndryshim të projektit prej atij fillestar? Ndryshimet a janë bërë përmes vlerësimit të një komisioni profesional, të cilët kanë vlerësuar që ndryshimet mund të bëhen, nëse krahasojmë edhe koston dhe modifikimet. E treta, ka mbi një muaj që i kam dërguar e-mail shefit të zyrës së prokurimit për qasje në dokumentet zyrtare për projektin e lumit “Rimnik”. Deri sot nuk kam marrë asnjë përgjigje deri sot. A është kërkesa e gabuar, a t’u ka drejtuar juve si kryetar komune për këtë kërkesë, ta lejoni, ose jo? Ku qëndron problemi? Besoj që është e drejtë për çdo qytetar që të ketë qasje në dokumente zyrtare, nuk është diçka e ndaluar. Nëse kërkesa është bërë gabim, së paku ta kemi një përgjigje: “Kërkesa juaj për qasje në këtë projekt është adresuar gabimisht”. Kam kërkuar një datë të caktuar, se kur më lejohej të shkoj ta shoh projektin, pse nuk ka ndodh deri sot?

Bejtullah Deliu: Faleminderit i nderuar kryesues! I nderuar kryetar, zëvendës, drejtorë, kolegë, media dhe të gjithë të pranishëm. Ka një kohë të gjatë që me drejtorin e arsimit kemi diskutuar rreth komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e ankesave për dhënien e mëdijve. Ende nuk ka ndonjë raport. Nëse ju kujtohet kryetar, ka pasur shumë shkelje të orëve dhe nuk ka qenë në rregull që keni thënë që brenda një jave formohet komisioni. Kanë kaluar 7-8 muaj dhe nuk ka asnjë lëvizje dhe asnjë informatë. Ka mësimdhënës që janë dëmtuar direkt financiarisht.

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, zyrtarë, media, përfaqësues të KFOR-it. Unë dëshiroj ta shtjelloj një çështje, ku kërkoj që të jenë më të përgjegjshme dy institucionet e komunës, kuvendi dhe kryetari i komunës. Në seancën e kaluar, pavarësisht debatit që e kemi pasur, ajo që nuk i ka hije kuvendit dhe që unë jam munduar ta ndaloj dhe përmirësoj për atë që kam qenë unë kryesuesi. Qasja e kryetarit, e dimë që ndonjëherë varet prej emocioneve dhe nervozës së tij. Ofendimi i anëtarëve të kuvendit mendoj që duhet të jetë pjesa ku kryesuesi duhet ta bëjë mbrojtjen e tyre. Duke filluar prej meje, por edhe me anëtarë tjerë të kuvendit, kryetari disa herë e ka potencuar që “ti fol palidhje”, “ti nuk din”, “ti naj herë ia qëllon”. Nuk besoj që kjo është gjuhë që duhet të përdoret brenda kuvendit që ne sado vota që i kemi, 200-300 vota që thotë kryetari, kjo nuk na bënë neve asgjë, përveç që kjo qasje e kryetarit neve na rritë. Kërkoj nga kryetari që të jetë më i qartë te kjo pjesë dhe t’i ndalojë afendimet ndaj anëtarëve të kuvendit. Përgjatë diskutimit që e ka pasur, kryesuesi me një moment tha që lëri këto “debate koti”. Nuk mund të arrish te një vlerësim kur një temë që trajtohet në kuvend komunal, t’i thuash “debat koti”. Kërkoj ta përmirësojë këtë qasje në kuvend. Githashtu, të falënderoj edhe ty edhe kryetarin për mundësinë e debatit që po e krijojmë bashkërisht, qoftë me minuta shtesë për ndonjë temë të caktuar. Një pyetje tjetër për kryetarin e komunës, te zgjatja e kontratave: E dimë që me ligj të prokurimit, zgjatja e kontratës që projekti të përfundojë është 3 vjet, a mund të ngjitet ky standard për Komunën e Rahovecit, ku edhe çështja e buxhetimit do të ishte më e lehtë dhe siguria për qytetarët më e madhe. Përkundër intensitetit që po punohet në shesh, qytetarët nuk kanë besim që mund të përfundojë brenda afatit ligjor, shkak i përvojës së kaluar që projektet nuk përfundojnë me kohë. Kjo do ta shtonte më shumë vlerën e komunës.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorët, kolegët, monitoruesit. I kam disa pyetje të lehta, kryesisht për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Rreth rrugës për dri, poshtë. Bujqësia lidhet shumë me atë pjesë dhe është e domosdoshme kur do të intervenoni në kanalizim dhe t'i sanoni disa defekte, si dhe do të ishte shumë mirë nëse përfundon edhe asfaltimi, sepse aty rrezikohen fëmijët dhe të rriturit. E dyta, te ndriçimi publik t'i bëni presion pak operatorit, sepse ka defekte në ndriçim dhe në kanalizim. Për kryetarin e kam një pyetje duke pasur parasysh që "Ismajl Kadare" është fitues i çmimit "Ukshin Hoti" dhe pasi që nuk është më në mesin tonë, a ka ndonjë hapësirë që një emër i ndonjë rruge apo ndonjë shesh, ta mban emrin e tij, nëse ekziston ndonjë mundësi kur bëhen riemërtimet e rrugëve.

Edona Kryeziu: Faleminderit kryesues! I nderuar Kryetar i Komunës Smajl Latifi, drejtorë të drejtorive, kolegë, monitorues. Kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, drejtor, para 2-3 seancave të rregullta, të kam kërkuar që t'i vizitosh nga afër rrugët e fshatit Xërxë dhe gjendjen e tyre. Rruga që të shpie te ambulanta është në gjendje të mjerueshme. Në rrugën "Lidhja e Lezhës" në çdo 20-30 metra pusetat janë të hapura, gjë që sjell shumë frikë për fëmijët dhe për kalimtarët e rastit. Rruga te udhëkryqi, saktësisht afër shkollës fillore, po ashtu është në gjendje të mjerueshme. Kërkoj nga ju që të merrni masa, që këto rrugë të kthehen në gjendje të kalueshme sa më shpejt që është e mundur.

Eqrem Spahiu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, kolegë asambleistë dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Kryetar, e kam një brengë që në fshatin Opterushë nuk po shkon diçka mirë në lidhje me punimet që po i bën KRU-Gjakova, ose nuk don që të zgjidhet problemi, ose nuk ka trysni të mjaftueshme nga ana e kuvendit dhe ekzekutivit. Në momentin kur po flasim, në Opterushë nuk kemi ujë të pijshëm. Nuk e di se çfarë marrëveshje keni me KRU-Gjakovën, por, ose trysni për punë të mirë, ose ta ndërpreni marrëveshjen.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Rezultatet preleminare të numrit të banorëve të komunës sonë, kanë dalë rreth 41.000, prej matjes së fundit që kanë qenë 56.208. Rënia është prej 26% dhe mendoj që është shumë rënie e madhe. E dimë që në Kosovë në "trend" është migrimi i jashtëm dhe kur e shqyrtojmë këtë temë të ndarë në komuna, e shohim që në disa komuna është më e theksuar. Komuna e Rahovecit ka rënie të madhe, përveç kësaj, Rahoveci ka pasojë shumë të mëdha në migrim të brendshëm. Studentat e Rahovecit në moment që përfundojnë studimet, mbesin në Prishtinë, ndërsa shumë pak prej tyre kthehen për të dhënë kontribut në Rahovec. A ndiheni përgjegjës dhe ku mendoni që është problemi që po ndodh kjo?

Kryetari: Faleminderit kryesues! Të nderuar drejtorë të drejtorive, nënkryetar, anëtarë të kuvendit të komunës, monitorues. Faleminderit për kontributin e diskutimeve në paraqitjen e shqetësimeve dhe kërkesave që natyrisht meritojnë përgjigje. Shprehi mirëseardhje për bashkatdhetarët dhe shpresojmë që gjatë kësaj periudhe, dëshira, vullneti dhe përpjekjet tona janë që ata të kenë shërbime më të mira. Kemi një sportel të veçantë për ta, që zakonisht e bëjmë çdo vit. Do të ketë edhe aktivitete dhe iniciativa shtesë, p.sh: Sot erdhi një shkresë për reklama nëpër qytet, nëse nuk gaboju është nga Ardit Sylka. Përgjigja ime ishte që po, për t'i dhënë më shumë shije në estetikë qytetit. Pyetjeve do t'i përgjigjen edhe drejtorët e drejtorive. Sa i përket kompleksit, përgjigjet Afrim Dina. Përparim Kraniqi i përgjigjet kërkesave për infrastrukturë. Avni Morina nuk është me ne, sepse sot e marton djalin. Albnor Mullabazi do të përgjigjet te pyetja e Burim Krasniqit, rreth sheshit qëndror. Te kërkesat në qasje në dokumente publike do të përgjigjem unë. Te Bejtullah Deliu, meqenëse nuk është drejtori i Arsimit, do të përgjigjem unë. Do të përpiqem ta jap një shpjegim për Defrim Kafexhiun rreth gjuhës dhe komunikimit në kuvend. Zakonisht, çdo herë kam reaguar kur të tjerët kanë vepruar me një gjuhë jo të arsyeshme. Te zgjatja e kontratave, do të përgjigjem unë. Te Sejfullah Sejfullahu do të përgjigjet Përparimi. Merisës do të përpiqem t'i jap përgjigje unë, aq sa di. Te kërkesa për qasje në dokumente publike, ne shquhemi si komunë për përgjigje të shpejtë. Adresa në këtë rast nuk ka qenë e saktë. Qasja për dokumente zyrtare bëhet përmes Blerta Gashi Nalli-it, që është zyrtarë për qasje në dokumente publike. Të inkurajoj ta bësh, sepse ne brenda shtatë ditës jemi të obliguar të japim përgjigje dhe zakonisht nuk e presim shtatëditëshin, por e bëjmë më herët. Komisioni për verifikimin e asaj që është materie e kontratës kolektive. Bejtullah, ne kemi vërejtur situata që ndonjë mësimdhënës, qoftë për ndonjë gabim teknik të avokatit që e ka përfaqësuar lëndën e tij, qoftë për ndonjë arsye tjetër, kanë bërë përsëritje. Pra, një here e ka realizuar të drejtën që i takon dhe pa të drejtë, e ka përsëritur atë. Natyrisht, ne kemi vlerësuar ta krijojmë një komisioni, i cili e verifikon listën

e vendimeve gjyqësore të listave për pagesë. E vërteta është që kontrata kolektive po zbatohet, por diku i kushtuar me pasoja të rënda financiare Komunave të Republikës së Kosovës. Sot, jemi në një situatë shumë sfiduese dhe deri më 30 qershor kemi paguar 1.6 milion € për kontratën kolektive. Është shqetësuese, sepse nëse e kemi një kontratë për një projekt, thesari nuk të pyet, t'i merr dhe komuna jonë për momentin është e bllokuar në qasje për pagesa. Anëtarët e komisionit me vendim janë: Egzon Thaqi, Valmir Gashi, Jeton Krasniqi. Ky komision ka prodhuar rezultate të dobishme në mbrojtje të buxhetit të komunës, sepse ekziston mundësia që në mungesë të këtij komisioni të dëmtohet buxhet i komunës. Te zgjatja e kontratave: E vërtetë është që dëshira e secilit autoritet kontraktues është që të zgjatet kontrata. Duhet ta pranojmë faktin që ka vonesa në zbatim të kontratave, sepse prej orës 10:00 deri në 16:00 nuk punohet dhe kjo ju ka shkakuar operatorëve telashe në organizimin e punës. Ka kontrata që kryhen shumë shpejt, bile edhe para afatit dhe ka prej tyre që vonohen më shumë se sa që mund të projektohen në fillim. Te gjuha e përdorur, që me fillim jam ngjendje t'i kërkoj ndjesë ose falje të gjithë atyre që e kanë ndjerë veten të lënduar në paraqitjet dhe pikëpamjetet e mia. Unë gjithmonë ia kam filluar pasi më kanë rënduar të parët, si institucion apo te kolegët e mi. Gjuhë fyese, përçarëse, përçmuese, nuk është mirë të kemi as në kuvend, as në realacionet brenda ekzekutivit. Te mënyra e reagimit dhe te temperamentit nuk mund të bëhem ndryshe, sepse i kam bërë 53 vjet. Nuk mund të rikthehem në moshën 18 vjeçare dhe të bëjë imitime. Karakteri formësohet në moshën e 18 vjeçare dhe një është e sigurtë, që jam në gjendje t'i menazhojë situatat më të rënda se sa këto këtu në kuvend. Incidentet kurrë nuk kanë qenë dhe nuk janë për të krijuar karrierë politike. E ftoj kryesuesin, kuvendin dhe ekzekutivin që t'i përbahen gjuhës sa më të arsyeshme. Rezultati preliminar i regjistrimit të popullsisë është ky. Unë kam qenë kryetar i komisionit komunal dhe aty janë edhe disa anëtarë, përfshirë edhe përfaqësuesin për pakica. Kemi tentuar që t'i shfrytëzojmë të gjitha hapësirat që mos të mbetet askush pa u regjistruar. Raportimi nuk ka ndodh te kryetari i komunës, por kemi marrë informata nga regjistruesit dhe kemi pasur komunikim të mirë edhe me Agjencionin e Statistikave. Sipas raportit preliminar janë 41.777 banorë. Raporti final pritet të del raporti përfundimtar dhe ky numër mund të shkojë deri në 42.100 - 42.300, sepse mund të ketë edhe diçka që ka mbetur e papërfshirë. Rënia e numrit të banorëve është shqetësues. Ka ulje të natalitetit, ka migrim të jashtëm dhe të brendshëm. Këto dukuri janë duke ndodhur në të gjitha komunat e Kosovës, qoftë edhe me migrim të brendshëm. Kuadrot nuk rrijnë këtu, sepse Prishtina është e madhe dhe pashmangshëm ka më shumë mundësi. Po përpiqemi ta afirmojmë një organizatë joqeveritare që është formuar në Prishtinë, unë kam qenë dy herë, me emrin "FARDI". Këta përpiqen ta dëshmojnë me anë të shumë aktiviteteve në bashkëpunim me komunës, që nuk e harrojnë origjinën e tyre. Kjo është vetëm një formë nga qindra forma të mundshme. Studentë për bursa janë 230 aplikues dhe të gjitha ankesat e bursistëve i kemi miratuar. Rreth 100.000€ po iu japim atyre që kanë nevojë për një bursë dhe gjithsej janë 195 bursa. Përprojekte të shumta jemi duke bërë dhe janë legjitime për parandalimin e migrimit të brendshëm. Sa i përket rënies së popullsisë, gati në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës ka rënie, diku 25%, diku 26%, kuptohet duke e bërë krahasimin me regjistrimin e fundit të vitit 2011. Ju njoftoj që ligjshmëria për listën rezervë për emërimin e rrugëve ka ardhur. Unë jam i interesuar dhe jam pro, për Ismail Kadarenë, nëse ka ide dhe pozicion dhe pse mos ta emërtojmë ndonjë hapësirë publike me këtë emër.

Afrim Dina: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar asambleistë. I pata dy pyetje, të dyjat lidhen me kompleksin sportiv. Unë jam në komunikim të vazhdueshëm me klubin e Rahovecit, të cilët aktualisht po i bëjnë stërvitjet për fillimin e sezonës. Kampionati vjeshtor për superligën fillon me 10 gusht, ndërsa për ligën e parë, me 18 gusht. Jemi duke punuar intensivisht në "Kompleksin Sportiv", duke i përmbushur obligimet tona që i kemi si komunë dhe pjesa tjetër për bari sintetik mbetet te federata. Në komunikimin e vazhdueshëm që e kam me federatën, ata e kanë bërë porosinë e barit sintetik dhe fundi i korrikut dhe eventualisht fillimi i gushtit, bari do të vjen në Rahovec. Aktualisht jemi duke i rregulluar zhvështoret, sot përfundon pllaka e dytë dhe menjëherë fillojmë me suvatim, si dhe gjithashtu është bërë porosia e dyerve dhe dritareve. "Kompleksi Sportiv" do të jetë funksional sipas projektit të paraparë, aktualisht është duke u bërë rregullimi i fushës së parë ndihmëse, sepse kompleksi i ka dy fusha të vogla ndihmëse. Shtegu i atletikës është shtruar me shavor dhe mbetet të shtrohet edhe me pjesën e asfaltit. Për 10 ditë përfundojnë punimet për zhvështore, në bazë të kompanisë që po i kryen punimet.

Burim Krasniqi: Drejtor, pyetje ishte kështu: A ka ndryshime në mes projektit fillestar mbi bazën e të cilit është kontraktuar dhe ekzekutimit të projektit?

Afrim Dina: Në fazën e parë të projektit të kompleksit sportiv, pikërisht kanë qenë dy fushat e vogla ndihmëse, me rrethojë te vetëm aty dyjat. Mirëpo, në fazën e dytë është bërë revidimi i projektit dhe me kërkes të federatës kanë kërkuar që zhveshtoret duhet të zmadhohen, si dhe është planifikuar që komplet kompleksi të rrethohet, në mënyrë që të ruhet bari për arsyë të shumta.

Burim Krasniqi: Drejtor, nuk po e kontestoj që qëllimi i modifikimit është për të mirë. Megjithatë ndryshimi ka procedurë. A ka pasur komision profesional, i cili e ka bërë revidimin e projektit? Ndryshimi a ka pasur kosto financiare? Përveç pjesës së minimi që e kemi diskutuar, pjesa e zhveshtoreve e ka pasur aneks kontratë për t'i përfunduar edhe zhveshtore?

Afrim Dina: Faleminderit Burim! Të gjitha këto kanë procedura! Pjesa e zhveshtoreve është pjesë e fazës së dytë të kompleksit. Të gjitha procedurat kanë përfunduar sipas rregulloreve që kërkohen.

Kryetari: Dua ta plotësoj Afrimin pak, që Burimi ta kuptojë deri në fundi kontekstin. Është një standart që quhet kolaudimi i pozicioneve, të cilat bëhen një bazë zë një situata që përshkruhet përmes një komisionit, përmes mbikëqyrësit, përmes menagjerit dhe në këtë rast në lojë është futur edhe Federata e Futbollit e Kosovës me kriteret e veta. Nëse nuk bëhen këo kolaudime në këtë rast, atëherë, je subjekt i njësisë për hetimin e krimeve të rënda. Gjithçka është me procedurë dhe shpresoj që nuk kemi gabime teknike.

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kolegë drejtorë, asambleistë dhe pjesëmarrës tjerë. Sa i përket pyetjes për projektin e sheshit qëndror, punimet në shesh po vazhdojmë dhe për momentin jemi duke punuar në unazën e sheshit e cila do t'i lidh 4 rrugë. Te pjesa e stadiumit i kemi ndalë punimet për shkak të fuksit të mërgimtarëve, po ashtu edhe bjektet, veda dhe hardhia janë larguar, të njëjtat janë kthyer në parkingje, deri në funksionalizimin e parkingut nëntokësor brenda sheshit. Sheshi qëndror, përveç projektit ideor ka edhe projektin kryesor, sepse nuk jam ndoshta aq i guximshëm që të punoj në projektin më të madh urban të Komunës së Rahovecit, pa një projekt. Gjatë rrugës ky projekt do të ketë edhe plotësime, e kemi kompaninë projektuese. Projekti i sheshit qëndror ka projekt kryesor, gjendet në urbanizëm dhe të ftoj pas seancës në zyrë ose të kërkoni për qasje zyrtare.

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë kuvendarët e pranishëm, të nderuar përfaqësues të LMT-së. Sefa e bëri pyetjen rreth rrugës kah drini! Po Sefë, aty kemi punuar instalime nëntokësore, gypin e ujit dhe kanalizimit. Gjendja nuk është e mirë, për shkak se duhet të finalizohet me asfaltim dhe e kemi lutur kompaninë që të asfaltohet sivjet, sepse e ka gjatësinë 1400m. Përveç kësaj, në Krushë të Madhe është edhe një segment që do të bëhet një rrugë çasje të bizneseve dhe një kolektor. Sa i përket ndiçimit publik dhe riparimit nga KRU Gjakova, në mëngjes e kemi kontaktuar Ismet Berishën, që është menazher i njësisë së KRU Gjakovës për regionin e Prizrenit dhe për çështjen e ujit të pijshëm e menazhon edhe Krushën e Madhe, si dhe do ta bie pjesën teknike që duhet të ndërhyjë në çështjen e kanalizimit. Në ndriçim publik nuk kemi probleme. Problemi kemi me operatorë kabllorë që janë privatë. E kemi dërguar një kërkesë në KEDS, sepse gjatë punës që bëjnë i këpusin edhe telat e ndriçimit publik. Në Krushë të Madhe i kemi zënë me fakte. Edona Kryeziu pyeti për rrugën në Xërxë: Po, është e vërtetë ajo që thotë Edona, gjendjen jo të mirë të rrugëve e ka shkaktuar KRU Gjakova, gjatë ndërhyrjeve në rrjet të ujësjellësit. Ne i kemi angazhuar inspektorët dhe nëse nuk përgjigjen do të marrin dënime. Te riparimi i rrethrotullimit, ajo është rrugë rajonale dhe komuna nuk e ka në kompetencë riparimin. Kjo kërkesë është adresuar përmes policisë dhe përmes inspektoratit tonë, sepse i kemi dy probleme serioze: Në rrugën rajonale Rahovec – Krushë e Madhe dhe në rrugën rajonale në udhëkryqin në Xërxë. Sa i përket ujit të pijshëm në Opterushë: Ne e kemi dërguar kompaninë KRU Gjakova, ata kanë dalur në vend të ngjarjes dhe kanë thënë që janë dy ventilë që janë prekur nga pjesa e Opterushës që është e prekur me pengesa për furnizim të rregullt të ujit të pijshëm. E kemi marrë një konfirmim zyrtar që ata ventilë do të mbyllen dhe do ta shohim situatën tutje. Ne jemi në komunikim të shpeshtë me zyrtarët e KRU Gjakovës.

Vlora Vuçiterna: Përshëndetje për të gjithë! Unë e kam një pyetje të shkurtë për kryetarit. Para disa seancave kur e kam ngritë shqetësimin në lidhje me mbylljen e pediatriisë pas orës 14:00 dhe marrjen e shërbimeve në po të njëjtin

vend fëmijë dhe të rritur. Keni premtuar që nëse me të vërtetë është gjendja e tillë, gjë që është, keni me ndërmarrë ndryshime. A keni ndërmarrë diçka, apo mbetet si premtim?

Leonard Moria: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, asambleistët, qytetarët. Megjithatë u përmend arsimit dhe bursat, e kam një pyetje: Në thirrjen për bursa, kriteri ka qenë që të jetë student në universitetin publik dhe nota mesatare 7.0. Ndërsa në disa email-a që i kam pranuar nga studentët e nivelit master, sepse nuk është specifikuar që duhet të jetë veç niveli bachelor, kanë ardhur dhe kanë aplikuar dhe dosja nuk u është pranuar. E dyta, a ka mundësi që vitit tjetër të ketë bursa për nivelin master, sepse edhe këta na bëjnë krenarë nesër kur të marrin tituj të ndryshëm.

Kryetari: Faleminderit kryesues! Kam premtuar që do të interesohem për këtë temë. Besoj që e kemi adresuar këtë çështje, Saranda e din më mirë. Unë menjëherë e kam thirrur menaxhmentin e QKMF-së. Sa i përket bursave, më tregoni si ta rrisim buxhetin e komunës, prej mbi 1 milion për subvencione, ta bëjmë 2 milionë dhe atëherë mund t'i subvencionojmë edhe të nivelit master, por edhe doktorët. Na kanë dëmtuar shumë duke na marrë buxhetin për kontratën kolektive. Nuk jemi kundër kontratës kolektive, por, Komuna e Rahovecit dhe asnjë komunë e Kosovës nuk e ka nënshkruar kontratën kolektive. Pra, për vitin 2025, sipas qarkores së parë buxhetore, i kemi 1.010.000€. Subvencionimi shkon për bujqësi, kultur, rini dhe sport, bursa për studentë dhe nxënës, për mbulim të shpenzimeve të varrimit, start-up biznese për gra, për ndihma momentale dhe për shumë situata që cilësohen subvencione. Përveç studentave të nivelit master, unë jam pro t'i përkrahim edhe doktorët.

Saranda Sallteku: Faleminderit Vlora! Reparti i Pediatrisë nuk është i mbyllur, punon deri në ora 14:00, ashtu siç është e paraparë në kujdesin primar shëndetësor. Pas orës 14:00 punon mjeku i përgjithshëm, si të punojë në katin e parë, si në të tretin është i njëjtë. E kemi urgjencën 24 orë dhe ekipën mobile për shtëpi.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues! Dua t'ju jap pak respekt drejtorëve që ishin të mirë në përgjigjet e tyre dhe ju inkurajoj që vazhdimisht të dilni të përgjigjeni. Te çështja e kryetarit: Limiti i arsyeshmërisë së fjalëve që përdoren në debate parlamentare duhet të gjykohej prej kryesuesit të kuvendit. Reaksioni fjala kundër fjalës dhe që nuk e fillon gjithmonë i pari, nuk besoj që qëndron. Ti e sheh me një këndvështrim tjetër, por nuk qëndron. Sa do të rënda që janë fjalët, ju e keni përgjegjësinë ekzekutive, ndërsa unë nuk kam. Këtu e kam përgjegjësinë e përfaqësimit të qytetarëve kundrejt punës që ju e bëni, në lëvdata apo kritika. Përgjegjësia është tek ju dhe është normale që "limiti i arsyeshmërisë së fjalëve" duhet të jetë më i lartë, sesa prej ekzekutivit kundrejt kuvendit. Te gabimet që i bën në punë, shfryhesh te anëtarët e kuvendit. Këtu është edhe një problem tjetër, sepse në debat me anëtarët e kuvendit dispropocioni i kohës është katastrofal, psh: Për një replikë që e kam 3 minuta, ju debaton 33 minuta dhe kjo gjendje ta mundëson ty që të luajnë emocionet dhe të del diçka edhe jashtë arsyes, si dhe reaksioni rritet më shumë, sepse ndoshta bëhesh nervoz edhe me kohëzgjatjen e fjalimit tënd. Te amandamentimi i kontratave, deri në çfarë periudhe mund të zgjaten kontratat? "FARDI" më vjen mirë që është një bashkim i shoqërisë rahovecase që vepron në Prishtinë dhe në vende tjera, besoj që mund të japin shumë kontribut. I ftoj që përveç këtij aktiviteti në Gradish, nuk e ka parë asnjëherë që kanë mbajtur takime në Komunë të Rahovecit, një kritikë e butë. Te numri i popullsisë, te migrimi i brendshëm mund të jenë njëri nga faktorët edhe institucionet komunale. Nëse e marrim shembull që njerëzit në këtë kohë kanë qejf që vendi i tyre të jetë më i zhvilluar, minimalisht të ketë banesa të mjaftueshme, që ata mund të banojnë me qera, shkak që njerëzit në këtë kohë nuk dëshirojnë të jetojnë në bashkësi sikur më herët. Të rinjtë e Rahovecit pas fejesës dhe martesës nuk kanë ku të bashkëjetojnë këtu dhe po dalin në Prishtinë. Parkingu nëntokësor i sheshit qëndror në plan ka qenë të përurohet në qershor, nuk është përuar. Në lagjen e epërme ka më shumë se një muaj që nuk ka ujë, besoj që duhet të bëni më shumë trysnë te KRU Gjakova, sepse ka shumë ankesa nga qytetarët e lagjes së epërme.

Kryetari: Si për 3 minuta, si për 33, unë i pranoj përballjet dhe kam gatishmëri. Anëtarin e kuvendit e inkurajoj të ketë vërejtje dhe kritika, sidomos alternative. Kjo nuk do të thotë që anëtari i kuvendit ka të drejtë të bëjë kualifikime apo fabrikime. Të mirëpritura janë kritikrat legjitime, pavarësisht a më pëlqejnë, apo jo. Gjuha fyese është e

papranueshme si në seancë, ashtu edhe në realacion me ekzekutivin dhe anasjelltas. Mirë është të dakordohemi në parim që mos të kemi gjuhë fyese në kuvend. Unë kam marrë pjesë në një nga seancat e parlamentit të Mbretësisë së Bashkuar. Atje përplasjet janë konceptuale, kritikët janë parimore, bile për respekt, kur të flet njëri prej anëtarëve të grupit, tjerët ngriten në këmbë. Është e vërtetë që Rahovecit ka nevojë për ndërtime të larta, po ashtu është e vërtetë që Komuna e Rahovecit dhe asnjë komunë e Kosovës nuk ndërton ndërtesa të larta. Komunat krijojnë kushte dhe lehtësira për investitorin privat. Ne tani e kemi PZhK-në dhe jemi në pritje të HZK-së që nga muaji mars nga ministria. Defrim, edhe ti deri vonë e ke pasë në qejf jetesën bashkë me prindë, tani ka ardhur një tendencë pozitive të planifikimit të jetës më ndryshe. Fejohu më shpejtë se banesa gjendet diku. Fejohuni ju të rinjtë, mos rrini kështu “palidhje”. Besoj që ndryshimi është i mirë. Sa i përket migrimit të brendshëm, Prishtina është hapësirë e madhe, njerëzit e aspirojnë më shumë. Kjo nuk është duke ndodhur veç te ne, por në të gjithë Kosovën. “FARDI” e ka marrë një subvencion për monografinë për masakrat që kanë ndodhur në komunën tonë. Kjo është një vepër, që ata e kanë për detyrë deri ka marsi i vitit të ardhshëm ta bëjnë gati për promovim.

Vlora Vuçiterna: Dua të ndërlihem me drejtoreshën me atë që tha që si në kat të tretë, si në të parin është njëjtë. Nuk është njëjtë drejtoreshë! Pasi thua që është njëjtë, pse nuk po e bartni edhe gjinekologjinë poshtë? E para, ka dallim, sepse fëmiu e merr ndaras trajtimin e nevojshëm dhe jo bashkë me një të rritur. E dyta, lart, fëmijët kontrollohen nga pediatri specialist, pastaj si ia bëjnë ata fëmijë që shkojnë në ora 1 për një infuzion, d.m.th pak para mbylljes të ndërrimit të parë, duke e ditur që infuzioni zgjatë më shumë se një orë. Ka ndodhur shumë herë, që fëmija bashkë me infuzion të zbret prej katit të tretë në të parin. Meqenëse është e paraparë në udhëzim administrativ, pse deri tani keni punuar kundër udhëzimit administrativ?

Saranda Sallteku: Gjinekologjinë nuk e zbresim poshtë, sepse lart punon gjinekologu. Pas orës 14:00 punon mjeku i përgjithshëm familjar.

Dafina Gashi: Faleminderit kryesues! Kur po flitet këtu për përgjegjësi dhe për llogaridhënie, nëse ka mundësi ta dimë arsyen e dështimit të mbledhjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që ka qenë për këtu muaj?

Vlora Vuçiterna: Faleminderit Dafinë për këtë pyetje, por më preke pak në çështje familjare! Në këtë rast është shumë i informuar Skenderi, mungesën e kam pasur me arsye, sepse vajzën e kam operuar dhe ka pasur 10 ditë pushim nga mjeku.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale Nr. 00889-0, ZK- Çifllak, në sipërfaqe prej 11765m²;

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë kolegë, media. Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Çifllak, parcela është e komunës, P-00889-0. Po marrim vendim për ta dhënë me qera për 15 vjet, me kulturë të klasit të katërt për qëllim bujqësor dhe vetëpunësim, në sipërfaqe të përgjithshme prej 35.227m², por në shfrytëzim do të jepen vetëm 11.765m².

Sejfullah Sejfullahu: Konkretisht për çka është paraparë kjo parcelë dhe a ka të interesuar?

Erhan Morina: Po i nderuar, unë e ceka që qëllimi i marrjes në shfrytëzim është për qëllime bujqësore.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A kemi ndonjë diskutim tjetër? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Unanimisht me 24 vota votohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-00889-0 ZK, Çifllak, në sipërfaqe prej 11765m²;

Erhan Morina: Kjo pikë lidhet me pikën paraprake. Kërkohej të formohet komisioni prej 5 anëtarëve, 2 prej tyre nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

Kryesuesi: Atëherë, shkojmë me propozimet e juaja!

Hasan Përboqi: AAK – Florida Bajraktari!

Leonard Morina: LVV – Ilir Pallqa!

Eqrem Spahiu: LDK- nuk kemi propozim!

Sejfullah Sejfullahu: PDK – nuk kemi propozim!

Kryesuesi: Atëherë, ndërkohë edhe dy propozimet tjera do të jenë nga ekzekutivi i komunës dhe një nga sektori joqeveritar. Nga kuvendit janë Florida Bajraktari dhe Iliri Pallqa. E vendosim në votim, kush është “për”?... Unanimisht me 23 vota kalon pika e katërt.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, Nr. 00889-0, ZK- Çifllak, në sipërfaqe prej 860.00 m²;

Erhan Morina: Para jush keni propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim të parcelës, 00889-0 në ZK- Çifllak. Këtu duhet që sekretaria ta përmirësojë, sepse jepen në shfrytëzim 8600m² dhe jo 860.00m. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është kultivimi i bujqësisë.

Ilir Pallqa: A është e destinuar vetëm për bujqësi? Në rregull, faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit Ilir Pallqa! Atëherë, e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime 20 vota “për”, aprovohet pika e pestë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00889-0 ZK, Çifllak, në sipërfaqe prej 860.00 m²;

Erhan Morina: Para jush keni propozim-vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, vendimi ndërlihet me pikën paraprake, P-00889-0 ZK. Komisioni duhet t’i ketë 5 anëtarë.

Kryesuesi: Atëherë, dy përfaqësues do të jenë nga kuvendi i komunës.

Hasan Përboqi: AAK, propozojmë Sinan Kryeziun!

Leonard Morina: LVV, nuk kemi propozim!

Eqrem Spahiu: LDK, nuk kemi propozim!

Sejfullah Sejfullahu: PDK, propozojmë Melinda Oruqi Iska!

Kryetari: Nga ekzekutivi janë Besmirë Bytyqi dhe Afrim Oruqi dhe ndërkohë një përfaqësues nga ojç.

Kryesuesi: Faleminderit! Komisionin si të tillë e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (19) votohet edhe pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për faljen e borxhit të papaguar për taksën komunale, respektivisht - qiranë e shfrytëzimit të hapësirës publike;

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! E kemi një kërkesë nga një banor i Krushës së Madhe, ekskluzivisht nga Bajram Ramadani, për shfrytëzimin e hapësirës publike konkretisht objektit të përkohshëm. Tani aty është ndërtuar parku dhe janë rikthyer 4 objekte dhe palët që kanë qenë aktive më herët, kanë bërë kërkesë që t’ju bëjmë kontratë 1 vjeçare, sipas rregullores që e kemi për shfrytëzimin e hapësirës publike. Bajrami, i ka pasur disa obligime të papaguara dhe është një periudhë që disa vite nuk ka punuar, në dosje i keni edhe procesverbalet e inspektoratit. Këtu kërkohet që të merret një vendim për pezullimin e aktiviteteve ndërvite që nuk ka punuar. Për pjesën tjetër të borxhit të mbetur, të bëhet një draft marrëveshje që ta bëjë pagesën dhe t’ia japim kontratën e re.

Defrim Kafexhiu: Në mbledhjen e KPF-së kam kërkuar që nëse ekzistojnë procesverbalet e Drejtorisë së Inspektionit për çdo vit, prej vitit 2011-2017. Në material nuk e kemi asnjë procesverbal.

Përparim Krasniqi: Unë kam menduar që e kam përcjellur te zyra e kuvendit, përndryshe të gjitha procesverbalet i kam këtu, për pak minuta do t’i keni afër.

Burim Krasniqi: Po ndalemi te një individ. Në KPF kërkoja që nëse ka raste të njëjta, pse mos të jenë këtu? A vlerësohet diskriminuese që sot këtij t’ia falim dhe dikush e ka të njëjtën rrethanë. Mendoj që duhet të marrim vendim në parim, sepse është e ndjeshme dhe në një formë që nëse nuk e falim, ai nuk ka punuar fare dhe të ngarkohet nuk është korrekt nga ana jonë. Në anën tjetër, nëse është ndonjë tjetër me rrethana të ngjashme, atëherë mirë është ta kemi një listë të tyre për t’ju falur obligimet dhe për t’ju riformuluar kontratat. Përndryshe, po e lëmë në besim të plotë tek ju që nuk ka operuar, kemi dëshmi që nuk ka operuar dhe nuk dua të paragjykoj në atë drejtim.

Kryetari: E kam mirëkuptuar Defrimin dhe posaçërisht Burimin! Burimi e shtroj edhe një çështje që është parimore. E ftoj drejtorin e Ekonomisë dhe të Shërbimeve Publike që diku ka shtatori ta përgatisin një listë të atyre që

potencialisht mund të jenë situata të ngjashme dhe nëse ka lejon ligji, atëherë ne operojmë si ekzekutiv dhe kuvend. Pajtohem në atë që nuk është ndoshta e ndershme që është veç ky rast, por ne e kemi pranuar vetëm këtë kërkesë. Te lokalet atje, njërin prej tyre do të jepet për postë, njëri për KRU Gjakovën, një e ka marrë një berber dhe tjetrën ky i fundit që ka pasur operime me faza, megjithatë mbetet një borxh dhe falet një tjetër ku është ngarkuar ndonëse nuk ka punuar. Në mbledhjen e shtatorit do të përpiqemi ta bëjmë një listë të operatorëve, që nëse ka dhe nëse ligji na lejon, t'ju falim nga një borxh për periudha të caktuara. Unë nuk jam për të bërë lobin për rastin konkret, por e ftoj kuvendin të vendosë ashtu siç e vlerëson edhe pse ndoshta është mirë që t'ia japim një mundësi.

Përparim Krasniqi: Vetëm edhe një sqarim, kjo nuk është falje e borxhit. Në bazë të procesverbalit bazohemi dhe është pezullim i asaj periudhe që nuk ka punuar, si dhe obligim për të mbeten edhe 6700€ që kuvendi na autorizon të bëjmë draft-marrëveshje që pala të paguan me një afat të caktuar me rata.

Burim Krasniqi: Çështja që e diskutuam që ta kemi në parim, mendoj që i mundëson komunës të ketë të hyra dhe besoj që i mënjanojmë borxhet e këqija. Megjithatë, në pikën 1 të vendimit, potencohet që inspektorati i ka procesverbalet që nuk ka operu, si grup i LDK-së besojmë që ashtu është. Në seancat tjera presim që kjo të ndodh edhe me të tjerët, që mos të jemi diskriminues dhe si vendim e ka përkrahjen tonë.

Leonard Morina: Parimisht edhe pse nuk e njoh personin, në KPF kam qenë kundër këtij vendimi. Nuk jam që mos t'i ndihmoj atij, por gjithashtu kam frikë që këto praktika do të përsëriten. Të njëjtën praktikë do ta ndjekin të gjithë ata që kanë toka, apo lokale të komunës në shfrytëzim. Nëse nuk ka operuar, ai ka qenë në kontratë dhe besoj që ai është dashur t'i paguaj obligimet. Ne mund të marrim prona në komunë dhe të themi që nuk e kam punuar tokën 3 vite dhe ta kërkoj faljen e borxhit. Nuk duket praktikë e mirë. Nëse është veç ky person, nuk ka të tjerë dhe nuk ka ndonjë rrezik që të ketë përsëritje, atëherë jemi në rregull.

Sinan Kryeziu: Faleminderit kryesues! Përsëritet për të gjithë të pranishmit në sallë! Kur jemi te kjo pikë, më lejoni ta jap kontributin tim në lidhje me anën ligjore. E mbështes këtë ide, sepse nuk e di sa e keni lexuar ligjin. Ligji çdo herë e favorizon qytetarin e thjeshtë, personin fizik, në këtë rast person juridik është komuna. Më pëlqen marrëveshja që e ka bërë drejtoria përkatëse për faktin se me ligj është "parashkrimi i borxhit publik. Zotëriu në fjalë, më vjen mirë që një pjesë për pagesë ka vullnet të lirë ta paguaj dhe një pjesë tjetër ka gatishmëri për falje. Nëse më merr mua si përfaqësues, komuna nuk mund t'ia marr as këtë shumën e mbetur që është mbi 6000€, sepse ligji e thotë që borxhi parashkruhet brenda një viti e gjysmë, ndërsa këtu bëhet fjalë që zotëriu në fjalë nuk ka paguar 10 vite.

Merisa Sharku: E kemi një rast, ku në stacionin e autobusëve e kemi pas një kontratë të njëjët, personi nuk ka operuar dhe njëkohësisht e ka paguar qeranë. Nëse ai e dëgjon këtë rast, mund të vijë në komunë dhe çka nëse ai kërkon që ato mjete t'i rimburohet, sepse është rasti është i njëjtë. Nëse është kështu, atëherë këtu bëhet një hamulli dhe komplikohet situata.

Kryetari: Kështu, në stacion të autobusëve po krijon kushte që të ketë burime të mira financiare, me anë të lokaleve afariste. Ai lokali për të cilin po flet, ka paguar qera, por nuk ka pasur leje dhe i nderuari z. Fehmi Hoxha nuk ka arritur ta pajis me leje asnjëherë, si dhe tani i takon ekskluzivisht stacionit të autobusëve. Ne jemi në dilemë, bashkë me bodrin e stacionit që a ta rrëzojmë atë objekt, apo ta lëmë ashtu siç është. Nuk është ky rast i ngjashëm Merisë, por raste të tjera mund të ketë dhe është mirë që t'i shqyrtojmë.

Bejtullah Deliu: Faleminderit kryesues! Ne ballafaqohemi jorrallëherë me mungesë të dokumentacionit për një pikë sikur kjo dhe jemi në lajthitje se si të veprojmë. Te ju qenka raporti i inspektoratit, mirëpo ne nuk e kemi dhe duhet t'i besojmë fjalëve që i thatë. Në rregull është që ne t'i kemi paraprakisht gjërat që të dimë se çka po votojmë. E dyta, si lejohet që kaq shumë vite të mbahet një kontratë pa ndonjë vërejtje dhe pa ndonjë rishqyrtim nga ekzekutivi apo nga personat përgjegjës, 6-7 vite ai nuk operon, nuk paguan dhe nuk jep asnjë përgjegjësi. Këtu është pikëpyetja, pse është lejuar kaq vite kjo kontratë? E treta, ekzekutivi nuk është në dijeni nëse ka raste të tjera të kësaj natyre, pse të ngutemi që këtë pikë tani ta votojmë, nëse kryetari thotë që në shtator do ta kemi një listë me një analizë më të thukët lidhur me rastet e tilla. Të shtyhet kjo pikë dhe të bëhet votimi i rasteve në tërësi. Ndoshta ky person e meriton që plotësisht t'i falet kjo, por kur është individualisht, mendoj që dikush "diskriminohet" dhe dikush "favorizohet". Nëse ekzekutivi është në mëdyshje që mund të ketë ende raste të tilla, pse jo që edhe kjo pikë të mos bartet në shtator?

Kryetari: Ne jemi në suaza të paragjytimeve, ndërkohë në tavolinë e kemi një situatë konkrete! Praktika e pezullimit të borxhi, kush e mban në mend, këtij kuvendi i ka ndodh shumëherë. Është situatë konkrete, personi ka bërë kërkesë dhe tregon që ka një obligim, si dhe procesverbalet të cilat tregojnë që nuk ka operuar. Nuk kemi kërkesa të tjera të kësaj natyre. Kërkova nga drejtoritë që në shtator ta bëjnë ndonjë listë, nëse ekziston edhe ndonjë rast i tillë. Unë jam për ta hedhur në votim, a votohet a jo, unë nuk jam për ta marur njërin, apo tjetrin rol.

Defrim Kafexhiu: Të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit duhet të mësohen ta vlerësojnë pronën e shtetit-komunës. Nuk është i vetmi rast, qytetarët që e marrin në shfrytëzim qoftë një objekt, apo një tokë, e vlerësojnë më pak se kur e marrin me qera prej një personi fizik tjetër. Tash është më mirë, sepse është krijuar një standard i ri me pronat komunale dhe më duket se çmimi është më i arsyeshëm, si dhe çmimi e tregon edhe vlerën e pronës. Te ky rast, para se ta vendosim në votim, minimalisht i kërkoj kryesuesit të na skenojë procesverbalet dhe në pjesën e pauzës një orëshe që mund ta shqyrtojmë më mirë. Plotësisht pajtohem me Leonardin dhe Bejtullahun që mund të ketë edhe raste tjera. Parimisht jam për t'i krijuar zgjidhje për shkak të akumulimit të borxhit, por minimalisht duhet t'i shohim dokumentet.

Burim Krasniqi: Nëse mundem pak të ndihmojë si proces. Drejtor, nuk është problem i madh ta dërgosh dikë t'i bëjë fotokopje dhe së kapu 5-6 kopje t'i kemi para vetes. E dyta, te pjesa tjetër që po flasim për veprim në parim dhe për rishikim të obligimeve, mendoj që drejtoritë mund ta shohin listën kush ka situatë të ngjashme, t'i vlerësojnë edhe ata që nuk kanë situatë të ngjashme se çka mund t'i falet që mos të kalojë në borxh të keq. Operatorit duhet t'ju drejtoheni me shkresë, t'i thoni "a jeni të gatshëm për marrëveshje"? Para se ta marrin vendimin në asamble, sepse nuk mund të marrim vendim, nëse ai thotë që "nuk jam i gatshëm". Nëse ai nuk është i gatshëm, janë procedurat përmbartimore që i realizon komuna. Në parim, mendoj që duhet ta bëni një listë në të ardhmen të atyre që kanë obligime dhe të cilët janë të gatshëm për marrëveshje, apo jo dhe besoj që krijohet një situatë kur rifillohet prej zeros në këtë drejtim. Akumulimi i borxheve nuk bën zgjidhje për institucionin, përveç telasheve që nuk kemi as mekanizëm të realizimit të tyre.

Kryetari: Sektori i tatimit në pronë, sektori i bizneseve dhe drejtoritë, bëjnë marrëveshje në baza ditore, madje edhe për tatimin mbi pronë. Bëjnë programim të borxhit, me rata apo sezona. Është normale që këto marrëveshje bëhen në mënyrë që të mos akumulohen borxhet. Bëhen marrëveshje të reja, rishikim të borxheve në baza ditore. Aktualisht po flasim për një listë potenciale dhe nëse na lejon ligji, formalisht duhet t'i shlyejmë. Përndryshe për marrëveshjet për të cilat fole, bëjmë gati çdo ditë. Nëse dikush i ka borxh 5000€, gjysmën prej tyre e paguan menjëherë, ndërsa pjesën tjetër brenda vitit. Votoni si ta vlerësoni, mirë është t'i japim epilog.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Atëherë, pas diskutimeve të shumta, pikën e shtatë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 11 vota pro, 2 kundër dhe 6 abstenim, kalon pika e shtatë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pauzën e drekës një orëshe.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, P-00041-1, ZK-Drenoc;

Erhan Morina: Para jush keni propozim-vendimin e kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm ndërtesën administrative KB Bujku në Drenoc, me numër të parcelës 00941-1, shfrytëzues ekonomia e pyjeve. Qëllimi është inicimi i procedurës për shpronësimin e kësaj lokale dhe meremetimin e shtabit të UÇK-së.

Kryetari: Bëhet fjalë për ish objektin e shtabit rajonal të UÇK-së në Drenoc. Fatkeqësisht është nën menaxhim të AKP-së. Ne kemi kontratë për riorganizim aty dhe duhet ta marrim vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm. Do të renovohet dhe do të bëhet si tip muzeu dhe qëllimi është që ta mbrojmë me vendim të kuvendit.

Kryesuesi: Atëherë, nëse nuk kemi diçka tjetër, këtë pikë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht (20) votohet edhe pika e tetë.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin e ndërtesës me Nr. 00644-0, ZK – Rahovec;

Kryetari: Drejtori mesiguri ka edhe informata më të rëndësishme dhe më të detajizuara, nëse do të ishte drejtori për Gjeodezi dhe Kadastërt, sigurisht edhe më shumë. Bëhet fjalë për objektin në qendër të qytetit të Rahovecit, aty ku ka qenë dikur një shitore e këpucëve, apo aty ku e ka shfrytëzuar Qamil Sylka etj. Rezulton që ata i paguajnë qera komunës, ndërsa objektet janë të AKP-së. Dëshirojmë që t'i mbrojmë me vendim të kuvendit dhe të shohim tutje.

Defrim Kafexhiu: E pata një pyetje të çështja e shpalljes me interes të përgjithshëm dhe pas kësaj vjen shpronësimi. A janë tarifat e njëta si të komunës në raport me Agjencionin e Privatizimit? Besoj që ka qenë i njëjti rast si me shpronësimin e ish pompës së shtetit dhe arsytimi i drejtorit që e ka dhënë në KPF ka qenë shkaku se nëse nuk vazhdojmë si komunë t'i përvetësojmë këtë objekte, atëherë mund të dalin në shitje apo privatizim.

Kryetari: Mund të jetë raste përafërsisht të ngjashme. Ne do të ndjekim edhe hapa të guximshëm dhe nëse mund t'ia marrim krejt realisht, sepse është një situatë interesante, ata i paguajnë qera komunës dhe jo AKP-së.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Atëherë, nëse nuk kemi diçka tjetër, këtë pikë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht (20) votohet edhe pika e nëntë.

10. Shqyrtimi i raportit financiar, janar-qershor 2024;

Afrim Limani: I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, asambleistë! Raporti 6-mujor financiar, për dallim ai 3-mujor, që është i ndarë nga dy pjesë kryesore, pjesa e të hyrave dhe pjesa e shpenzimit të buxhetit, ky raport përpos këto dy elementeve që i ka, i kemi edhe numrin e kontratave të lidhura në mënyrë të detajuar. Në raport raport janë të futura obligimet kontraktuale, financiare, si dhe analitika në përgjithësi për këto shpenzime. Të hyrat për këtë periudhë gjashtëmujore në total janë 893.815€ dhe kur i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, atëherë, kemi një minus prej 136.101€. Bashkë me gjobat e gjykatave dhe të trafikut të cilat i keni në raport, në total të hyrat janë 947.442€ dhe kur i krahasojmë kemi një minus prej 218.000€. Ndërkohë ka ardhur edhe raporti për gjobat e gjykatave dhe trafikut për 3 mujorin e dytë dhe kanë qenë prej 92.671€ dhe që në total të hyrat rriten për t'u bërë 1.040.000€ dhe diferenca finale është minus 125.663€. Në raport i keni edhe realizimet e të hyrave sipas kodeve ekonomike, raportin e tatimit në pronë, shpenzimin e buxhetit (12.412.000€) apo 62.79%. Në këtë raport e keni edhe raportin e kontratave të lidhura deri në këtë periudhë, që deri më tani është 1.691.000€. Vlera e obligimeve kontraktuale në total duke filluar nga viti 2020 është prej 16.256.000€, nga ky total ka investime kapitale dhe mallra dhe shërbime dhe kur e zbrisim këtë të dytën, atëherë vlera kontraktuale është 14.173.000€. Ju rikujtoj që buxhet për t'u shpenzuar për këtë vit kanë mbetur edhe mbi 33% të buxhetit. I kemi projeksionet për vitet 2025-2027 dhe vlera e këtyre projeksioneve është e mjaftueshme që të jemi komod, që këto obligime kontraktuale do të mbulohen. Vlera e obligimeve financiare për këtë gjashtëmujor në total është prej 277.000€.

Leonard Morina: Së pari e pyes drejtorin, ndoshta është edhe çështje teknike: Këto karakteret që po dalin nëpër kolona, a ka mundësi pse nuk ka të dhëna, po vetëm karaktere dhe jo informacion shifror? Te kodi 50013, taksa për certifikata të lindjes: Te planifikimi për vitin 2024 i keni planifikuar 14.000€, ndërsa realizimi 810€ dhe totali në përqindje del 5.79%. Pse kjo përqindje e pakuptimtë? Te karburantet për vetura, në vitin 2024 te zyra e kryetarit janë 5000€ dhe në pyetjet që i kemi pasur më herët keni thënë që hyjnë edhe kategoritë tjera, jo veç zyra e kryetarit. Nëse ka mundësi që këtë raporte t'i dalloni, që mos ta vendosni komplet zyrën e kryetarit, por, t'i ndani në kategori që t'i dimë shpenzimet. Te kodi 14060, mirëmbajtje rutorore janë tri kode dhe janë shpenzuar 160.000€, për çfarë kontrata është fjala? I kemi dy kode të shërbimit të avokaturës dhe shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse. Te e avokaturës janë 30.000€, të këshilldhënës 10.000€, nëse i ndërrohet vlera, a është më mirë që 30.000 t'i vendosni të këshilldhënës dhe jo të dëmi të avokatura, ndoshta më shumë këshilla, më pak gabime. Komplet karburant janë shpenzuar 34.500€ brenda këtij gjashtëmujorshi, në kilometra nëse e shikojmë me një çmim mesatar 1.30€ i bie që janë bërë 520.000km, m'u duk si shumë! Nëse ka mundësi një sqarim. Pyetja e fundit, furnizimi me uniforma të drejtorisë e Inspektionit është rreth 9360€ ka qenë kontrata. Sa ka staf? Sa ka kushtuar një uniformë?

Burim Krasniqi: Drejtor, te raporti financiar ka disa pozicione që ka rënie të të hyrave, ka trend negativ kur krahasohet me vitin paraprak. Te taksat komunale, te tatimi në pronë, a është rezultat i ligjit të ri për tatimin në prone, apo ku është rezultati i kësaj? Në seancën e kaluar e kam dhënë një sugjerim që duhet të rishikohen edhe një herë sipërfaqet e shtëpiave të banimit, sepse aty ka një dallim që është duke u shkaktuar kjo çështje. E dyta, te lejet e ndërtimit ka trend negativ, nuk është që ka reduktim të ndërtimit të objekteve, por lejet ndërtimore kanë të hyra më pak sesa vitin paraprak për periudhën e njëjtë kohore. Te shpenzimet: Në raportin financiar si obligime janë 16.156.000€, 14 milion prej investimeve kapitale, që i bie një pjesë e konsiderueshme të drejtorisë e Shërbimeve Publike. Drejtor, kjo drejtori në gjashtëmujorin e parë ka bërë pagesa vetëm 800.000€, jo më shumë. Nuk ka më shumë

punë të kryera se 800.000€, kur kemi parasysh që kemi obligime prej 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe realizimi është vetëm 800.000€. Në anën tjetër, janar-qershor kemi kontrata 1.691.000€, ndërsa obligime të vitit 2024 janë vetëm 750.000€. D.m.th, janë lënë obligimet e vitete paraprake dhe janë paguar rreth 900.000€ obligimet e vitit 2024. Nuk është ndjekur vazhdimësia e mbylljes së obligimeve. E fundit që më la përshtypje, komuna ka arritur të vie në 300.000€ punë të kryera (fatura), borxh financiar, jo obligim kontraktual dhe me përjashtim të mbi 200.000€ të obligimeve të vitit 2020, 2019 e tutje janë shlyer të gjitha. Nuk ka obligime të kontratave të mëhershme të nënshkruara, që besoj që duhet të ketë, sepse ruga Xërxë-Rahovec që nëse nuk jam gabim, kontrata është e lidhur para vitit 2020.

Defrim Kafexhiu: Te të hyrat vetanake, pothuajse është viti i dytë që Komuna e Rahovecit po e tejkalon planifikimin e të hyrave, a mund ta di pse? Cilat janë masat që i keni marrë në grumbullimin e të hyrave që ka tejkallim të parashikimeve? Një pyetje e kam te avokati i komunës, i cili për këtë gjashtëmujor i ka kushtuar 28.000€. Kryetari, në fillim kur kemi debatuar rreth kontratës që Komuna e Rahovecit e ka lidhur me avokatin, ka thënë që mund të variojë prej 1000 deri në 5000€. Dëshiroj ta dëgjoj një koment prej kryetarit për këtë çështje.

Kryetari: E di që drejtori i Financave është protagonist i përgatitjes së kujdesshme të raportit 6-mujor financiar dhe besoj që i ka të gjitha përgjigjet. Dua ta plotësoj pak Burimin, se edhe mua m'u duk interesant. Janë paguar obligimet financiare të vitit 2024 dhe ndoshta në vitet paraprake jo. Ne e kemi grantin e performancës dhe granti të obligon vetëm investim në projekte të reja, bile granti nga MAPL-ja sivjet duhet të shpenzohet, gjysma tjetër financohet nga Demos-i dhe ambasadat përkatëse. Rritja e të hyrave, te Defrimi. Po, është tejkallim i të hyrave. Në radhë të parë ka më shumë vetëdije dhe ndërgjegje ndaj obligimit të tatimit mbi pronë, gjithashtu ka një aksion më efektiv të drejtorisë së Financave. Madje, kërkesë nga auditori e kemi që duhet të regjistrojmë sa më shumë pronarë që kanë prona. Bëhet fjalë për një ndërmarrje më efektive të komunës, sepse regjistrohen edhe prona dhe ndërtime të reja nga eklipi i tatimit në pronë.

Defrim Kafexhiu: Te shpenzimet për informim, ishin 4400€, për çka shpenzohet këto mjete? Një kërkesë tjetër e kam, "shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse" 7100€ është shuma për këtë gjashtëmujor të vitit 2024. Besoj që për ta kursyer buxhetin e komunës për këtë gjashtëmujorin e dytë, mund ta thirrni ndonjë ekspert prej kuvendit për këshilldhënie.

Kryetari: Kuvendin e vlerësojmë, është institucion që dominon ekspertiza. I konsideroj shumë të rëndësishme këshillat e secilit këshilltar këtu. Konsulenca nuk është veç avokati, ka konsulencë për hartimin e projekteve - inxhinier, ekonomist.

Afrim Limani: Faleminderit për pyetjet, nëse eventualisht ndonjë nuk kam mundur ta regjistroj, e lëmë opsionin e komunikimit interaktiv. Te Leonardi: Te tabelat/shtyllat i bëjmë me formulë dhe në momentin që nuk ka të dhëna del ajo pjesë. Te certifikatat e lindjes, planifikimi i madh-realizimi i vogël. Sa i përket kësaj, janë të regjistruar në kodin e taksave, sepse ndonjëherë ndodh ndonjë gabim në sistem. Pyetja tjetër ishte se pse në zyrën e kryetarit ka kaq shumë shpenzime me vlerë 5000€: Në kuadër të zyrës së kryetarit veprojnë edhe disa sektorë, siç është zyra e prokurimit, e auditimit, ligjore, të informimit etj... Zyra e kryetarit e ka kodin e veçantë dhe në bazë të veturave që janë mund të dimë saktë në mënyrë analitike edhe pse asnjëherë nuk e kemi praktikuar këtë gjë. Mos të harrojmë që edhe çmimi në këtë vit është pak më ndryshe. Te përmbajtja rutinore, ne i kemi dy kontrata të mëdha që merren me pastrim të ambientit, me Ekoregjionin dhe Ekodrininë. Mirëmbajtja është për dy sezona, verore dhe dimërore. Shpenzimet e avokaturës u diskutuan. Raporti është i specifikuar detajisht prej 1 janarit deri më 30 qershor. Shërbimet këshilldhënëse: Kryesisht janë komitetet që i paguajmë, obligative dhe joobligative. Te uniformat, nuk janë vetëm të inpekcionit, por edhe të sektorit të tatimit, që gjithsej bashkë janë 17 punëtorë. Burimi tha për rënien e të hyrave të tatimit në pronë. Po, është e vertetë! Kjo rënie ka ndodhur sepse vitin e kaluar shpërndarja e faturave të tatimit në pronë ka ndodhur më vonë dhe qytetarët nuk kanë ngurrar që të paguajnë. Është fakt që te lejet ndërtimore nuk ka pasur kërkesa për leje nga qytetarët. Pyetja tjetër e Burimit ishte, pse kaq pak obligime financiare? Të them të drejtën kaq është, operatorët po e kryejnë punën dhe në aspektin ligjor e dorëzojnë faturën që ta kenë një garanci. Te Defrimi, pse po tejkalohe të hyrat vetanake: Ne e bëjmë një planifikim real, të cilin e dorëzojmë në departamentin e buxhetit dhe zakonisht ata e kanë zbritur atë që ne e kemi planifikuar. Realisht dy vitet e fundit, përveç realizimit, jemi duke e tejkalluar planin. Tejkallimi është shumë i mirë për ne, sepse ato para i dedikojmë në projekte të ndryshme.

11. Shqyrtimi i Informatës të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

Berat Duraku: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, asambleistë. Para jush keni të gjitha aktivitetet dhe punët që janë kryer në Drejtorinë e Bujqësisë në periudhën gjashtëmujore. Këtë material e kemi ndarë në dy periudha, janar-shkurt-mars dhe prill-maj-qershor. Fillimi i vitit është karakterizuar me aplikimin e fermerëve për subvencionet e qumështit. Në këtë fazë kanë aplikuar 91 fermerë me gjithsej 1.7 milion litra dhe 522 krerë të viçave. Në këtë periudhë është hapur thirrja për aplikimin e fermerëve vreshtarë për luftimin e sëmundjes “Cikadia”. Kanë aplikuar fermerët, janë zgjedhur përfitesit dhe gjithashtu është bërë shpërndarja e preparateve për luftimin e sëmundjes “Cikadia”. Në periudhën e dytë e kemi hapur thirrjen për aplikim për pleh. Kanë aplikuar 1128 fermerë, prej tyre janë zgjedhur përfituesit. Në këtë proces akoma nuk ka filluar shpërndarja dhe shpresojmë që nga e hëna fillon, do ta bëjmë njoftimin. Në materialin e juaj janë disa të dhëna tabelare, kryesisht janë nga aplikacionet e fermerëve që kanë aplikuar në programin e pagesave direkte në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë. Në këtë thirrje kanë aplikuar 3099, nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi 20 aplikues më pak. Vlen të theksohet që në këtë vit kemi rritje të sipërfaqes në perim-kulturë, ndërsa kemi lënie të gruri dhe të misri. Gjithsej në skemën e granteve, projektet të cilat kanë kaluar janë 1.160.000€ dhe nëse kalon lista rezervë janë shtesë edhe 923.000€.

Burim Krasniqi: Drejtor, faleminderit për informatën. Te pjesa e drithërave ka rënie shumë. Te gruri 230 ha më pak, te mistri 67 ha më pak. E keni diskutuar me bujqit, pse po ndodh kjo? E dyta, këtë fenomen shqetësues e kemi të vreshtat, ka filluar të bie sipërfaqja me hardhi. Jemi të njohur si “Grapeland”, por nëse fillon të bie sipërfaqja me hardhi, fillon shqetësimi. Mendoj që ndoshta është mirë ta shohim edhe këtë arsye pse po ndodh kjo. Pjesa e perimeve, lakra, speci, këto janë variabile dhe bujku e ndjek tregun. Më la përshtypje që the që plehu do të shpërndahet nga e hëna. Te drithërat, plehu më nuk përdoret, përveç mbjelljeve e reja të grurit. A është analizuar si të bëhet kjo punë? A do ta shpërndani plehun që të përdoret për vitin e ardhshëm? Kërkoj mirëkuptim që vitin tjetër me inpute të fillohet më herët, që kur të fillon pranvera e hershme, bujqit t’i kenë ato lehtësirat e veta. Berat, secili jemi marrë me bujqësi dhe e din që pranvera është periudha më e vështirë, nëse bujku ngarkohet me shpenzime. Një pyetje të fundit që ndërlidhet me bujqësinë dhe me drejtorinë e Ekonomisë: Rreth depove grumbulluese që kanë filluar të bëhet te Bërnjaka, a janë afër të jepen? Besoj që qëllimi është lehtësi për bujqun, së paku në periudhat më të vështira kur është çmimi më i lirë, t’iu mundësoni që t’i ruajnë produktet, për të pritur në stabilitet të çmimit.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit drejtor për informatën! U përmend lista rezervë, si janë gjasat të arrihet ajo listë dhe a kemi ndonjë shansë, që nëse më pyesin bujqit ta di çka t’ju përgjigjem.

Hasan Përboqi: Drejtor, faleminderit për informatën! Në bazë të tabelarëve, shihet që është punuar në mënyrë të mirë dhe të detajuar. Dua të ndalem te kultura bujqësore e grurit dhe po e shoh që diferenca me vitin e kaluar është minus 223 ha. A keni ndonjë informatë apo statistikë se sa është rendimenti për hektar? Jemi duke e parë një fushatë të qeverisë dhe prej Ministrisë së Bujqësisë që është siguruar buka e motmotit, si qëndron komuna jonë me statistika? Nëse bazohet në atë fushatë, duhet të jetë më shumë!

Berat Duraku: Burim, gjatë pyetjes tani e the edhe përgjigjen, fermerët kryesisht punojnë në atë që e shohin lavërtinë. Duke u bazuar në çmimet e vitit të kaluar të perimeve, kanë qenë të mira dhe kanë përfituar, atëherë është rritur sipërfaqja në perime dhe në kulturë lavërtare ka rënë. Shqetësuese është kjo e rrushit, viti i kaluar ka qenë shumë i vështirë dhe pak vreshtarë kanë marrë “bërqet” në kulturat vreshtare. Kryesisht ato sipërfaqe i kanë lënë të papunuara dhe nuk kanë aplikuar fare për subvencione. Te plehu e ke me të drejtë. Tani është koha kur fermerit nuk i nevojitet në këtë fazë, por ky është lloj i plehut përdoret për të gjitha stinët e vitit. Procedurat për shpërndarjen e plehut artificial i kemi filluar në tetor të vitit të kaluar. Procedurat e tenderit, prokurimit, është vonuar në OSHP mbi 5 muaj dhe kemi arritur këtu ku jemi. Sefa pyeti për listën rezervë. Nëse mund t’ia cilësojë një vendim të mirë këtij ministri aktual, Faton Peci, është vetëm një vendim që e ka marrë në vitin 2022 për t’i kaluar të gjithë fermerët që kanë qenë në listën rezervë. Shpresojmë që ky veprim do të merret përsëri. Përndryshe, viti i katërt i Faton Pecit si ministër dhe është duke i zbatuar vetëm dy thirrje në skemën e granteve. Hasani e përmendi fushatën e atyre që po thonë e kemi “siguruar bukën”, ne nuk e kemi ndonjë menakizëm matës, por duke ku bazuar në të dhënat që i kemi, del që viti i kaluar me tani është pothuajse i barabartë. Këtë vit rendimenti është më i mirë, 4500-5500 është mesatarja për këtë vit, ndërsa

në vitin e kaluar ka qenë 3500-4300 dhe kur përpjesëtohet me atë që kanë rënë sipërfaqet këtë vit, i bie që është pothuajse njëjtë.

Sejfullah Sejfullahu: Me 3 dhe 4 gusht e kemi festën tonë, Agro-festën dhe mirë është që të vijmë të gjithë. E ruajta me qëllim këtë te drejtoria e Bujqësisë.

Berat Duraku: Po, ka filluar propovimi i festës së perim-kulturës në Krushë të Madhe. Do të mbahet më datë 3 dhe 4 gusht. Do të filloj në orën 4 pasdite deri të nesërmen në 4 pasdite. Nata e parë është kryesisht ajo me aktivitete muzikore, nata e dytë është e karakterit e aktivitetëve. Ju ftoj të gjithëve në Krushë të Madhe dhe pastaj të bëhemi gati për festën e vjeljes së rrushit me 6,7,8 shtator.

Kryetari: Në Krushë të Madhe me 3,4 gusht është "Agro-festa". Me 30 korrik është buxhetimi me pjesëmarrje në parteritet me kontratën sociale -USAID-in me moton "ec për qytetin" dhe kemi planifikuar t'i ndajmë 30.000€ për projektin fitues. Më 30 korrik në ora 16:30 jepen propozimet. Ju ftoj që të jeni prezentë në parkun e qytetit, ky program realizohet për herë të parë bëhet në Rahovec, është pilot-projekt. Vendosin qytetarët përmes votimit të drejtpërdrejt. Mund ta bëjmë një projekt, dy, pesë, por edhe shtatë. I mirëpresim qytetarët të jenë prezentë dhe aktivë. Te konsulenca për fitimin e granteve ka arritur deri në 6 milion € për grante, sepse konsulenca e din sakt se kush do ta fitojë projektin, e kush jo. Kjo është dobja e konsulencës. Sa që ndonjëherë Faton Peci po thotë që "a krejt buxheti duhet të shkojë në Rahovec a?" Megjithëse unë jam tepër i pakënaqur me disa politika të Ministrisë së Bujqësisë, sepse realisht vetëm 2 herë brenda 4 viteve është hapur thirrja për grante dhe në thirrjen e dytë ende nuk i kemi përfituesit për implementimin e granteve të fituara. Fatkeqësisht jemi 3099 fermerë aplikues dhe kjo është e vërteta.

Defrim Kafexhiu: E kam një kërkesë për kryetarin e komunës. Kërkoj prej teje kryetar, si i pari i komunës, t'i ftoni vreshtarët, besoj që jeni të informuar që janë dy shoqata të vreshtarëve. Komunikimin më të mirë me Ministrinë e Bujqësisë e ka shoqata e verëtarëve, për këtë po irritohen edhe vreshtarët. Ky irritim po del në opinion dhe po shfaqen probleme që janë të panevojshme. Kërkoj që të takohesh me vreshtarët, që fillimisht ata të jenë të koordinuar në kërkesat e tyre dhe të jenë njëzëri në kërkesat e bëra. Unë kam marrë pjesë në një takim që e ka pasur ministri me vreshtarët, kur ishte çështja e çmimit të subvencioneve për hektar. Ata janë totalisht të pakoordinuar në mes veti dhe kjo është duke ndikuar që ata të mostrajtohen mirë nga ministria e Bujqësisë. Te çështja e bashkëpunimit me USAID-in për këtë pilot-projekt, është njëra prej projekteve më kreative që e keni bërë deri tani si ekzekutiv, ju përgëzoj për këtë punë. Është një formë shumë atraktive e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrjen e qeverisjes lokale.

12. Shqyrtimi i Informatës të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

Saranda Sallteku: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket gjashtëmujorit të parë të Drejtorisë së Shëndetësisë, gjatë periudhës raportuese, janar-qershor ka zhvilluar aktivitetet e saja në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të ngritjes së përgjithshme të cilësisë së shërbimeve dhe të jetës së qytetarëve në komunën tonë. Gjatë kësaj kohe është bërë shqyrtimi dhe janë bërë shumë përgjigje me kohë të kërkesave të qytetarëve për ndihma momentale financiare, prej të cilave 260 janë të miratuara. Ka vazhduar ofrimi i shërbimi mjekësor në dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc. Në Krushë të Madhe për momentin është duke u bërë renovimi dhe jemi bartur në Fortesë dhe punojmë deri në ora 21:00. Është duke vazhduar shërbimi mjekësor i kujdesit shtëpiak, i cili trajton të moshuarit dhe ata me sëmundje të rënda që e kanë të vështirë mobilitetin te QKMF-ja apo QMF-ja. Në QKMF - në Rahovec funksionon aparati i mamografisë, i cili ndihmon për të diagnostifikuar më herët kancerin e gjirit. Janë kryer shumë vizita sistematike të nxënësve në shkollat e komunës sonë. Vazhdon furnizimi me barna esenciale nga buxheti i komunës, vazhdon renovimi i objektit të QMF-së dhe është bërë përrurimi i objektit të QMF-së në Ratkoc.

Burim Krasniqi: Drejtoreshë, faleminderit për informatën. Te informatat e shërbimeve sociale, i kemi disa shifra që ndonjëherë janë shqetësuese. Për gjashtëmujorin e parë janë 7 fëmijë të keqtrajtuar, 30 fëmijë me punë të rënda. 9 fëmijë me sjellje sociale dhe 15 fëmijë delikuentë. Besoj që kur të vjen raporti njëvjeçar mundësisht të ketë raport krahasues me vitin paraprak, që të mund të shohim nëse ka trend të rritjes apo të rënies. E dyta, ashensori në QKMF, a ka kontratë të mirëmbajtjes? Dje kam qenë me familjarë, nuk ka punuar dhe sot nuk punon gjithashtu. Analizat janë në kat të dytë, repartin e Gjinekologjisë e keni ende më lart dhe me një formë dje dhe sot nuk ofrohen shërbimet normale, për shkak të pamundësisë të qasemi aty. Kur pritet ashensori të kthehet në funksion? Shqetësimi i fundit:

Para disa dite u.d së drejtorit të QKMF-së në Rahovec, i ka ftuar 3 mjekë dhe iu ka kërkuar dorëheqjen e tyre, me arsyetimin që nuk kanë marrë pjesë në diskutim për buxhetin kur ka qenë kryetari i komunës. Kur është kërkuar arsyeja e dorëheqjes, është thënë që është kërkesë e drejtoreshës së Shëndetësisë, sepse nuk keni marrë pjesë në debat publik me kryetarin e komunës dhe jeni të papërgjegjshëm. Nuk dua të besoj që qëndron kështu, kërkoj një sqarim nga ana juaj, se si mundet një drejtor të bëjë presion në këtë mënyrë te stafi shëndetësor. A qëndroni prapa kësaj dhe ju lutem shkoni në QKMF dhe bisedoni, si dhe mendoj që është e udhës të sqaroheni, sepse është e papranueshme joetike dhe e dëmshme për shoqërinë tonë.

Defrim Kafexhiu: Kisha pasë qejf ta dëgjoj si informatë prej drejtoreshës së Shëndetësisë, llogaridhënia e drejtorit të QKMF-së kundrejt drejtorisë së Shëndetësisë. Kemi dëgjuar edhe prej infermierëve dhe prej personave që punojnë në QKMF, që selektimi i njerëzve për ndërrimin e orareve, po bëhet për çështje inati të drejtorit. A jeni të njoftuar për këtë çështje dhe a është marrë ndonjë masë disiplinore ndaj tij? Një pyetje politike e kam, e keni pritë si Alencë në Rahovec që drejtori i QKMF-së ta përfundojë specializimin, që është kusht t'i nënshtrohet konkursit për drejtor të QKMF-së. Tani përveç qytetarëve, ju ka zhgënjyer edhe juve, nuk ka arritur të specializojë. A do ta pritni deri në aplikimin e radhës për specializim, apo do ta vazhdoni me ndonjë figurë tjetër që po ashtu kemi informata që mund të ndodh?

Vlora Vuçiterna: Një pyetje të shkurtë në lidhje me barna, a keni kontratë me furnitorin, sa është vlara dhe kush është furnitori? A është pikë farmaceutike apo ndonjë barnatore?

Saranda Sallteku: Faleminderit! Burim, sa i përket liftit, e kemi lajmëruar kompaninë dhe besoj që sot gjatë ditës do të rregullohet. Për ata 3 mjekë që the, nuk është e vertetë dhe nuk jam e informuar.

Burim Krasniqi: Drejtoreshë, unë të njoh moti, jo sot dhe nuk kam dashur të besoj që kjo është prej teje, por drejtori aktual i QKMF-së i ka thënë 3 mjekëve që duhet të japim dorëheqje, sepse nuk kanë qenë në dëgjimin buxhetor të kryetarit me stafin mjekësor.

Saranda Sallteku: Vlorë, sa i përket barnave esenciale, kemi kontratë dhe është deri në tetor të këtij viti. Vlora është 65.000€ dhe janë ndarë në një lot, me reagenca dhe me material shpenzues. Për furnitor nuk e di. Sa i përket pyetjes politike të Defrimit, unë jam me të gjithë, sepse ndryshe nuk do i merrja 700 vota.

Kryetari: Drejtoresha e Drejtorisë për Përkujdesje sociale përfaqëson, mbron, justifikon dhe realizon politikat komunale për shëndetësi dhe përkujdesje sociale. Ne i vlerësojmë shumë mjekët dhe personalin shëndetësor në QKMF, për përgjegjësitë dhe punën e tyre. Ne përfaqësojmë politikën e avancimit në karrierë të profesionistëve shëndetësorë. Në politikën tonë ka ardhur një moment dhe kam kërkuar nga drejtoresha që megjithatë duhet të ndodh një ndryshim cilësor në pikëpamje të vendimmarrjes brenda institucionit. Nuk mund të jetë koordinator për performancë në të gjitha shërbimet mjekësore vetëm një njeri dhe atë 20 vjet. Nuk është çështja e pjesëmarrjes në debat publik, çështja është më e thellë, sepse është një praktik joobligative ligjore që unë i bëj takimet periodite me punëtorët shëndetësorë, që realisht bëhet fjalë për planifikimin e hershëm buxhetor. Kur unë shkoj aty, shefi i sektorit flet ndryshe, puntori i atij sektori flet ndryshe. Është një komunikim jo të mjaftueshëm edhe brenda sektorëve dhe ne kemi thënë që le ta bëjmë ndryshim që duke mos iu ndërruar statusin, le të ndërrohen disa dhe le të vijnë të tjerë, por jo specifikisht kush e tek. Ky është mesazh, a do të ndodh apo jo, ne nuk mund ta bëjmë vet, sepse ata e kanë statutin e QKMF-së. U.d të drejtorit të QKMF-së është brenda këtij mesazhi dhe duke qenë një mjek i ri dhe mund t'ju them që më mirë punët shkojnë në QKMF sot, se sa kur ka qenë drejtor me kompetenca të plota një personalitet i çmuar i shkencës mjekësore, z. Korenica. Pra, jemi duke luftuar që në QKMF, ta reflektojmë trendin e ecjes përpara. Respekt të plotë kanë të gjithë aty. Prishje të ashensorit mund të ketë dhe ka, ne kemi kontratë për servisim dhe duhet të rregullohet. Më pëlqejnë këto reagime se njëkohësisht i bëjnë më të përgjegjshëm ata që janë aty. Një gjë mund t'ju them që QKMF në Rahovec, ka kapacitete më shumë se sa që ka pasur, është shumë fleksibile në kryerjen e shërbimeve, ka zhvillime të reja, ka barna esenciale dhe gjithashtu edhe komuna ka impakt të madh aty. Kur kam ardhur unë në 2018, aty nuk kanë folur mjekët në mesveti për arsye qesharake. Tani ka një menaxhim dhe një gjendje të përmirësuar. Pritja dhe mos-hapja e konkursit nuk ka të bëjë vetëm me një emër, ne nuk e dijmë kur hapet dhe unë nuk e di a e ka dhënë testin a po jo, sepse nuk merrem me atë punë hiç. Sytë janë për të parë dhe vërehet që brenda QKMF-së ka lidhshmëri më të mirë dhe vazhdimisht punojmë

për shërbime të reja dhe aftësim profesional. Jemi duke e mbajtur situatën mirë me ushtrues detyre edhe pse e ka afatin edhe 3-4 muaj dhe më shumë nuk ka të drejtë, mund ta bësh një ushtrues detyre tjetër, po jo të njëjtin.

Burim Krasniqi: Je pak kundërthënës në fjalim! The që nuk është mirë, ka nevojë për ndërrim dhe the që, ka zhvillim, ka rritje, ka suksese, ka rezultate. A ka rezultate dhe që e kanë bërë punën mirë, apo nuk ka rezultate, e kanë bërë punën keq. E dyta, me aq sa kam informacion, personat përgjegjës kanë “aktemërim” nuk kanë kontratë. Aktemërimi garanton punë të përhershme, deri në pensionim. Nëse nuk ka qenë në rregullt, është dashur që deputetët e të gjitha partive të votojnë ligje për t’i bërë me mandat, sepse janë pozicione të ndishme dhe ka nevojë për freskim. E fundit, mendoj që në krejt botën, eksperiencia e zhvillon njeriun. Pozitat menaxheriale nuk janë punë praktike, janë pozicione që kërkojnë njerëz me eksperiencë. Nëse mendojmë t’i heqim njerëzit me eksperiencë, për t’i vendosur njerëzit e rinj për t’u mësuar ngadalë, është gabim. Në qoftëse kanë aktemërim, t’i hiqni është joligjore. Nëse themi që ka zhvillim në të gjitha aspektet në QKMF dhe në shërbimin primar shëndetësor, të themi na duhet ndërrimi, përsëri është gabim.

Kryetari: Në jetën time personale dhe aktualisht me përgjegjësi direkte publike, zakonisht nuk jam kontradiktor, as kundërthënës, bile antagonizmat i luftoj gjithë kohën. Padyshim që ka zhvillime cilësore të dukshme në krejt ecurinë e zhvillimeve në QKMF- në Rahovec dhe në të gjithë rrjetin e AMF-ve dhe QMF-ve. Ka zgjatje të shërbimeve shëndetësore, personale në rritje, pajisje të reja shëndetësore dhe më shumë shërbime shëndetësore dhe e gjithë kjo nuk mund të konsiderohet ndryshe përveç se sukses. Ndërrimi nuk ka lidhje me persona të përveçëm, por duhet të reflektojmë, por duhet të reflektojmë me një ndryshim edhe me kapacitetet vendimmarrëse të QKMF-së. Unë jam treguar i matur, sepse kam përvojë, e kam prituri deri sa ka dalur në pension doktorin e nderuar, z. Korenica. Ai ka qenë drejtor me kompetenca të plota, por nuk e ka dëgjuar askush në kuptimin e menaxhimit, sepse të gjithë të tjerët përreth e kanë konsideruar veten më të zotë në kuptimin e menaxhimit. Për tetë vite me mua, asnjëherë nuk e kam prekur asnjë shufër të sektorit. E ka parë nevojën e një ndryshimi, pa patur nevojë t’ia mohojmë eksperiencat, sepse ne po flasim vetëm për menaxhim. Në qoftëse kanë “aktemërim” dhe nuk e lejon ligji, “therrën në këmbë të shëndosh, askush nuk e fut”. Ne e bëjmë një hap me marrëveshje, sepse ka prej atyre që janë lodhur. Për atë përgjegjësi menaxheriale që e kanë, ata nuk paguhën më shumë, por, vetëm si specialistë. Është i nevojshëm ky ndryshim, sepse është e pamjaftueshme ajo që ndodh në disa sektorë të QKMF-së.

Sejfullah Sejfullahu: Po flas, po “inshallah” nuk kthehet kryetari për përgjigje, sepse i bën gjatë. Realisht nuk është fusha ime e mjekësisë, por puna e liftit, mendoj që operatori në fillim duhet ta vendos një lift më të mirë. Në 2004 më ka ndodhur në spital të Prishtinës, është prishur lifti duhet e mbajtur “xhenazen” te poshtë, veç shpirti im i din ato përjetime. E dyta, a është rritur numri i lindjeve në QKMF dhe sa është dallimi me atë se kur kanë qenë subvencionet më të vogla dhe e treta, the për riorganizim të brendshëm, me aq sa jam i informuar, një gjë e tillë është e ndaluar prej gjykatës së apelit dhe jam kureshtar ta di nëse ka diçka të tillë.

Saranda Sallteku: Gjatë vitit të kaluar kanë qenë 23 lindje gjithë vitin, tani deri dje janë 18. Sa i përket riorganizimit, bashkë me këshillin drejtues, orarin e punës e bën drejtori i QKMF-së me kryeinfermierin.

13. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Arsim rreth përfundimit të vitit mësimor 2023/2024;

Nënkryetari: I nderuar kryesues, kryetar, të nderuar kuvendarë, drejtorë. Në mungesë të drejtorit, po e prezantoj shkurtimisht raportin e Drejtorisë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2023-2024. Raporti është i ndarë në 4 periudha. Shtator – nëntor janë të paraqitura të gjitha punën që kanë përfunduar. Riparimet në shkolla, ekonomizimi, garat e diturisë, olimpiada e matematikës dhe fizikës, pajisjet me mjete konkretizimi dhe pajisjet laboratorike që janë vendosur nëpër shkolla, dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shkollore, vizitat sistematike etj... Raporti ka edhe fotografi dhe nëse eventualisht ka ndonjë pyetje, ato që i dimë do të përgjigjemi, për të tjerat, e presim drejtorin.

Leonard Morina: Në informatën e DKA-së, të paraqitura më shumë ka investime kapitale, sesa ka të bëjë me mësimdhënien, mësimnxënien, mungesat e nxënësve, trajnimin e mësimdhënësve. Mendoj që investime duhet të jenë poshtë informatës. Në 17 pikat e para përmenden investimet kapitale. Te kjo informatë më ra në sy dhe nuk më pëlqej, klasën e 9-të e kanë përfunduar 547 nxënës. Në vitin e parë që janë regjistruar i kemi 280 në klasë të 10. Afër 50% e nxënësve nuk ndalen në shkollat e Komunës së Rahovecit. Cilat janë arsyeja? Për mendimin tim, janë dy arsye: Njëra mund të jetë për shkak të mungesës së drejtimeve që ata i kërkojnë, ose mund të jetë ky imazh i keq që është krijuar

për shkollat e mesme në Komunën e Rahovecit, gjë që nuk e besoj që është, por qytetet tjera dijnë të punojnë më mirë ndoshta me propagandë. Te pjesa e dytë, kërkoj prej drejtorisë së Arsimit dhe prej kryetarit të komunës të rregullohet imazhi i shkollave të mesme, sepse në qoftëse 50% të nxënësve nuk e dëshirojnë regjistrimin në këto shkolla të mesme, është problematike për të ardhmen. Besoj që të gjithë duhet të angazhohemi që kjo pasqyrë të ndryshohet.

Kryetari: Leonard, i përmende dy faktorë që ndikojnë: I pari, që njerëzit mund të kenë nevojë për drejtimit që mungojnë në shkollat tona të mesme. Drejtimit e reja dhe të nevojshme i jep Ministria e Arsimit, kuptohet me lobime në bazë të orientimit të nxënësve në karrierë. I dyti, përzgjedhja e kolegjeve private, për mua është shqetësues që këtë që janë a po arrijnë të marrin mjaftueshëm atë që duhet. Shkollat e mesme të ne në Kosovë janë qëllim i madh dhe njëkohësisht sfidë e madhe. Jemi të kënaqur me programet që i ka aplikuar komuna, qoftë me efikasitet, qoftë me investimet tjera dhe gjendja fizike e objekteve është 100% më mirë. Besoj që për të gjitha paqartësitë tjera, Avniu kur të vjen ju përgjigjet.

Nënkryetari: Besoj që infrastruktura në shkolla kurrë nuk ka qenë më e mirë dhe më moderne. Te mësimnxënie dhe mësimdhënia i takon më shumë atyre, sepse ata marrin secili nga një pagë dhe secili e ka pranuar ta nënshkruajë kontratën për atë punë, njëjtë siç e bëjmë ne këtu. Arsimitarët, mësuesit dhe profesorët janë të obliguar t'i edukojnë nxënësit. Përndryshe, pajtohem me ty që në këtë raport të Drejtorisë së Arsimit, t'i kemi edhe mungesat e nxënësve dhe arsimtarëve në secilën shkollë. Nëse i dënojmë nxënësit për mungesa, duhet ta bëjmë të njëjtë gjë edhe me arsimtarët dhe mendoj që çdo shkollë duhet ta aplikojë këtë sistem të punës.

14. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit të Punës së Zyrës së Prokurimit, janar-qershor 2024;

Kryetari: Shefi i Prokurimit gjithashtu ka gazmend familjar në familje. E mora përsipër ta lexoj raportin e zyrës. Ai e ka bërë një raport të shkurtër për këtë gjashtëmujor, thotë se janë 43 aktivitete të prokurimit, 31 kontrata të nënshkruara të të gjitha llojeve të prokurimit me vlerë 1.373.4693.68€. Tri aktivitete të prokurimit janë në OSHP, nga 2 prej këtyre ekspertit i OSHP-së i ka dhënë të drejtë autoritetit kontraktues. Personeli i zyrës së prokurimit ka proceduar 588 urdhër-blerje. Një procedurë është jashtë planit të prokurimit, sepse e kemi një memorandum mirëkuptimi me një nga ministritë e linjës. Deri më tani për këtë gjashtëmujor plani i prokurimit është 82% dhe mund të themi që komuna jonë është më e mira në nivel Kosove, sa i përket realizimit të veprimeve të planifikuara të prokurimit.

Leonard Morina: Meqenëse edhe në seancën e mëhershme ka munguar zyrtari i prokurimit. Vlera e parashikuar e kontratës ka qenë po e zëmë 100.000€ dhe kur ka ardhur puna për nënshkrim ka qenë çmimi i njëjtë. Në disa parashikimi që na ke thënë, ke thënë që ne mund t'i parashikojmë 20.000€, por, operatori mund të vie me 15.000 ta marrë kontratën. A ka konkurrencë aty dhe nëse ska pasur, pse bash kështu sakt të gjitha kontratat, a janë të negociuar apo çka është puna?

Kryetari: Kontratat njëburimore janë krejt ndryshe. Në qoftëse një njoftim rrin 25 ose 30 ditë si njoftim zyrtar, atëherë është e hapur dhe u jepet e drejta të aplikojnë të gjithë ata që janë të interesuar. Mund të aplikojë një operator, dy, dhjetë apo më shumë. Kemi rastë kur ka aplikuar veç një operator. Pse ka aplikuar veç një operator? Unë e di dhe nuk mund ta di, sepse nuk është punë e imja, por aplikimi është i hapur për të gjithë, konkurrenca gjithashtu.

15. Shqyrtimi i Informatës mbi parcelat publike të dhëna në shfrytëzim nga Kuvendi Komunal;

Kryetari: Ka qenë një kërkesë nga seanca e kaluar, që duhet t'i paraqesim se cilat janë atë prona që i japim në shfrytëzim me vendim të kuvendit dhe pastaj në ankand. E kemi një listë të pronave dhe pronarëve dhe ju lutem që ta mbani pak diskrete, sepse është vetëm për kuvend. Ka të dhëna se sa metra katror janë dhënë, sa është qeraja dhe cilët janë shfrytëzuesit. Kjo informatë është e dobishme edhe për transparencë.

Leonard Morina: Meqenëse kryetari tha t'i ruajmë këto të dhëna, nuk po flasim me emra. Por, nëse dikush e ka marrë në shfrytëzim për 10 vite, afati i ka përfunduar në vitin 2020, kur i është vazhduar kontrata, a ka qenë në ankand? Apo automatikisht pronari ka pasur të drejtë për vazhdim dhe a rinegocohet çmimi për vazhdim?

Kryetari: Zakonisht Agjencioni i Pyjeve e ka programin 5 +, nëse e ka pasur për pesë vjet, pesë të tjera i vazhdohet me automatizëm. Komuna i ka 2-3 qëllime që i vendosë përmes komisionit. Një nga kriteret është të rritet vlera e pronës. Në këtë rast kur t'i përfundon kontrata, duhet ta vendosim propozimin në kuvend, merret vendimi dhe shpallet ankandi. Kontrata nuk ka shansë t'i vazhdohet a priori askujt, përndryshe është ilegale.

15. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike në Komunën e Rahovecit;

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Ne edhe në seancën e fundit e kemi pasur, por në bazë të planit të punës së kuvendit, ka qenë një informatë për implementimin e planit për investime në hapësira publike. Në bazë të planit i kemi dy kontrata që operojnë në komunën e Rahovecit, me vlerë totale 222.000 dhe me afat dy vjet. Operojmë me 162 pozicione, që përfshihen në varreza, lapidare, hapësira të lira publike, ujitja e drunjve dekorativë etj... Nëse keni ndonjë kërkesë shtesë për pastrim në vendbanimet ku jeni, ju lutem drejtoheni në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Sejfullah Sejfullahu: Te kanalizimi që është duke u bllokuar, të intensifikohen më shumë punët rreth kësaj.

Kryesesi: Të nderuar anëtarë të kuvendit, nëse nuk keni pyetje tjera, ju falënderoj për vëmendjen tuaj dhe shihemi në mbledhjet tjera.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni



Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunes së Rahovecit

Njësia Nr./Br./No. 02(Kabineti i Kryetarit të Komunes)

Nr./Br./No. 4440 Nr. i faq./Br.sht./No.pg. 147

Data/Datum/Date 10 / 7 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023

Nr	Komponent a e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarre	Zyrtar përgjegjës	Data e planifi kuara e zbatim it të rekom andimi t	Koment e
1.	Çështja A1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve	Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Përmes pagesave direkte nga Thesari për vendime gjyqësore/përmbartimore, janë ekzekutuar 12 transaksione në vlerë 284,095€ për pagat jubilarë dhe shujtat, si dhe një transaksion për subvencione dhe transfere në vlerë 42,754€, të cilat janë realizuar nga kategoria e investimeve kapitale. Në këto dy raste, keqklasifikimi i shpenzimeve ishte në vlerë 326,894€. Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet. Ndërsa, pagesa e subvencioneve dhe e mallrave nga kategoria e investimeve kapitale ka ndodhur si rezultat i moszbatimit të drejtë të rregullave financiare që rregullojnë përdorimin e fondeve publike.	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) ashtu që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Ne do t'i ndërmarrim të gjitha veprimet e nevojshme për ndarjen e fondeve në të gjitha kategoritë ekonomike në mënyrë që të mos krijohen keqklasifikime, edhe pse disa herë keqklasifikimi po ndikohet edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm. Si për shembull: Thesari. Konsiderojmë që ky rekomandim do të jetë i zbatuar gjatë vitit 2024.	Drejtori për Buxhet dhe Financa, me drejtori të tjera përkatës.	2024	

2.	Çështja A2 - Mbivlerësi mi i detyrimeve kontingjente .	Bazuar në nenin 18 të Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore përcaktohet se: “Organizatat buxhetore në harmoni me LMFPF-në raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente” . Gjatë testimit të mostrave, kemi vërejtur se në nëntë (6) raste në vlerë 78,534€ detyrimet kontingjente ishin mbivlerësuar, si: - Në pesë (5) raste, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave (P/nr. 830/2023 në vlerë 24,010€, C.nr.102/2021 në vlerë 12,915€, P.nr.831/2023 në vlerë 3,018€, P.nr.271/2022 në vlerë 2,548€ dhe P.nr.269/2022 në vlerë 2,548€), komuna ka pranuar të vendime gjyqësore/ përmbarime dhe pagesat ishin duke u ekzekutuar; dhe - Lënda P.nr352/15 në vlerë 33,495€ e raportuar si detyrim kontingjent në PVF, nuk është detyrim i komunës, por borxh i një operatori ekonomik ndaj komunës. Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës.	Kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar regjistrin e detyrimeve kontingjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë dhe i plotë në PVF.	Rekomandimi të çështja A2 do të zbatohet gjatë vitit 2024, për të gjitha lëndët që kemi pranuar vendime gjyqësore, nuk ushtrohet prapësim, dhe janë në ekzekutim të largohen nga regjistri i detyrimeve kontingjente	Zyra Ligjore, Zyra Juridike, në bashkëpunim me drejtoritë përkatës e	2024
3.	Çështja A3 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë	Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 dhe 11.4 4, përcakton se: Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1, të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Ndërlidhur me këtë UA nr. 03/20211 për mbledhjen dhe regjistrimin e informative mbi pronën dhe tatimpaguesin, neni 7, paragrafi 1.1, kërkon numrin personal identifikues të tatimpaguesit fizik.. Pas analizës së bërë, kemi identifikuar se në raportin financiar të objekteve, janë identifikuar 428 tatimpagues që nuk kanë numër personal, për të cilët është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Kjo ka ndodhur për shkak të stafit të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë, ku nuk është arritur që të azhurnohen të dhënat në Protax.	Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të zbritjeve për vendbanim parësor.	Do të merren të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e tatimpaguesve të cilët nuk kanë numër personal identifikues dhe do të zbatohet gjatë vitit 2024.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Sektori i Tatimit në Pronë.	2024

4.	Çështja A4 - Kontraktim i projekteve të paparapara më buxhet, në mungesë të mjeteve financiare dhe zgjatja e afatit të realizimit të projekteve më të gjatë sesa ofertimi	Ligji i prokurimit publik nr. 04/L-042, nenin 9 paragrafi 3 taksativisht normon se, nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet a ardhshme fiskale do t’i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjisllacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla. LMFPP nr. 03/L-048 neni 36.1 përcakton se; Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK. Ligji i buxhetit nr. 08/L-193 për vitin 2023, neni 12 paragrafi 8 taksativisht normon se; nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2023 dhe për dy (2) vitet në vijim. Ndërlidhur me këtë, Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit FTD, pjesa IV.2 - Kriteret për dhënien e kontratës “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të kriterit 2 Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit të kontratës me poentim 0.2”. Kontraktimet e projekteve pa buxhet dhe zgjatja e afatit të realizimit të tyre më gjatë sesa ofertimi, janë identifikuar në këto raste, si në vijimi: • Projekti “Ndërtimi i qendrës rinore dhe kulturore në Rahovec” ishte kontraktuar me 20.10.2023 në vlerë 2,982,585€, ndërsa fondet ishin buxhetuar në PIP për tri vite në vlerë 800,351€ (për vitin 2023 në vlerë 150,351€, për vitin 2024 në vlerë 150,000€ dhe për vitin 2025 në vlerë 500,000€). Përveç kësaj, kemi vërejtur se edhe para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë zotimi fondeve të vitit aktual. Për më tepër, ishte udhëhequr procedurë e prokurimit më kriterin e dhënies së kontratës çmimi ekonomikisht më i favorshëm me poentim	Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë përputhje me shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim. Po ashtu, të ndërmarr masat e duhura për projektet e kontraktuara që, afati i të jetë sipas ofertimit për vlerësim të parapara në dosjen e tenderit.	Konsiderojmë se rekomandimi të çështja A4, do të zbatohet gjatë vitit 2024, se të gjitha kontratat do të mbulohen financiarisht me buxhetin e vitit 2025, si dhe me projektionet buxhetore 2026 dhe 2027.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Prokurim it.	2024
----	--	--	---	--	---	-------------

5.	Çështja A5 - Pranimi i furnizimit të autoambulancave jo në pajtim me dosjen e tenderit	Flota e të dhënave të dosjes së tenderit (FTD) në piken 2.1 taksativisht parasheh, blerjen e dy autoambulancave sipas specifikimeve teknike të detyrueshme, si dhe pika 4.1 Variantet nuk janë të autorizuar. UA (M1) 02/2018 për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore, nenin 2.1.1 përcakton se; automjetet motorike të projektuara dhe ndërtuara kryesisht për transportimin e personave dhe bagazheve të tyre dhe të cilat përveç ulëses së vozitësit nuk kanë më shumë sesa 8 ulëse – automjete të kategorisë M1, ndërlidhur me këtë, nenin 2.1.3 përcakton se; automjetet motorike të projektuara dhe ndërtuara kryesisht për transportin e mallrave, masa maksimale e të cilave nuk kalon 3.5 tonë – automjete të kategorisë N1, dhe neni 18 paragrafi 1.5 parasheh pëlqimi për regjistrim. Komuna ishte furnizuar me dy autoambulanca në vlerë prej 109,998€ të kategorisë N1. Pas verifikimit të dosjes së tenderit, kemi vërejtur që kërkesa ishte për dy autoambulanca të kategorisë M1, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme në dosjen e tenderit. Nga analiza e mëtejshëm e dokumentacionit, kemi konstatuar se është bërë ndryshim ose modifikim i autoambulancave nga kategoria e kërkuar N1 në M1 në Qendrën e Automjeteve të Kosovës-EUROLAB, certifikata e konformitetit ishte për autoambulancat në kategorinë N1 (automjete motorike të projektuara dhe ndërtuara kryesisht për transportin e mallrave, masa maksimale e të cilave nuk kalon 3.5 tonë), por jo për autoambulancat për transportimin e personave dhe bagazheve – automjete të kategorisë M1. Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të duhur të kontrolleve për të siguruar që furnizimi të jetë sipas kërkesave të kontratës dhe dosjes së tenderit.	Kryetari duhet të sigurojë që pranimi i furnizimeve të bëhet në sipas kushteve të dosjes së tenderit dhe kontratës.	Ky rekomandim do të zbatohet plotësisht gjatë vitit 2024.	Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyra e Prokurimit	
----	---	--	--	--	---	--

6.	Çështja B1 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale	Rregulla nr. 01/2022 për prokurim publik taksativisht në neni 70.23 pika b parashihet se menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Gjatë testimeve kemi vërejtur se në nëntë (9) kontrata publike për punë nuk ishin realizuar sipas afatit kohor të përcaktuar me kontratë dhe as nuk ishin aplikuar penalet për vonesat, si: - Projekti „Ndërtimi i ndërtesës së përbashkët për banim të familjeve me nevojë” – Faza përfundimtare, në vlerë 99,097€ e nënshkruar më 24.11.2022 do të duhej të përfundonin punimet për 140 ditë. Deri në situacionin e II-të të datës 02.05.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 70,048€ apo 70%, vonesa ishin deri 2 muaj. - Projekti „Trajtimi i shtretërve të përrrenjve në Komunën e Rahovecit” – Faza e parë, në vlerë 815,988€ e nënshkruar më 02.09.2020 do të duhej të përfundonte për 24 muaj. Deri në situacionin e V të datës 17.10.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 386,588€ apo 47%, që rezulton në vonesë rreth 13 muaj. - Projekti „Ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit Hardhfest” Faza e përfundimtare, në vlerë 156,605€ e nënshkruar më 08.07.2022 do të duhej të përfundonte për 210 ditë. Deri në situacionin e IV projekti ishte realizuar në vlerë 115,365€ apo 74%, që rezulton në vonesë rreth 6 muaj. - Projekti „Ndërtimi i shtratit të përroit në lagjen Kelmendi në Kramovik” në vlerë 266,034€, i nënshkruar më 09.09.2021 do të duhej të përfundonte për 320 ditë. Deri në situacionin e III të datës 03.02.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 224,154€ apo 84%, që rezulton në vonesë rreth 6 muaj. - Projekti „Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike të Rahovecit lot 2” në vlerë 356,152€ e nënshkruar më 25.10.2021 do të duhej të përfundonte për 300 ditë. Deri në situacionin e VI të datës 15.12.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 179,995€ apo 51%, që rezulton në vonesë rreth 15 muaj. - Projekti „Ndërtimi i parqeve në komunën e Rahovecit” në vlerë 288,963€ e nënshkruar më 15.09.2021 do të duhej të përfundonte për 500 ditë. Deri në situacionin e V të datës 30.05.2023	Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuara të aplikohen penalet e parapara me kontratë.	Shpresojmë që ky rekomandim do të zbatohet pjesërisht, me gjasë edhe tërësisht gjatë vitit 2024, sepse menagjerët e kontratave do të ndërmarrin veprimet e duhura për përfundimin e punimeve në terren.	Zyra e Prokurimit, dhe drejtoritë përkatëse.	2024
----	---	--	--	--	---	-------------

[illegible]

8.	Çështja B3 – Vonesa në pagesën e obligimeve financiare	LMFPP nr. 03/L-048, neni 39 përcakton që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për punët, mallra dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Gjatë auditimit të pagesave, kemi identifikuar se 11 pagesa në vlerë 444,437€, nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturave. Vonesat ishin nga 2 javë deri në 2 vite. Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore, si dhe kontrolleve jo adekuate në menaxhimin e obligimeve.	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda afatit kohor ligjor.	Gjatë vitit 2024, prioriteti i yni ka qenë pagesa e faturave brenda afatit të caktuar prej 30 ditësh, dhe i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet për pagesën e faturave dhe respektimin e LMFPP nr. 03/L-048, dhe konsiderojmë që ky rekomandim do të jetë i zbatuar deri në fund të vitit 2024.	Drejtoria për Shëndetësi, Zyra e Prokurimit dhe drejtoritë përkatëse e.	2024
----	--	---	---	--	--	------



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No	4541	Nr. i faq./Br.str/No.pg 158
Data/Datum/Date	31 / 7 / 24	
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 4, nenit 5, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/2019), nenit 4, nenit 8, nenit 9, dhe nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, u:

P R O P O Z O N

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Komunës së Rahovecit dhënien e **Pëlqimit** për Dhënien e Pronës me qira për 15 vjet (pesëmbëdhjetë vjet), e cila gjendet në Rahovec, në sipërfaqe prej 1276m² (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë metra katror), e cila gjendet në njësinë kadastrale: P -71510057-05058-0, në vendin e quajtur **Krajishte, sipas certifikatës së pronësisë – Pronë shoqërore, Komuna e Rahovecit.**
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë, si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral, do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
5. Ky propozim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510057-05058-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

08-942/03-0019146/24

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

16.05.2024 - 12:38

Komuna / Opština / Municipality:

RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Rahovec / Orahovac / Rahovec

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:


RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Superfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510057-05058-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	1276			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
KRAISITË KOMUNA E RAHOVEC RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC				



A.2 LLOJI I SHRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina Area (m ²)
1	Bujqësore/Pojtoprivrečno/Agriculture	Kullosar/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 5/Pasnjak 5 Klase/5th Class Pasture	1276

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Rahovecit	600535233	RAHOVEC/ ORAHOVAC/ RAHOVEC/		DËSHMORËT E PASHTRIKUT	1/1		






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN


Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rahovec

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510057-05058-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1276



Shkalla/Razmera/Scale: 1:478

Punoi/Obradio/Created: Albina Durguti
Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____
Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 31.07.2024
Koha/ Vreme/ Time: 03:16:15

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Albina.Durguti




Z.K. RAHOVEC.

↓
05058-0
KOMUNA RAHOVEC
1276m².

↓
RUGA
TRANZITĚ
C.K. RAHOVEC



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNA E RAHOVECIT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komuna e Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komuna e Rahovecit (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komuna e Rahovecit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve në vlerë 326,894€ nga kategori ekonomike jo adekuate. Nga investimet kapitale ishin ekzekutuar pagesa në shumë 326,849€ nga thesari për vendime gjyqësore/përmbartimore për të paguara për pagat jubilarë dhe shujta në vlerë 284,095€, si dhe një pagesë për subvencionim në vlerë 42,754€.
- A2 Shpalosjet e detyrimeve kontigjente nuk ishin të plota dhe të sakta ngase ishin mbivlerësuar për 78,534€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komuna e Rahovecit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Komuna ka zbatuar zbritjen në tatim në pronë për banim primar pa të dhënat përkatëse.
- A4 Kontraktimi i projekteve të paparapara më buxhet, në mungesë të mjeteve financiare dhe zgjatja e afatit të realizimit të projekteve më të gjatë sesa ofertimi.
- A5 Pranimi i furnizimit të autoambulancave jo në pajtim më dosjen e tenderit
- B1 Vonesa në realizimin e projekteve.
- B2 Regjistrimi i urdhër blerjeve në SIMFK pas pranimit të faturave.
- B3 Vonesa në pagesën e obligimeve financiare.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komuna e Rahovecit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komuna e Rahovecit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komuna e Rahovecit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komuna e Rahovecit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohem ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komuna e Rahovecit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF). Pas kërkesës sonë disa çështje të ngritura në PVF-të janë korrigjuar dhe dorëzuar në MF. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në, të hyra, detyrime kontigjente, ekzekutimin dhe klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e projekteve kapitale si dhe në procedurat e prokurimit publik të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore ishte 919,025€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 695,310€, ndërsa 223,715€ ishin shpenzime shtesë procedurale të gjykatës/përmbartimit.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja dhe tre (3) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Përmes pagesave direkte nga Thesari për vendime gjyqësore/përmbartimore, janë ekzekutuar 12 transaksione në vlerë 284,095€ për pagat jubilarë dhe shujtat, si dhe një transaksion për subvencione dhe transfere në vlerë 42,754€, të cilat janë realizuar nga kategoria e investimeve kapitale. Në këto dy raste, keqklasifikimi i shpenzimeve ishte në vlerë 326,894€.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet. Ndërsa, pagesa e subvencioneve dhe e mallrave nga kategoria e investimeve kapitale ka ndodhur si rezultat i moszbatimit të drejtë të rregullave financiare që rregullojnë përdorimin e fondeve publike.

Ndikimi Keq klasifikimi i shpenzimeve rezulton me pasqyrimin jo të drejtë dhe të saktë të shpenzimeve në PVF, rrjedhimisht mund të shpie në keqkuptim të

pozitës financiare të komunës më mbivlerësim/ nënvlerësim të kategorive ekonomike.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridentinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) ashtu që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente.

Gjetja

Bazuar në nenin 18 të Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore përcaktohet se: “Organizatave buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente”.

Gjatë testimit të mostrave, kemi vërejtur se në nëntë (9) raste në vlerë 78,534€ detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar, si:

- Në pesë (5) raste, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave (P/nr. 830/2023 në vlerë 24,010€, C.nr.102/2021 në vlerë 12,915€, P.nr.831/2023 në vlerë 3,018€, P.nr.271/2022 në vlerë 2,548€ dhe P.nr.269/2022 në vlerë 2,548€), komuna ka pranuar të vendime gjyqësore/ përmbarime dhe pagesat ishin duke u ekzekutuar; dhe
- Lënda P.nr.352/15 në vlerë 33,495€ e raportuar si detyrim kontingjent në PVF, nuk është detyrim i komunës, por borxh i një operatori ekonomik ndaj komunës.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës.

Ndikimi

Mos shpalosja e saktë dhe e plotë e detyrimeve kontigjente ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre dhe mund të shpie në keqkuptimin e pozitës financiare të komunës.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë dhe i plotë në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 dhe 11.4 4, përcakton se: Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1, të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Ndërlidhur me këtë UA nr. 03/20211 për mbledhjen dhe regjistrimin e informative mbi pronën dhe tatimpaguesin, neni 7, paragrafi 1.1, kërkon numrin personal identifikues të tatimpaguesit fizik..

Pas analizës së bërë, kemi identifikuar se në raportin financiar të objekteve, janë identifikuar 428 tatimpagues që nuk kanë numër personal, për të cilët është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Kjo ka ndodhur për shkak të stafit të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë, ku nuk është arritur që të azhurnohen të dhënat në Protax.

Ndikimi

Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përlogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të zbritjeve për vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Kontraktimi i projekteve të paparapara më buxhet, në mungesë të mjeteve financiare dhe zgjatja e afatit të realizimit të projekteve më të gjatë sesa ofertimi

Gjetja

Ligji i prokurimit publik nr. 04/L-042, nenin 9 paragrafi 3 taksativisht normon se, nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritët të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla. LMFP nr. 03/L-048 neni 36.1 përcakton se; Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK. Ligji i buxhetit nr. 08/L-193 për vitin 2023, neni 12 paragrafi 8 taksativisht normon se; nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2023 dhe për dy (2) vitet në vijim. Ndërlidhur me këtë, Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit FTD, pjesa IV.2 -Kriteret për dhënien e kontratës “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të kriterit 2 Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit të kontratës me poentim 0.2”.

Kontraktimet e projekteve pa buxhet dhe zgjatja e afatit të realizimit të tyre më gjatë sesa ofertimi, janë identifikuar në këto raste, si në vijimi:

- Projekti “Ndërtimi i qendrës rinore dhe kulturore në Rahovec” ishte kontraktuar me 20.10.2023 në vlerë 2,982,585€, ndërsa fondet ishin buxhetuar në PIP për tri vite në vlerë 800,351€ (për vitin 2023 në vlerë 150,351€, për vitin 2024 në vlerë 150,000€ dhe për vitin 2025 në vlerë 500,000€). Përveç kësaj, kemi vërejtur se edhe para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë zotimi fondeve të vitit aktual. Për më tepër, ishte udhëhequr procedurë e prokurimit më kriterin e dhënies së kontratës çmimi ekonomikisht më i favorshëm me poentim 20% për planin dinamik, ku operatori ekonomik fitues në planin/afatin e realizimit të projektit e kishte paraparë për 450 ditë, ndërsa në kushtet e veçanta të kontratës komuna e kishte zgjatur afatin për realizimin e projektit në 960 ditë.
- Projekti “Ndërtimi i rrugëve në hapësirat për biznes dhe turizëm” e kontraktuar me 05.10.2023 në vlerë 1,894,482€, nuk ishte i planifikuar në ligjin për ndarje buxhetore dhe as në tabelën 4.2 financimi i investimeve kapitale. Për më tepër, ishte udhëhequr procedurë e prokurimit më kriterin e dhënies së kontratës çmimi ekonomikisht më i favorshëm me poentim 20% për planin dinamik, ku operatori ekonomik fitues në planin/afatin e realizimit të projektit e kishte paraparë për 225 ditë dhe mbi këtë bazë është shpallur i përgjegjshëm, ndërsa në kushtet e veçanta të kontratës komuna e kishte zgjatur afatin në 480 ditë.
- Projekti “Ndërtimi i rrugëve lokale lloti 1” e kontraktuar me 01.11.2023 në vlerë 898,601€. Kemi vërejtur se para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë zotimi fondeve të vitit aktual, ishte

udhëhequr procedurë e prokurimit më kriterin e dhënies së kontratës çmimi ekonomikisht më i favorshëm me poentim 20% për planin dinamik, ku operatori ekonomik fitues në planin/afatin e realizimit të projektit e kishte paraparë për 225 ditë, ndërsa në kushtet e veçanta të kontratës komuna e kishte zgjatur afatin në 480 ditë.

- Projekti “Ndërtimi i shtegut të ecjes dhe turizmit në Rahovec, Drenoc, Polluzhë, Xerxë-Opterushë” e kontraktuar me. 23.11.2023 në vlerë 119,595€, ndërsa fondet e buxhetuar në PIP për tri vite ishin në vlerë 45,000€ (për vitin 2023 në vlerë 25,000€, dhe për 2024 në vlerë 20,000€). Për më tepër, para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë zotimi i plotë i fondeve të vitit aktual.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre, hyrja në obligime për projekte të paplanifikuara, si dhe zgjatja e afatit të implementimit të kontratave jo përputhje me kërkesat rregullative.

Ndikimi

Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, nënshkrim i kontratave për tej limiteve buxhetore dhe hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare të komunës ngase duhet të bëhen shumë përshtatje buxhetore dhe ri destinime të mjeteve për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve. Po ashtu zgjatja e afateve në realizimin e kontratave ka efekt në performancën e komunës, përveç që pamundëson realizimin e projekteve sipas planit, rritë edhe rrezikun e kostove shtesë për shkak të padive që mund të bëjnë kontraktorët në rast të mos pagesës së obligimeve për punët dhe furnizimet e realizuara.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë përputhje me shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim. Po ashtu, të ndërmarr masat e duhura për projektet e kontraktuara që, afati i të jetë sipas ofertimit për vlerësim të parapara në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A5 - Pranimi i furnizimit të autoambulancave jo në pajtim më dosjen e tenderit

Gjetja

Fleta e të dhënave të dosjes së tenderit (FTD) në piken 2.1 taksativisht parasheh, blerjen e dy autoambulancave sipas specifikimeve teknike të detyrueshme, si dhe pika 4.1 Variantet nuk janë të autorizuara. UA (MI) 02/2018 për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore, nenin 2.1.1 përcakton se; automjetet motorike të projektuara dhe ndërtuara kryesisht për transportimin e personave dhe bagazheve të tyre dhe të cilat përveç ulëses së vozitësit nuk kanë më shumë sesa 8 ulëse - automjete të kategorisë M1, ndërlidhur me këtë, nenin 2.1.3 përcakton se; automjetet motorike të projektuara dhe ndërtuara kryesisht për transportin e mallrave, masa maksimale e të cilave nuk kalon 3.5 tonë - automjete të kategorisë N1, dhe neni 18 paragrafi 1.5 parasheh pëlqimi për regjistrim.

Komuna ishte furnizuar me dy autoambulanca në vlerë prej 109,998€ të

kategorisë N1. Pas verifikimit të dosjes së tenderit, kemi vërejtur që kërkesa ishte për dy autoambulanca të kategorisë M1, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme në dosjen e tenderit. Nga analiza e mëtejshëm e dokumentacionit, kemi konstatuar se është bërë ndryshim ose modifikim i autoambulancave nga kategoria e kërkuar N1 në M1 në Qendrën e Automjeteve të Kosovës-EUROLAB, certifikata e konformitetit ishte për autoambulancat në kategorinë N1 (automjete motorike të projektuara dhe ndërtuara kryesisht për transportin e mallrave, masa maksimale e të cilave nuk kalon 3.5 tonë), por jo për autoambulancat për transportimin e personave dhe bagazheve - automjete të kategorisë M1.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të duhur të kontroleve për të siguruar që furnizimi të jetë sipas kërkesave të kontratës dhe dosjes së tenderit.

Ndikimi Furnizimi me automjete të autoambulancave të modifikuara/ndryshuara nga furgonet dhe jo në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, rrit rrezikun keqpërdorimit të parasë publike dhe të sigurisë së shërbimeve që ofrohen me këto autoambulanca.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë që pranimi i furnizimeve të bëhet në sipas kushteve të dosjes së tenderit dhe kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Rregulla nr. 01/2022 për prokurim publik taksativisht në neni 70.23 pika b parashihet se menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë.

Gjatë testimeve kemi vërejtur se në nëntë (9) kontrata publike për punë nuk ishin realizuar sipas afatit kohor të përcaktuar me kontratë dhe as nuk ishin aplikuar penalet për vonesat, si:

- Projekti „Ndërtimi i ndërtesës së përbashkët për banim të familjeve me nevojë” - Faza përfundimtare, në vlerë 99,097€ e nënshkruar më 24.11.2022 do të duhej të përfundonin punimet për 140 ditë. Deri në situacionin e II-të të datës 02.05.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 70,048€ apo 70%, vonesa ishin deri 2 muaj.
- Projekti „Trajtimi i shtretërve të përrrenjve në Komunën e Rahovecit” - Faza e parë, në vlerë 815,988€ e nënshkruar më 02.09.2020 do të duhej të përfundonte për 24 muaj. Deri në situacionin e V të datës 17.10.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 386,588€ apo 47%, që rezulton në vonesë rreth 13 muaj.
- Projekti „Ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit Hardhfest” Faza e përfundimtare, në vlerë 156,605€ e nënshkruar më 08.07.2022 do të duhej të përfundonte për 210 ditë. Deri në situacionin e IV projekti ishte realizuar në vlerë 115,365€ apo 74%, që rezulton më vonesë rreth 6 muaj.
- Projekti „Ndërtimi i shtratit të përroit në lagjen Kelmendi në Kramovik” në vlerë 266,034€, i nënshkruar më 09.09.2021 do të duhej të përfundonte për 320 ditë. Deri në situacionin e III të datës

03.02.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 224,154€ apo 84%, që rezulton më vonesë rreth 6 muaj.

- Projekti „Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike të Rahovecit lot 2” në vlerë 356,152€ e nënshkruar më 25.10.2021 do të duhej të përfundonte për 300 ditë. Deri në situacionin e VI të datës 15.12.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 179,995€ apo 51%, që rezulton më vonesë rreth 15 muaj.
- Projekti „Ndërtimi i parqeve në komunën e Rahovecit” në vlerë 288,963€ e nënshkruar më 15.09.2021 do të duhej të përfundonte për 500 ditë. Deri në situacionin e V të datës 30.05.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 194,369€ apo 67%, që rezulton më vonesë rreth 5 muaj.
- Projekti „Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit” në vlerë 155,959€ e nënshkruar më 08.07.2022 do të duhej të përfundonte për 120 ditë. Deri në situacionin e III të datës 06.12.2022 projekti ishte realizuar në vlerë 106,927€ apo 69%, që rezulton më vonesë rreth 2 muaj.
- Projekti „Rregullimi i varrezave të dëshmoreve dhe civileve lot 1” në vlerë 134,795€ e nënshkruar më 27.08.2020 do të duhej të përfundonte për 24 muaj. Deri në situacionin e IV të datës 10.05.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 121,217€ apo 90%, që rezulton më vonesë rreth 16 muaj; dhe
- Projekti „Riparimi i monumenteve kulturore dhe historike lot 1” në vlerë 130,015€ e nënshkruar më 20.09.2021 do të duhej të përfundonte për 430 ditë. Deri në situacionin e VIII të datës më 21.11.2023 projekti ishte realizuar në vlerë 87,792€ apo 68%, që rezulton më vonesë rreth 11 muaj.

Kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit jo të mirë të kontratave publike, si dhe për shkak të hyrjes në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore.

Ndikimi	Mos implementimi i kontratave publike brenda afateve kohore ka ndikim negativ në aspektin buxhetor dhe operacional, dhe reflekton drejtpërsëdrejti në mos ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve me kohë për qytetarët.
Rekomandimi B1	Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuara të aplikohen penalet e parapara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Urdhër blerjet pas pranimit të faturës apo pas pranimit të furnizimeve apo punëve

Gjetja	Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet e parasë publike, neni 22 specifikon se zotimi dhe urdhër blerja i paraprinë raportit të pranimit apo faturës. Gjatë testimit të 26 pagesa për investime kapitale në vlerë 1,090,793€, kemi vërejtur se urdhërblerjet ishin bërë pas pranimit të faturave dhe pas pranimit të punimeve. Vonesat në përgatitjen e urdhërblerjeve ishin nga 2 ditë deri në 2 vite.
---------------	---

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në përgatitjen e

urdhërblërjeve më kohë në SIMFK.

Ndikimi Përgatitja e urdhërblërjeve me vonese vështirëson zbatimin e drejtë të pagesave/kontratave dhe krijon paqartësi rreth urdhërësive për blerje dhe përcjelljes së afatit të liferimit.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që procesit të blerjeve apo porosisë për punë, furnizime dhe shërbime dhe punë të kontraktuara ti paraprijë përgatitja e zotimit dhe aprovimi i urdhërblërjeve në SIMFK.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare

Gjetja LMFPP nr. 03/L-048, neni 39 përcakton që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për punët, mallra dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimi të faturës.

Gjatë auditimit të pagesave, kemi identifikuar se 11 pagesa në vlerë 444,437€, nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimi të faturave. Vonesat ishin nga 2 javë deri në 2 vite.

Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore, si dhe kontrolleve jo adekuate në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi Mos pagesa më kohë e obligimeve financiare rritë rrezikun e ankesave apo padive të mundshme të kontraktuesëve, dhe kjo mund të shkaktojë kosto shtesë financiare për komunën.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesëve të paguhet brenda afatit kohor ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	17,548,240	20,465,815	20,385,685	15,648,597	15,041,586
Grante Qeveritare - Buxheti	16,102,637	17,585,817	17,536,263	13,217,112	13,193,192
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	102,049	46,852
Të bartura nga viti i kaluar	0	490,416	482,531	534,009	452,593
Të hyrat vetanake	1,445,603	1,445,603	1,423,641	1,167,754	937,785
Donacionet vendore	0	634	0	9,973	4,177
Donacionet e jashtme	0	943,346	943,249	617,701	406,988

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,917,575€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së grantit të qeverisë për 1,483,180€, rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak për 490,416€, rritjes së donacioneve të brendshme për 624€, si dhe rritjes së donacioneve të jashtme për 943,346€.

Në vitin 2023, komuna ka shpenzuar 99% të buxhetit final apo 20,385,685€, me një përmirësim rreth 5% në krahasim me vitin 2022.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	17,548,240	20,465,815	20,385,685	15,648,597	15,041,586
Pagat dhe mëditjet	8,503,088	9,986,268	9,985,339	7,610,165	7,602,730
Mallrat dhe shërbimet	2,203,829	2,279,923	2,279,307	1,848,923	1,721,164
Komunalitë	370,000	370,000	370,000	269,364	280,322
Subvencionet dhe transferet	820,000	837,268	833,859	342,704	476,200
Investimet Kapitale	5,651,323	6,992,356	6,917,179	5,577,441	4,961,170

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,483,180€. Rritja ishte si rezultat i vendimeve të qeverisë.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 76,094€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura.
- Buxheti final për shpenzime komunale nuk ka pasur ndryshime.
- Buxheti final për subvencione ishte rritur për 17,268€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura.
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 1,341,033€. Rritja ishte si rezultat i të hyrat e bartura për 397,054€, si dhe nga donacionet e jashtme për 943,979€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2023 ishin 1,808,491€ apo rreth 41% më shumë se vitin paraprak. Struktura e hyrave përbëhet nga të hyrat e tatimit në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	1,445,603	1,445,603	1,808,491	1,278,159	1,174,111
Të hyrat tatimore	790,514	790,514	1,040,765	498,731	577,233
Të hyrat jo tatimore	655,089	655,089	767,004	757,632	595,406
Të hyrat tjera	0	0	722	21,795	1,472

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Komunës së Rahovecit ka rezultuar në 9 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna, si dhe ka përgatitur raportet periodike lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2022.

Deri në fund të auditimit për vitin 2023, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, dy (2) nuk është i aplikueshëm dhe katër (3) nuk ka filluar zbatim, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos pagesë me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore / përmbarimore ndaj komunës. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.	Kjo çështje është raportuar në kapitullin 2	Nuk është i aplikueshëm më

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Kontratat publike të mos nënshkruhen pa zotim paraprak të mjeteve në SIMFK dhe pa sigurim të ekzekutimit në afatin e përcaktuar. Planet e menaxhimi të përgatiten menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.	Në testet tona nuk kanë rezultuar më ceshtje të njejta.	I zbatuar
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në pajtim me kërkesat dhe procedurat e MFK-së, ashtu që i njëjti zyrtar të mos merr pjesë në dy apo më shumë faza të procesit.	Janë ndermarr veprimet e duhura.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuara të aplikohen penalet e parapara me kontratë.	Edhe këtë vit, janë identifikuar vonesa në realizim të projekteve.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që procesit të blerjeve apo porosisë për punë, furnizime dhe shërbime dhe punë të kontraktuara ti paraprijë përgatitja e zotimit dhe aprovimi i urdhërblereve në SIMFK.	Edhe këtë vit janë hasur raste si në vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave monitorojnë dhe pranojnë nga kontraktuesi garancinë e kualitetit të punimeve në afatin e përcaktuar me kontratë, para se të aprovjnë raportin për pagesën përfundimtare të punimeve.	Nuk kemi hasur në raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në kategoritë adekuatë të buxhetit apo të ri-destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme, dhe që pagesa e shpenzimeve të realizohet nga buxheti i kategorisë adekuatë ekonomike.	Keqklasifikim të shpenzimit ka pasur edhe këtë vit, por në vlerë jo materiale.	Nuk është i aplikueshëm më
8.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se te kontratat publike të kontraktuara përmes procedurës me çmim të peshuar, raporti i peshimit apo përqindjes së përcaktuar për kategoritë të jetë i njëjtë edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.	Nuk janë hasur raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
9.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhet brenda afatit kohor ligjor.	Edhe këtë vit kemi vonesa në pagesën e obligimeve.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Keq klasifikimi i shpenzimeve	Te pagesa në emër të subvencioneve dhe transfereve me vlerë prej 42,75400€, e cila është ekzekutuar nga Investimet Kapitale. Kjo pagesë është ekzekutuar nga ana e Thesarit në mënyrë të drejtpërdrejtë pa marrë mendimin nga komuna jonë. Ekzekutor në muajin Prill të vitit 2023, që bie në kundërshtim me ligjin e buxhetit të vitit 2023, prandaj te nderuar, duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, gjegjësisht Neni 15 Transferi i shumave të ndara buxhetore, pika 7. Në përjashtim të paragrafit 2. dhe 3. të këtij neni, asnjë transfer i ndarjeve buxhetore nuk mund të bëhet në kategorinë “Paga dhe Shtesa” nga ndonjë kategori tjetër e shpenzimeve pa aprovimin paraprak të Kuvendit. Përjashtimisht, në tre (3) mujorin e fundit, lejohet transferi sipas nenit 30 të LMFP-së nga kategoritë tjera në kategorinë “Paga dhe Shtesa”, vetëm atëherë kur mungesa e tillë në kategorinë “Paga dhe Shtesa” vjen si rezultat i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo përmbartimore të formës së prerë. Andaj konsiderojmë që na është bërë e pa drejtë.	Komentet e komunës nuk ndryshojnë ceshtjen e keqkualifikimit të ekzekutimit të pagesës, prandaj e gjetura mbetet e pandryshuar.
Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente.	MBIVLERËSIMI I DETYRIMEVE KONTIGJENTE Komentim i gjetjeve: Zyra Kombëtare e Auditimit në (nën) titullin e emërtuar si Çështja A2 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente në Draft Raportin e Auditimit, ka theksuar se: “Gjatë testimit të mostrave, kemi vërejtur se në nëntë (6) raste në vlerë prej 78,534.00€ detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar” Zyra për Përfaqësime Ligjore, në bashkëpunim me sektorin e	Komentet e Komunës nuk qëndrojnë asnjëri, sepse të gjitha këto lëndë kanë propozim/urdhëra përmbartimor të pa kontestueshme nga komuna. Prandaj e gjetura dhe rekomadimi mbeten të pandryshuara.

financave të Komunës së Rahovecit, jep këto komente, si në vijim:

I. Tre (3) rastet, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave:

1) Sqarim lidhur me rastin

P.nr.549/2023: Urdhri Përmbarimor

P.nr.549/2023 i datës 06.10.2023

është nxjerrë nga Zyra e

Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha

nga Prizreni me të cilin ka lejuar

përmbarimin e borxhit sipas

propozimit për përmbarim të

Kreditorit Mustafa Hoti, për borxhin

në vlerën prej 604.00 €.

Provë 1: Propozimi për Përmbarim dhe Urdhri Përmbarimor

P.nr.549/2023 dt.06.10.2023.

Konstatim: Në bazë të kësaj, mund

të konstatohet se borxhi nuk është

në vlerën prej 24,010.00 €, por në

vlerën prej 604.00 € në emër të

borxhit kryesor dhe në emër të

shpenzimeve procedurale në

shumën prej 474.22 € apo në

shumën e përgjithshme prej

1,078.00 €

Debitori Komuna e Rahovecit e ka

pranuar Urdhrin Përmbarimor

P.nr.549/2023 më datën 09.10.2023.

Me kërkesën e Zyrës Kombëtare të

Auditimit ka dorëzuar regjistrin e

lëndëve aktive në emër të borxhit

kontingjent më datën 09.10.2023.

Nga kjo mund të konstatohet se Zyra

e Përfaqësimeve Ligjore nuk ka

mundur të largojë lëndën

përmbarimore nga regjistri,

respektivisht nga raporti brenda një

dite pa kaluar afati për

prapësim/kundërshtim, pa pranim të

raportit të pagesës së kryer, pa

pranuar urdhrin për përfundimin e

procedurës përmbarimore të cilin

Zyra për Përfaqësime Ligjore e ka

pranuar më 30.11.2023 dhe në fund

pa bërë krahasimin e të dhënave për

mjetet e ekzekutuara në raport me

borxhin e lejuar me Aktgjykimin e

plotfuqishëm.

2) Sqarim lidhur me rastin

C.nr.102/2021: Lënda është

evidentuar pranë Zyrës së

Përfaqësimeve Ligjore të Komunës

së Rahovecit me numër C.nr.102/2021, ndërsa në Gjykatë është evidentuar me numrin C.nr.186/2020 sipas padisë së paditësve mësimdhënës Besim Morina, Bajram Morina, Bedri Morina, Ahmet Morina dhe Avdi Gashi për kompensimin e pagave jubilarë, shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit. Sipas Aktgjykimit C.nr.186/2020 dt.02.09.2021 të Gjykatës Themelore Gjakovë - Dega në Rahovec, kërkesëpadia e paditësve është aprovuar në tërësi. Komuna e Rahovecit ka ushtruar mjetin e rregullt juridik, ndërsa Gjykata e Apelit, me Aktgjykim Ac.nr.833/2022 dt.15.01.2024 ka aprovuar pjesërisht ankesën e Komunës së Rahovecit, të cilin Aktgjykim e kemi pranuar më 27.02.2024.

Pas verifikimit për pagesat e dyfishta për të njëjtën bazë juridike, kemi konstatuar se paditësi Bedri Morina tashmë është kompensuar për të njëjtën bazë juridike e që është shpërblimi jubilar për 45 vitet e përvojës së punës sipas aktgjykimit C.nr.679/2021.

Prandaj, me qëllim të nxjerrjes së provave lidhur me kërkesëpadinë e dyfishtë dhe parandalimin e pagesës me mjetet ligjore, kjo lëndë nuk është larguar nga regjistri, ngase në fund do të ndryshojë vlera e tërësishme e kontestit.

Provë 2: Aktgjykimit C.nr.186/2020 dt.02.09.2021 të Gjykatës Themelore Gjakovë - Dega në Rahovec; Aktgjykim Ac.nr.833/2022 dt.15.01.2024 i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykim C.nr. C.nr.679/2021 dt.10.05.2022 me të cilin vërtetohet pagesa e dyfishtë për të njëjtën bazë juridike-shpërblimi jubilar për mësimdhënësin Bedri Morina.

3) Sqarim lidhur me rastin P.nr.831/2023: Urdhri Përmbarimor P.nr.831/2023 i datës 13.12.2023 është nxjerrë nga Zyra e Përmbaruesit Privat Gjokë Radi nga

Gjakova, me të cilin ka lejuar përmbarimin e borxhit sipas propozimit për përmbarim të Kreditorëve Hajrije Gjoshi dhe Afijete Shllaku, për borxhin në vlerën prej 3,018.00 €.

Provë 3: Propozimi për Përmbarim dhe Urdhri Përmbarimor P.nr.831/2023 i datës 13.12.2023. Më datën 15.12.2023 Debitori Komuna e Rahovecit e ka pranuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.831/2023 i datës 13.12.2023. Andaj, theksojmë se Zyra e Përfaqësimeve Ligjore nuk ka mundur të largojë lëndën përmbarimore nga regjistri, respektivisht nga raporti pa kaluar afati për prapësim/kundërshtim, pa pranim të raportit të pagesës së kryer, pa pranuar urdhrin për përfundimin e procedurës përmbarimore të cilin Zyra për Përfaqësime Ligjore e ka pranuar më 29.02.2024 dhe në fund pa bërë krahasimin e të dhënave për mjetet e ekzekutuara në raport me borxhin e lejuar me Aktgjykimin e plotfuqishëm.

4) Sqarim lidhur me rastin P.nr.271/2022: Urdhri Përmbarimor P.nr.271/2022 i datës 09.06.2022 është nxjerrë nga Zyra e Përmbaruesit Privat Enis Hoxha nga Prizreni, me të cilin ka lejuar përmbarimin e borxhit sipas propozimit për përmbarim të Kreditorëve Ali Berisha, Shqipe Zenunaj, Isuf Rrahmanaj, Osman Morina, Hamza Krasniqi dhe Hysni Bytyqi, për borxhin në vlerën prej 2,080.00 €.

Më datën 02.08.2022 Përmbaruesi Privat ka dërguar Urdhrin për transferimin e mjeteve, por për shkak se Zyra për Përfaqësime Ligjore deri më tani nuk ka pranuar Urdhrin për përfundimin e procedurës përmbarimore dhe specifikacionin përkatës nga Thesari për pagesat e kryera, kjo lëndë ka mbetur ende në regjistrin e lëndëve përmbarimore.

Provë 4: Propozimi për Përmbarim

dhe Urdhri Përmbarimor
P.nr.271/2022 i datës 09.06.2022.
5) Sqarim lidhur me rastin
P.nr.269/2022: Urdhri Përmbarimor
P.nr.269/2022 i datës 09.06.2022
është nxjerrë nga Zyra e
Përmbaruesit Privat Enis Hoxha nga
Prizreni, me të cilin ka lejuar
përmbarimin e borxhit sipas
propozimit për përmbarim të
Kreditorëve Ali Berisha, Shqipe
Zenunaj, Isuf Rrahmanaj, Osman
Morina, Hamza Krasniqi dhe Hysni
Bytyqi, për borxhin në vlerën prej
2,080.00 €.

Më datën 02.08.2022 Përmbaruesi
Privat ka dërguar Urdhrin për
transferimin e mjeteve, por për
shkak se Zyra për Përfaqësime
Ligjore deri më tani nuk ka pranuar
Urdhrin për përfundimin e
procedurës përmbarimore dhe
specifikacionin përkatës nga Thesari
për pagesat e kryera, kjo lëndë ka
mbetur ende në regjistrin e lëndëve
përmbarimore. Në shkresat e lëndës
nuk ka Urdhër për përfundimin e
procedurës përmbarimore.

Provë 5: Propozimi për Përmbarim
dhe Urdhri Përmbarimor
P.nr.269/2022 i datës 09.06.2022.
KOMENT Lidhur me (5) rastet të
lëndëve përmbarimore: Zyra
Kombëtare e Auditimit në draft
raportin ka konstatuar se: "Komuna
ka pranuar vendime
gjyqësore/përmbarimore dhe
pagesat ishin duke u ekzekutuar".
Zyra për Përfaqësime Ligjore e
Komunës së Rahovecit, deri më tani
ka udhëhequr procedurën e
menaxhimit të lëndëve me shumë
kujdes, sidomos kur bëhet fjalë për
shpalljen e lëndës së caktuar të
kryer. Shpallja e lëndës së caktuar të
kryer (të përfunduar) nënkupton
largimin e lëndës nga qarkullimi
juridik dhe arkivimin e asaj lënde në
dosjen e lëndëve të arkivuara. Në
rastin e lëndëve përmbarimore, Zyra
për Përfaqësime Ligjore ka praktikë
të punës që, pasi të ketë pranuar
specifikacionin për pagesat e kryera
nga Zyra e Thesarit dhe Urdhrin për

përfundimin e procedurës përmbartimore nga zyra e caktuar përmbartimore, atëherë pas verifikimit të tërësishëm për rregullsinë e procedurës së kryer, një lëndë e caktuar përmbartimore shpallet e kryer dhe arkivohet në dosjen e lëndëve të kryera për vitin e caktuar. Nëse për një lëndë të caktuar përmbartimore, nuk është ushtruar prapësim/kundërshtim, nuk do të thotë se lënda duhet të shpallet e kryer. Kjo procedurë e menaxhimit të lëndëve dhe regjistrave bazohet në praktikën e krijuar në përputhje me procedurën për menaxhimin e lëndëve brenda Gjykatës Themelore.

II. Një (1) rast, që ka të bëjë me padinë për vërtetimin e pronësisë nga viti 1995:

6) Sqarim lidhur me rastin P.nr.352/2015: Lënda është evidentuar pranë Zyrës së Përfaqësimeve Ligjore të Komunës së Rahovecit me numër P.nr.39/2018, sipas kërkesës së Drejtorisë së Ekonomisë të Komunës së Rahovecit për zbatimin e vendimit të plotfuqishëm gjyqësor në bazë të detyrimit që kanë pasur subjektet ekonomike ndaj Komunës së Rahovecit.

Provë 9: Mbështjellëse e lëndës P.nr.39/2018.

Sa i përket çështjes në fjalë japim sqarim si në vijim: Zyra për Përfaqësime Ligjore mbanë regjistrat elektronikë të lëndëve të cilat regjistrat janë identik me regjistrat që mbajnë Gjykatat. Në këto regjistrat, janë të evidentuar të dhënat e përgjithshme e rasteve sipas renditjes në kolona me numrat rendor. Në regjistër të lëndëve përmbartimore, kolonat janë të renditura si vijon: Kreditori, (pasi që me propozim të kreditorit fillon procedura përmbartimore); Debitori; Dokumenti Përmbartimor; Shuma përmbartimore, Organi Përmbartimor (sipas ligjit mund të jetë gjykata përmbartimore apo Përmbartuesi Privat) dhe në fund kolona e përshkrimit të rastit. Në këtë rast, kur

është kërkuar regjistri i lëndëve përmbare, për të evidentuar borxhet kontigjente, Zyra për Përfaqësime Ligjore, ka dorëzuar regjistrin e lëndëve përmbare aktive, në të cilin regjistër është edhe lëndë në të cilën Kreditor është Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Ekonomisë. Përndryshe, në lëndën përmbare P.nr.352/2015, në mbështjellësen e lëndës shihet qartë se Kreditor është Komuna e Rahovecit, ndërsa debitor janë subjektet juridike ndaj të cilëve është iniciuar procedura përmbare me propozim të Drejtorisë së Ekonomisë.

KOMENT I PËRGJITHSHËM:

Komuna e Rahovecit është vërsuar nga numri i madh i padive të mësimdhënësve me bazë-zbatimi i Kontratave Kolektive të Arsimit. Gjykata Themelore Gjakovë - Dega në Rahovec, gjithashtu. Ndërmarrja e veprimeve procedurale kontestimore, siç janë: evidentimi i lëndëve (pasive) të pranuar, verifikimi i përgjithshëm dhe në veçanti verifikimi i provave të bashkëngjitura, përpilimi i përgjigjeve në padi, përcjellja e rastit, verifikimi i aktgjykimeve të pranuar, ushtrimi i mjetit juridik dhe përsëritja e veprimeve në procedurë përmbare siç janë: evidentimi i lëndëve (urdhrave) përmbare, krahasimi i propozim-kërkesës me vendimin gjyqësor, përpilimi eventuale i prapësimit/kundërshtimit, verifikimi i pagesave përmes THESARIT, identifikimi dhe evitimi i pagesave të dyfishta etj., janë veprimet të përditshme që kërkojnë angazhim dhe përkushtim të theksuar. Në të gjitha këto veprime procedurale, nuk përjashtohet mundësia e vonësive në menaxhimin e regjistrave të lëndëve nga të cilat regjistra gjenerohen raportet zyrtare, siç është në këtë rast raporti për borxhet kontigjente. Detyruesisht, duke qenë të mbingarkuar me lëndë të Kontratave Kolektive të Arsimit në këtë periudhë, Zyra për Përfaqësime Ligjore dhe Përfaqësuesi i

Autorizuar bëjnë përpjekje të vazhdueshme, duke i dhënë rëndësi të veçantë afateve ligjore të ndërlidhura me procedurat kontestimore dhe përmbarimore që janë afatet prekluzive në procedurat gjyqësore dhe jo vetëm.

Zyra për Përfaqësime Ligjore,
Shtojcë:

1) Provë 1, Rasti P.nr.549/2023:
Propozimi për Përmbarim dhe Urdhri
Përmbarimor P.nr.549/2023
dt.06.10.2023.

2) Provë 2, Rasti C.nr.102/2021:
Aktgjykimi C.nr.186/2020
dt.02.09.2021 të Gjykatës
Themelore Gjakovë - Dega në
Rahovec; Aktgjykim Ac.nr.833/2022
dt.15.01.2024 i Gjykatës së Apelit
dhe Aktgjykim C.nr.679/2021
dt.10.05.2022.

3) Provë 3, Rasti P.nr.831/2023:
Propozimi për Përmbarim dhe Urdhri
Përmbarimor P.nr.831/2023 i datës
13.12.2023.

4) Provë 4, Rasti P.nr.271/2021:
Propozimi për Përmbarim dhe Urdhri
Përmbarimor P.nr.271/2021 i datës
09.06.2022.

5) Provë 5, Rasti P.nr.269/2021:
Propozimi për Përmbarim dhe Urdhri
Përmbarimor P.nr.269/2021 i datës
09.06.2022.


Provë 6, Rasti P.nr.352/15:
Mbështjellëse e lëndës P.nr.352/15
(ZPL/P.nr.39/2018).

Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë	Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë Komenti i rekomandimit: Sipas të dhënave tona të gjeneruara në sistemin e Tatimit në Pronë-ProTax, nuk janë 428 tatimpagues pa numer personal, por janë gjithsej 269 tatimpagues (të bashkangjitur gjeni tabelën në Excel) nga ky numer disa janë tatimpagues të cilët janë të liruar nga nënshtetësia, që sistemi i Tatimit në Pronë nuk i gjeneron këto të dhëna (pa numer personal), disa tatimpagues janë nga komuniteti serb të cilët kanë migruar, që është e pamundur ti kontaktojm për marrjen e informatave, dhe disa tatimpagues-pronar tani më nuk janë në jetë që kemi veshtiersi për marrjen e informatave. Ku sipas konstatimit tuaj, citoj: *Pas analizës së bërë, kemi identifikuar se në raportin financiar të objekteve, janë identifikuar 428 tatimpagues që nuk kanë numër personal, për të cilët është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.* Atëher ju informojmë se sistemi ProTax nëse një tatimpagues nuk ka numer personal nuk lejon të rillogaritet që tatimpaguesi të ketë të drejtë të perfiton zbritjen prej 15,000. Andaj, kërkojm nga ju që Çështja A3 të hiqet si rekomandim nga draft raporti.	Komenti i Menaxhmentit të Komunës nuk qëndron, prandaj e gjetura jonë mbetet e pa ndryshuar dhe rekomandimi duhet të zbatohet.
--	---	---

Kontraktimi i projekteve të paparapara më buxhet, në mungesë të mjeteve financiare dhe zgjatja e afatit të realizimit të projekteve më të gjatë sesa ofertimi	Kontraktimi i projekteve të paparapara më buxhet, në mungesë të mjeteve financiare dhe zgjatja e afatit të realizimit të projekteve më të gjatë sesa ofertimi Komenti i rekomandimit: Projekti “Ndërtimi i shtegut të ecjes dhe turizmit në Rahovec, Drenoc, Polluzhë, Xerxë-Opterushë” e kontraktuar me. 23.11.2023 në vlerë 119,595€, ndërsa fondet e buxhetuar në PIP për tri vite ishin në vlerë 45,000€ (për vitin 2023 në vlerë 25,000€, dhe për 2024 në vlerë 20,000€).Për me tepër, para inicimit të procesit të prokurimit nuk ishte bërë zotimi fondeve të vitit aktual. Sqarim: Mungesa e fondeve të buxhetuara në PIP për këtë projekt për 3 vite ka ndodhur për shkak se paramasa dhe parallogaria janë përgatitur pas miratimit të buxhetit në Kuvendit Komunal, dhe si pasojë e kësaj nuk ka qenë e ditur kostoja për realizimin e këtij projekti. Ndërsa sa i përket zotimit të mjeteve, mjetet kanë qenë të zotuar me datë: 21.02.2023 në vlerë 18,000.00€ Të bashkangjitur gjeni dëshminë e zotimit të mjeteve në formatin PDF.	Komuna ka prezantuar zotimin jo i plotë të vitit 2023 projektin, prandaj e gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
--	---	---

Vonesa në realizimin e projekteve kapitale	Vonesa në realizimin e projekteve kapitale, Komenti i rekomandimit: • Projekti „Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit” në vlerë 155,959€ e nënshkruar me 08.07.2022 do të duhej të përfundonte për 120 ditë. Deri në situacionin e III të datës 06.12.2022 projekti ishte realizuar në vlerë 106,927€ apo 69%, që rezulton më vonesë rreth 2 muaj. Arsyetim: Te projekti në fjalë kanë ndodhur vonesa në realizim të projektit për shkak se ka pasur vonesa në pëlqimet elektroenergjetike dhe vonesa në ofrimin e zgjidhjes teknike nga ana e KEDS-it. Poashtu vonesa janë shkaktuar për shkak të ndërlikueshmërisë së porjektit, problem me infrastrukturën nëntokësore e cila në vazhdimësi na ka detyruar të bëjme revidime në zgjidhjen teknike të KEDS, dhe si pasojë e dy kërkesave për revidim janë shkaktuar edhe vonesat e lartëcekura. Të bashkangjitur gjeni dëshmit e kërkesave tona drejtuar KEDS-it.	Komenti dhe arsyetimet e komunës, nuk e ndryshojnë gjetjen dhe rekomandimin tonë.
--	--	---

Leter konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft/raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **KK-Rahovec** për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem pjesërisht** me gjetjet dhe rekomandimet, komentet dhe kërkesat janë të bashkangjitur në pjesën e formës për dorëzim dhe pranim të dëshmive.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Smajl Latifi
Kryetar i Komiteteve të Rahovecit

Data: 20.06.2024



Rahovec,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Kjo gjetje është përcaktuese/ determinuese në modifikimin e opinionit të auditimit.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Departamenti për Performancë dhe
Transparencë Komunale



RAPORTI I PERFORMANCËS SË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS JANAR-DHJETOR 2023



2

0

2

4

Institucioni:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Mbikëqyrja:

Drin Haraqia, Drejtor i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale MAPL

Pjesa e përgjithshme hartuar nga:

Haxhi Krasniqi, U.D i Udhëheqësit për Performancë Komunale;

Pjesa e veçantë nga:

Haxhi Krasniqi & Lazar Mitic

Mbledhja, përpunimi, verifikimi i të dhënave:

Haxhi Krasniqi, U.D i Udhëheqësit për Performancë Komunale;MAPL

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Edina Ibishi, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Shqiponja Vokshi DEMOS

Saranda Husaj, DEMOS

Blerta Sejdiu – Junior Konsulente/DEMOS

Edita Azemi – Praktikante/DEMOS

Përmbajtja

HYRJE	4
BAZA JURIDIKE PËR RAPORTIN E PERFORMANCËS.....	4
QËLLIMI	5
METODOLOGJIA.....	5
 Kapitulli I	6
I. Performanca e komunave 2023 – Pjesa e Përgjithshme	6
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I MATJES SË PERFORMANCËS KOMUNALE.....	6
2. TRENDET E PERFORMANCËS SË KOMUNAVE NDËR VITE	7
REZULTATET E VITIT 2023	8
 Kapitulli II	13
II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2023.....	13
 1. REZULTATET E KOMUNAVE SIPAS FUSHAVE DHE TREGUESVE	13
Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative.....	14
Fusha 2 – Transparenca Komunale	14
Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale.....	16
Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare	19
Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport.....	20
Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive.....	21
Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor	22
Fusha 8 – Hapësirat Publike	23
Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore.....	24
Fusha 10 – Transporti Publik.....	26
Fusha 11 – Shërbimet Publike.....	27
Fusha 12 – Mbrojtja e Mjedisit	28
Fusha 13 – Përfaqësimi Gjinor	29
Fusha 14 - Arsimi Parauniversitar	31
Fusha 15 – Kujdesi Primar Shëndetësor	32
Fusha 16 – Zhvillimi Ekonomik Lokal	33
Konkluzione dhe rekomandime	35
Shtojcë: % e treguesve sipas fushave	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Hyrje

Raporti i performancës komunale për vitin 2023 prezanton rezultatet e punës së komunave në 16 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 85 treguesve nga 93 sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale.

Vlerësimi i treguesve të aplikueshëm është bërë në koordinim me zyrtarët komunal, me të cilët para procesit të matjes është realizuar një konsultim i përgjithshëm, duke evidentuar treguesit e mundshëm dhe pezulluar 8 prej tyre. Për vitin 2023, raporti përmbledh 26 tregues më pak se për vitin 2022, kjo për shkak të rishikimit të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale i cili është bërë në vitin 2023.

Me kërkesën e zyrës së Kryeministrit dhe me aprovimin e Ministrit të MAPL-së, SMPK –së do t'i shtohet dhe një tregues që ka të bëjë me zvoglimin e Barrës Administrative në komuna. Ky tregues do të raportohet në vitin 2025.

Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre është bërë përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Qasje në këtë sistem kishin të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të Ministrisë. Krahas raportimit, sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjijtes së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave.

Ky raport synon të pasqyroj dy aspekte kryesore të punës së komunave:

- 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe
- 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Të dhënat e ofruara shërbejnë për të parë trendët e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet e vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal.

Procesi i verifikimit të të dhënave është bërë në tri faza si në vijim:

- procesi i verifikimit peraparak i cili është bërë gjatë fazës së raportimit brenda 45 ditëve
- procesi i verifikimit të rregullt i cili sipas Dokumentit Kryesor përfshin 30% të treguesve e që gjithsej në këtë verifikim janë përfshirë 27 tregues në 12 komuna.
- procesi i verifikimit në teren në të cilin janë përfshirë 11 komuna me 5 tregues

Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

Për vitin 2023 kanë raportuar 34 komuna të Republikës së Kosovës¹.

Baza juridike për raportin e performancës

Matja e performancës komunale tashmë është ngritur në nivel të rregullimit ligjor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 08/l-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 12.08.2022. Në vitin

¹ Të dhënat nuk janë raportuar nga Komuna e Novobërdës, Zubin Poptokut, Leposaviqit, Zveqanit

2023, ka hyrë në fuqi Udhëzim Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe Skemën e grantit për performancë komunale.

Sipas nenit 19, të ligjit procesi i matjes së performancës organizohet në baza të rregullta vjetore nga Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal. Në nenin 19 të Ligjit për SMPK dhe GPK, është i përcaktuar afati i raportimit të të dhënave komunale në SEMP.

Për më saktë, *“Procedurat dhe afatet tjera për matjen e performancës dhe vlerësimit për grant përfundojnë në pajtim me rregullat juridike që janë përcaktura me Udhëzim Administrativ.*

Referuar Ligjit Nr. 08/I-103, SMPK është i ndërtuar mbi bazën e parimeve themelore siç janë: Ligjshmërsë; Transparencë; Subsidiaritetit, meritës; objektivitetit dhe paanshmërsisë; Barazisë dhe mosdiskriminimit;

Udhëzimi përcakton të drejtën e autoritetit mbikëqyrës për të kërkuar informata të cilat i shërbejnë matjes dhe vlerësimit të performancës së komunave. Udhëzimi përcakton strukturat organizative përgjegjëse të komunave për raportim në kuadër të SMPK-së.

Qëllimi

Matja e performancës ka për qëllim përcjelljen sistematike të ngjarjeve dhe aktiviteteve të komunave brenda kornizës së treguesve të caktuar. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim, si dhe fushat ku duhet orientuar ndërhyrjet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata.

Të dhënat e fituara ndihmojnë që komunat të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunat?
- Nëse komunat po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikat në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kriterëve të qarta, ashtu që shpërndarja e investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Në këtë drejtim, qëllimi i matjes shërben edhe për nevojat të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.

Prandaj, të dy këto procese, matja e performancës dhe ndarja e grantit për performancë, synojnë të përmirësojnë punën e administratës komunale në përgjithësi, të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe të reflektojnë në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore për qytetarë.

Metodologjia

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) është i ndërtuar nga MAPL në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar. MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK.

Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

1. Funkcionalizimin e sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të performancës dhe mbajtjen e trajnimeve për të gjithë zyrtarët e komunave;
2. Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
3. Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
4. Mbrenda afatit për raportim është bërë verifikimin paraprak i të dhënave;
5. Adresimi i ndryshimeve eventuale në sistem, pas verifikimit paraprak;
6. Verifikimin e të dhënave me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në teren;
7. Verifikimin e rregullt sipas mostres prej 27 treguesve
8. Nxjerrjen dhe komunikimin preliminar të rezultateve të performancës në komuna;
9. Përmbylljen e periudhës së ankesave;
10. Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së nga komunat, pas udhëzimeve/trajnimeve të organizuara nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave.

Verifikimi i të dhënave – sigurimi i cilësisë së të dhënave dhe verifikimi i tyre është bërë përmes disa metodave:

- Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;
- Shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të bashkëlidhura me formularët e plotësuar në sistemin elektronik;
- Sqarimeve të ofruara nga koordinatorët në Sistemin Elektronik të Performancës;
- Krahasimit të të dhënave me dokumente të tjera zyrtare të institucioneve publike;
- Krahasimit me raportet e tjera zyrtare të MAPL-së;
- Për të dhëna të caktuara janë kontaktuar direkt zyrtarët përgjegjës në komuna

Kapitulli I

I. Performanca e komunave 2023 – Pjesa e Përgjithshme

1. Vështrim i përgjithshëm i matjes së performancës komunale

Matja e performancës së komunave është proces i rregullt i cili implementohet në Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse në komunë, duke përfshirë zyrtarët raportues, koordinatorët e performancës dhe kryetarët e komunave, si autorizues të fundit të të dhënave të raportuara nga komunat.

Matja shtrihet brenda kornizës së kompetencave të komunave sipas legjislacionit bazë dhe atij sektorial. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale ka përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e komunave në fusha të shumta të qeverisjes lokale, përfshirë: shërbimet publike, infrastrukturën lokale, mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, ndriçimin publik, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe ndërtimin, furnizimin me ujë të pijshëm, rrjetin e kanalizimit, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e arsimit parauniversitar, shëndetësinë primare, shërbime të mirëqenies sociale, aktivitetet kulturore, si dhe shumë çështje të tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) mundëson që rezultatet e fituara të shërbejnë si mjet identifikimi për aspektet e forta dhe të dobëta të qeverisjes lokale, në mënyrë që nga informacionet e fituara, të ndërtohen strategji për përmirësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Matja e vitit 2023 është realizuar në 16 fusha të kompetencave komunale, me gjithsej 93 tregues. Elementet e matjes së performancës shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore². Indikatorët e përdorur japin informacione të konsiderueshme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara japin indikacione të rëndësishme për menaxhmetin e komunës për të shtrirë prioritetet në sektorët më pak të zhvilluar.

Edhe në vitin 2023 procesi i matjes së performancës komunale është bërë me anë të Sistemit Elektronik i menaxhimit të Performancës, në të cilin kanë qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave dhe ministrisë. Digjitalizimi i këtij procesi ka mundësuar një formë interaktive të komunikimit, për të qartësuar të gjitha të dhënat diskutabile dhe për të rritur shkallën e dokumentimit. Njëherësh sistemi mundëson gjurmimin e të gjithë hapave të vlerësimit dhe ruan të gjitha dokumentet relevante mbi të cilat bazohet raportimi.

2. Trendet e performancës së komunave ndër vite

Në vitin 2023, kërkesës për raportim të performancës janë përgjigjur 34 komuna, nëdërsa 4 komuna tjera nuk i kanë raportuar të dhënat në SMPK. Komuna e Novobërdes ka raportuar vetëm 31% të të dhënave. Rezultatet e tregojnë se niveli i të arriturave të komunave ndër vite varion prej 57.06% deri në 59.38%, në vitin 2022, kurse në vitin 2023 është 58.24%.

Duhet cekur se elementet e matjes së performancës kanë ndryshuar ndër vite, për shkak të përfshirjes së risive brenda SMPK-së, përkatësisht shtimit dhe zvoglimit të treguesve dhe të dhënave të reja. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale. Kjo rritje po ashtu është bërë për faktin se komunat kanë forcuar kapacitetet e tyre për përdorimin e sistemit të performancës, duke rritur kualitetin e të dhënave të raportuara. Analizat e përgjithshme tregojnë se disa tregues tanimë kanë arritur një standard të mirë të funksionimit, që dëshmojnë për nivel të të rregullsisë brenda rezultateve të synuara. Në anën tjetër ekzistojnë parametra të caktuar për të cilët komunat akoma qëndrojnë në nivel të ulët të zhvillimit, për të cilët treguesit e matjes duhet të jenë prezent në një periudhë afatgjatë.

Më poshtë janë paraqitur përqindjet mesatare nga viti 2020 deri në vitin 2023, si në vijim:




Fig.1. Performanca e komunave sipas viteve 2020-2023

² Udhëzim Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale

Rezultatet e vitit 2023

Sa i përket të dhënave për vitin 2023, performanca e përgjithshme e komunave në 16 fusha me 85, nga gjithsej 93 tregues të matjes është 58.24%, që do të thotë se komunat kanë ofruar shërbime më të ulëta se në vitin 2022, për 1.14%, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ndonëse ka një ngritje të lehtë të performancës në vitin 2023 prej 1.18%.

Mesatarja e përgjithshme tregon se komunat duhet të rrisin përpjekjet tyre për të përmirësuar shërbimet dhe qeverisjen. Referuar % sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehet në këto fusha: përfaqësim të barabartë gjinor (39.66%), infrastrukturë rrugore (42.45%), transport publik (46.93%), arsim parauniversitar (48.78%) barazia në punësim (49.71%) hapsia publike (51.59%), mbrojtja e mjedisit (52.56%), zhvillim ekonomik lokal (56.75%), dhe shërbime publike (58.05%), i cili shërbim është shumë afër me mesatarën e vendit.

Mbi nivelin mesatar të vendit janë shërbimet si në vijim: Shërbime publike Administrative janë në nivelin më të lartë prej 80.00% në nivel vendi, e pasuar nga fusha transparenca komunale 73.02%, menaxhimi i fatëkeqësive me (69.30%) fusha kujdesi primar shëndetësor me 68.61% pasuar nga planifikimi hapsinor me 67.90%, fusha përgjegjëshmëria komunale ka vlerën 63.79% dhe Kultura Rina dhe Sporti janë shërbime të cilat janë shumë afër meastares së vendit ku janë ofruar në nivel të kënaqëshmëm që shprehur në përqindje janë 62.70%. Në grafikun Nr.2 shihet se 7 fusha të shërbimeve janë ofruar mbi mesatarën e vendit, ndërsa 9 fusha tjera janë ofruar nënë mesatarën e vendit që shprehur në % 43.75% të fushave janë mbi mesatare dhe 56.25% të fushave janë nënë mesatare.

Më poshtë është paraqitur figura me % e arritur të 16 fushave të matjes:




Fig.2. Performanca sipas fushave

Ndarja e fushave sipas kategorive dhe niveleve të performancës, në kater nivele i kemi ndarë 16 fushat e qeverisjes nga komunat. Sipas grafikut më lartë, në nivel të lartë të performancës janë pesë (2) fusha të radhitura sipas përqindjes, shërbimet Transparenca komunale dhe 73.02%, përkthësisht 80.00% shërbimet publike administrative.




Fig. 3 Kategorizimi i fushave sipas nivelit të performancës

Ndërsa niveli i dytë përcatkohe sipas përqindjes e që fillon 62.70% deri në 69.30%, sikurse niveli i tretë sipas kategorisë përbën përqindjen 51.59% deri në 58.05% dhe niveli i katër ose i fundit sipas përqindjes fillon në 49.71 deri në 39.66%, sa ka edhe fuisha përfaqësimi gjinor. Nga kjo renditje shihet që nuk ka ndryshime të theksuara nga viti 2022, edhe pse në vitin 2023 është rishikuar SMPK, edhe në vitin 2022 kanë qenë të renditura njësoj sipas performancës komunale, vetëm se vërhet një ndryshim i vogël specifik sipas përqindjes.

Elementet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale sigurojnë informata edhe për procedura dhe aspekte ligjore të një shërbimi publik, për këtë arsye kategorizimi i fushave për nga niveli arritjeve është bërë duke marrë parasysh qëllimin e treguesve, ngjashmëritë në mes të tyre, përmbajtjes dhe llojit të fushës së kompetencës. Së këndejmi, grupimi i fushave në vijim merr parasysh këto segmente:

- 1) Standardet e qeverisjes së mirë
- 2) Ofrimin e shërbimeve publike

Nga figura 4 vërejmë që në kuadër të treguesve të qeverisjes të dhënat tregojnë se komunat kanë rritur efikasitetin në ofrimin e **Përfaqësimi gjinor**, prej 39.66% që mund të quhet një arritje mjaft e konsiderueshme e komunave për vitin 2023. Në kuadër të fushës barazia në punësim, shërbime sociale dhe familjare niveli i përgjithshëm i arritjes shprehet me 49.71%³.

1) Standardet e qeverisjes së mirë

Në kuadër të **Shërbimeve publike administrative**, niveli i përgjithshëm i të arriturave shprehet me 80.00%, Fusha Zhvillimi Ekonomik Lokal ka një nivel mjaft të lartë që shprehet me 56.75% ku edhe kjo fushë krahasuar me vitin 2022 ka një ngritje të kënaqëshme prej 23.62%. Fusha **Transparenca komunale** për vitin 2023, shprehet me 73.02% në vitin 2023. Në fushën përfaqësimi gjinor për vitin 2023, mund shihet në figurën Nr 4, dhe ka vlerën 39.66%

³ Per me teper: <https://mapl.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2021/05/Dokumenti-Kryesor-i-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Performances-Komunale- designed-18.02.2021.pdf>, fq. 62




Fig. 4 % e arritur në fushat e qeverisjes

Transparenca komunale lidhet ngushtë me fushën e përgjegjshmërisë komunale, e cila vlerësohet me numrin më të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Për dallim nga treguesit e transparencës të cilët kryesisht janë të orientuar në ofrimin e publicitetit për aktivitetet dhe të dhënave zyrtare, përgjegjshmëria komunale inkorporon të dhëna që tregojnë për nivelin e llogaridhënies së organeve komunale, si dhe aktivitet e tyre për përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Në vitin 2023 këto dy fusha kanë shënuar rënje, ndoshta për faktin se në vitin 2023 është bërë rishikimin i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe si rrjedhojë janë hequr disa tregues të këtyre fushave. Kjo mund të themi që është një indikacion i rënjes së ofrimit të shërbimeve tek këto dy fusha.

Në kuadër të veprimeve që **ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal** komunat kanë performancë me nivel të përgjithshëm të të arriturave në shkallën 56.75%, edhe kjo fushe ka nivel të njëjet të aritjes së performancës krahasuar me vitin 2022.

Shërbime Publike- Në kuadër të kësaj fushe përfshihen tregues dhe të dhëna për ujë të pijshëm, menaxhim të mbeturianve dhe kanlizimet. Rezultatet e kësaj fushe shprehur në përqindje janë të kënaqëshme dhe kanë vlerën prej 58.05%

Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare - Në kuadër të kësaj fushe janë matur veprimet e komunave për ofrimin e banimit social, si dhe kujdesin institucional ndaj grupeve të cënueshme. Po ashtu janë mbledhur të dhëna për punësimin e personave me aftësi të veçanta dhe punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë bazuar në të drejtat ligjore të tyre. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 49.71%, krahasuar me 60.30% në vitin paraprak.

2) Fushat me tregues për ofrimin e shërbimeve publike.

Në kuadër të këtyre fushave bëjnë pjesë tregues për lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave, si në: Shërbime publike, mbrojtje të mjedisit, planifikim urban, aktivitete kulturore, arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mirëmbajtje të hapësirave publike, mirëmbajtje të rrugëve, shtigje të biçikletave, parkingje publike, shenjëzim të rrugëve etj.




Fig.5. Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2023

Fusha, **Kulturë, rini dhe sport**, për vitin **2023** ka shkallën më të lartë të ofrimit të këtij shërbimi në nivel të gjitha komunave, e shprehur në përqindje në vlerën prej 62.70%, e pasuar nga sikurse edhe fusha e **Arsimit parauniversitar** si kompetencë vetanake komunale ka një renditje të mirë sa i përket ofrimit të rezultateve në ofrim të shërbimeve komunale me 48.78%. **Planifikimi Hapsinor**, renditet e katërta sa i përket listës së ofrimit të shërbimeve kualitative e cila është shprehur %, kap vlerën 67.90%, dallim të vogël vërejmë edhe në fushën **Infrastruktura rrugore**, e cila në përqindje ka vlerën prej 42.45%, me pas renditet fusha **Menaxhimi i fatkeqësive**, e cila është shprehur në përqindje në vlerën prej 69.30%. **Mbrojtja e mjedisit** ka nivel mesatar të ofrimit për të gjitha komunat dhe kap vlerën prej 52.26%, e pasuar nga fusha e **Kujdesit parësor shëndetësor**, e cila në përqindje ka vlerën prej 68.61%.

Në nivel pak më të ulët është fusha si në vijim, duke filluar nga fusha **Hapsirat Publike**, 51.59%, fusha e Transportit Publik ka vlerën prej 46.93%.

Kapitulli II

II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2023

1. Rezultatet e komunave sipas fushave dhe treguesve

Matja e performancës në vitin 2023 ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 34 komuna, megjithëse shkalla e pavarshmërisë së të dhënave ishte mjaft e shprehur në disa komuna

Shkalla e ofrimit të shërbimeve dhe respektimit të standardeve të qeverisjes ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, varësisht nga fusha e kompetencave që matet. Në nivelin e performancës mund të ndikojnë faktorë të shumtë, si: prioritetet e vëna nga komuna brenda fushave për të cilat ushtrohet matja, mënyra dhe cilësia e planifikimit të punëve, realizimi në raport me planifikimin, realizimi në raport me mundësitë dhe pengesat e caktuara, kapacitetet dhe resurset, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e raportimit të të dhënave në SMPK, si dhe faktorë të tjerë relevant.

Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur detaje të të arriturave të komunave sipas fushave dhe treguesve përkatës.

Sqarim: Në vijim të raportit, llogaritja e rezultatit përfundimtar të fushave të matjes, merr për bazë edhe vlerën 0 për të dhënat e të cilave janë shpallur të pavlefshme. Kjo është bërë për arsye se edhe keqraportimi konsiderohet performancë e dobët, gjë që duhet të ndikoj në rezultatin përfundimtar të komunave që nuk kanë ofruar të dhëna. Kjo reflekton edhe në krahasimet në mes të komunave si dhe vlerësimet e bëra për qëllime të Grantit për Performancë.

Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative

Kjo fushë përbëhet nga katër tregues, ku përfshihen shërbimet publike administrative (SHPA) dhe efikasiteti i organeve komunale në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik, për çështjet që lidhen me kompetencat e tyre të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar shërbime administrative në formën online apo përmes e-kioskut.

Krahasuar me 16 fushat e tjera, në vitin 2023 kjo fushë radhitet e para për nga performanca, me nivel të përgjithshëm prej 80.00%. Komuna e Deçanit ka nivelin maksimal më të lartë të ralizimit të këtij shërbimi prej 100%.




Fig. 6 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e shërbimeve administrative

Të dhënat tregojnë se komunat në masë të madhe i kanë shqyrtuar kërkesat administrative të cilat u janë parashtruar. Përmes tre treguesve në SMPK. Treguesi: kërkesa administrative të shqyrtura gjatë vitit shprehur në % janë 87.62% sikurse kërkesa administrative të shqyrtura brenda afateve ligjore janë 84.79%, kurse shërbime administrative të ofruara online janë po ashtu 67.58%




Fig. 7 Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve administrative

Fusha 2 – Transparenca Komunale

Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 26 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kriterëve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj.

Performanca e përgjithshme e arritur në këtë fushë është 73.02%, për dallim nga viti paraprak ku ishte 85.78%. Sa u përket performancës sipas tregueseve, përqindja më e lartë është në publikimin e dokumenteve të prokurimit publik shprehur me 67.60%.




Figure 8 Treguesit e performancës në fushën e transparencës

Nga figura e mësipërme shihet se treguesi për transmetimin online të mbledhjeve të kuvendit del në nivel 72.15%, krahasuar me vitin paraprak prej 85.74%, ose 13.59% më pak në vitin 2023. Tetë kriteret e matura për ueb-faqe komunale del të jenë përmbushur në masën 80.59%, ndërsa aktet e kuvendit të komunës janë publikuar në shkallë prej 86.11%. Të dhënat tregojnë për trend pozitiv në publikimin e akteve me karakter të përgjithshëm të aprovuara nga kryetarët e komunave, shprehur në përqindje prej 81.64% ose 3.78% më shumë se në vitin 2022.

Po ashtu, komunat kryesisht kanë qenë efikase në publikimin e buxhetit të komunës si dhe raporteve të shpenzimeve, ne nivelin prej 65.29%. Sa i përket publikimit të planit vjetor të




Fig. 9 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e transparencës komunale prokurimit publik.

Figura e mësipërme tregon për 16 komuna të cilat kanë treguar performancë në mes 90-100% në fushën e transparencës, prej të cilave: Gjakovë (100%), Glogoc (100.00%), Kaçanik (100%) Lipjan (100%) Rahovec (100%) Skenderaj (100%) Suharekë (100%). Nën nesataren e vendit sa i përketë ofrimit të këtij shërbimi nga komunat vlen të theksohe se 22 komuna janë mbi mesatare, ndërsa 12 komuna nën mesatare, gjë që trasnparenca e organeve komunale është në fokus të komunave.

Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale

Përgjegjshmëria komunale ka gjithsej 10 tregues, të aplikuar në vitin 2023. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 63.79%. Në kuadër të kësaj fushe, vërejmë performancë të lartë të komunave në ndërmarrjen e veprimeve ligjore. Komunat kanë treguar performancë pozitive edhe në diskutimin e projektbuxheteve dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve, që shprehur në përqindje është 84.21%, në këtë tregues komunat janë treguar të suksesshme.




Figure 10 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike edhe në vitin 2023, mbetet e ulët edhe përkundër standardit të SMPK-së të 3% të popullsisë së komunës, i cili është përmbushur në shkallën 26.08% krahasuar me vitin paraprak që ishte 32.47%, apo 6.39 më e ulët se në vitin paraprak. Te ky tregues vërehet një rënje e lehtë në vitin 2023.




Figure 11 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Sa i përket nivelit të zbatimit të planit të prokurimit, bazuar në shumën e shpenzuar kundrejt shumës së planifikuar, performanca rezulton në masën 89.50%. Treguesi i për nivelin e adresimit të rekomandimeve të ZKA-së ka përqindjen prej 46.05%, ky tregues ka nivel mesatar të ofrimit edhe në vitin 2022 ka pas ofrim të përafërt. Treguesi niveli i pagesave brenda afateve ligjore prej 30 ditës në përqindje i shprehur 73.94%, sikurse, Treguesi për nivelin e zbatimit të planit të prokurimit ka vlerën prej 89.50%.

Performancë të mirë komunat kanë edhe sa i përket treguesit, pezullimi i zyrtarëve në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre që ka vlerën prej 93.94%, ka dëshmon se komunat nuk kanë pas suspendime sa i përket aktakuzave eventuale në shërbimin civil komunal. Komunat ende qendrojnë jo mirë në hartimin e planeve për integritet dhe miratimin nga kuvendi, vlera e treguesit është 52.94%, kjo vlerë mbetet e ulët.




Figure 12 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunal




Figure 13 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunal




Figure 14 Krahاسimi i performancës së komunave në fushën e përgjegjshmërisë

Performancën më të lartë në indikatorët e kësaj fushe e ka arritur komuna e Rahovecit (94.85%) Glogoc (93.28%) Lipjanit (92.72%), Suharekës (90.42%) Skenderaj (88.56%) dhe Hani Elezit (87.85%) Ndryshe nga to, më ulët qëndrojnë komunat: Mitrovica e Veriut, Partesh, Mamushë, Graçanicë, Prishtinë dhe Ranillug, Shtërpçë. Në nivelin të performancë në këtë fushë, ka ndikuar edhe mos raportimi i të gjitha të dhënave për tregues nga komunat në fjalë.

Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësim komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë prej 49.71%.




Figure 15 Krahاسimi i performancës së komunave në fushën e Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare




Figure 16 Treguesit e performancës në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Sipas të dhënave niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta mbetet i ulët, referuar kriterit të përcaktuar në Ligjin Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi, treguesi ka vlerën prej 26.88%. Më poshtë, janë pasqyruar të arriturat për të gjitha komunat në kuadër të kësaj fushe: Përqindje me e lartë është shënuar në dy tregues, Familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, në masën 43.32% dhe fëmijë në nevojë që iu është siguruar strehimi familjarë, në përqindjen prej 73.71%. Treguesi sa i përket zyrtarëve publik të punësuar nga komuniteti jo shumicë në institucionet komunale ka vlerën 44.31%.

Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive.

Fusha matë performancën duke e krahasuar me numrin e banorëve për arsye që të jetë më e balancuar ndaj komunave me shumë banorë dhe atyre me më pak banorë. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 62.70%. Vlenë të theksohet se 11 komuna kanë vlerë maksimale të ofrimit të këtij shërbimi prej 100%, ndërsa 6 komuna mbetën në vlerën 0 për këtë shërbim.




Figure 17 Treguesit e performancës në fushën kulturë, rini dhe sport

Treguesit, aktivitete të kulturës rinisë dhe sportit të mbështetura me buxhet komunal sipas përqindjes është 57.82%, kurse hapësira për aktivitete sportive krahasuar me numrin e banoreve në komuna është 67.58%.




Figure 18 Treguesit e performancës në fushën e kulturë, rini dhe sport

Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive

Kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 69.30%. Rezultate maksimale prej 100% në vitin 2023 kanë arritur 14 komuna në menaxhim efikas të faktëkeqësive, ndërsa në nivel minimal mbeten 4 komuna, kurse mbi mesatare të vendit janë 18 komuna.




Fig. 19 Krahasimi i performancës së komunave në fushën menaxhimi i fatkeqësive

Niveli i realizimit të treguesve për këtë fushe është si vijon: Intervenimet e për mbrojtje nga fatkeqësitë ka përqindjen 78.91% ndërsa në nivel mesatar të realizimit mbetet treguesi për realizimin e planit komunal për menaxhimin fatkeqësive prej 59.68%, krahasuar me vitin praparak është më e lartë prej 36.93%. Kjo tregon që komunat në vitin 2023 i kanë kushtuar rëndësi realizimit të planit për reagim emergjent.




Fig. 20 Treguesit e performancës në fushën e menaxhimi fatkeqësive

Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor

Kjo fushë matë zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor, por edhe nivelin e planifikimit të ndërtimeve komunale. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 67.90%.




Figure 21 Treguesit e performancës në fushën e planifikimit hapësinor

Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme është në shkallë prej 50.72%. ose 24.3% më e lartë se në vitin praparak 2022. Sa i përket lejeve ndërtimore nga komunat u shqyrtuan me kohë 92.68%. Sipas të dhënave, ndërtesat e reja për të cilat u lëshuan leje ndërtimi inspektuar në shkallë prej 77.49%.




Figure 22 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e planifikimit hapësinor

Nivel maksimal prej 100% për këtë shërbim kanë ofrur 6 komuna, ndërsa 15 komuna janë mbi mesataren e vendit, kurse vetëm Komuna e Mitrovicës së Veriut mbetet në nivelin minimal e vlerësua me 0.

Fusha 8 – Hapësirat Publike

Kjo fushë matë hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve. Performanca e përgjithshme sipas të dhënave të ofruara nga komunat është 51.59%. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ndër të tjera janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike.




Figure 23 Treguesit e performancës në fushën e hapësirave publike

Përpos nivelit të hapësirave të gjelbra për kokë banori, kjo fushë matë edhe sipërfaqen e hapësirave publike të cilat mirëmbahen rregullisht nga komunat, si dhe numrin e hapësirave publike të përcjella me ndriçim publik. Për nivelin e përmbushjes së treguesve referojuni figurës së mësipërme.

Sipas të dhënave rreth 62.78% të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, ndërsa 65.84% të hapësirave publike janë të përcjella me ndriçim publik. Siperfaqe të gjelbra për kokë banori në m2 janë 26.15% në nivel vendi.




Figure 24 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e hapësirave publike

Sipas të dhënave të raportuara nga Komunitat në nivel maksimal prej 100% janë 4 komuna të cilat e kanë ofruar këtë shërbim për qytetarët e vet, ndërsa për 6 komuna ende mbetet sfida ofrimi i këtij shërbimi dhe si rrjedhojë janë vlerësuar me 0.

Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore

Kjo fushë matë rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Fusha është plotësuar me tregues të ri për të nxitur përmirësimin e infrastrukturës rrugore me trotuare, ndriçim, shenjëzim si dhe shteg të biçikletave. Performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 42.25%.




Figure 25 Treguesit e performancës në fushën e infrastruktura rrugore




Figure 26 Treguesit e performancës në fushën e infrastruktura rrugore

Ajo çfarë e bënë performancën e përgjithshme të mos jetë aq e lartë, është përfshirja treguesit i ri për rrugët në zonat urbane me shtigje të biçikletave, si dhe raporti në mes të rrugëve lokale me trotuare dhe ndriçim publik. Nivelin e përmbushje së treguesve të kësaj fushe e keni në tabelën më lart. Vlen të përmendet treguesi me nivelin më të ulët, rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave 9.24% ose 1.86% më e lartë se në vitin 2022, dhe treguesi me përmbushjen më të lartë prej 61.38% rrugët lokale të riasfaltuara.

Performanca e komunave në nivel të fushës është paraqitur si më poshtë:




Figure 27 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e infrastrukturës rrugore

Komuna e Suharekës ka një nivel maksimal të ofrimit të këtij shërbimi për qytetarë, e pasuar nga komuna e Junikut dhe Obiliqit, ndërsa në nivel të ulët mbeten komunat, Mitrovica e Veriut, Shtërpçë, partesh, Klokot dhe Deçan

Fusha 10 – Transporti Publik

Kjo fushë matë ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 46.93 %.




Figure 28 Treguesit e performancës në fushën e transportit publik

Në kuadër të kësaj fushe performanca për tre tregues është pasqyruar në grafikun më lart. Sipas të dhënave vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik 65.23%, kurse vendndalimet e shënjizuara për automjetet e transportit publik qëndrojnë në nivelin 63.01% ose 2.29% më e lartë se në vitin 2022. Në nivel të ulët është përmbushur plani për transport publik i cili në përqindje është 12.54%, ky tregues edhe përkundër përpjekjeve të përbashkëta me komunat, mbetet i ulët po thuaj se në nivel të njëjtë.

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figure 29 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e transportit publik

Fusha 11 – Shërbime Publike

Kjo fushë është fuzionur me rastin e rishikimit të SMPK-së, dhe në vete përfshinë pesë 5 tregues, të ofrimit të shërbimeve publike si , Mbeturina, Kanalizim, dhe Ujësjiellës, që shprehur në tregues janë si në vijim: Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave, realizimin e planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjiellës, Realizimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, Realizimin e planit komunal për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit dhe Realizimin e planit komunal për mbledhjen e mbeturinave. Performanca në nivel të fushës është 58.05%.




Figure 30 Treguesit e performancës në fushën e parkingjeve

Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave 75.87%, Realizimin e planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjiellës 35.29%, Realizimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 49.12%, Realizimin e planit komunal për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit 41.92% dhe Realizimin e planit komunal për mbledhjen e mbeturinave 88.04%.

Në vijim është paraqitur arritjet e komunave në këtë fushë në përqindje.




Figure 31 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e parkingjeve publike

Komuna Suharekës ka arritur nivel maksimal të ofrimit të shërbimeve publike prej 100%, pasuar nga komuna e Rahovecit me 99.67%, e treta renditet komuna e Lipjanit me 99.45%. Ndërsa në nivel të ulët mbeten komunat si: Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Partesh, Malishevë, kjo mund të shihet në grafikun nr 31.

Fusha 12 – Mbrojtja e Mjedisit

Kjo fushë matë veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 52.56%.




Figure 32 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

Realizimi i planit të veprimit të mjedis del të jetë arritur në masën prej 48.69%⁴.ose 37.64% më e lartë se në vitin 2022. Kjo tregon për një seriozitet të komunave për trajtimin e planeve të veprimit në mjedis. Lejet mjedisore të lëshuar ishin në shkallën 45.47% ndërsa ndërtesat e reja që kanë zbatuar lejet mjedisore komunale del në shkallë mjaftë të ulët prej 63.52%.




Figure 33 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

⁴ Shumica e komunave nuk kanë dëshmuar ta kenë të hartuar Planin Lokal për mbrojtje të Mjedisit

Komunat, Dragash, Istog, Rahovec, Suharekë kanë vlerën maksimale prej 100%. Në grafikun më lartë mund të shihen edhe komunat të cilat kanë rezultate të knaqëshme të ofrimit të këtij shërbimi, ndërsa mesatarja e vendit është 52.56, ku mbi mesatare renditen 21 komuna dhe 13 komuna renditen nënë mesataren e vendit për këtë shërbim.

Fusha 13 – Përfaqësimi Gjinor

Përfaqësimi gjinor matet më gjerësisht në këtë fushë duke përfshirë qasjen e të dy gjinive në programet për zhvillim social, ekonomik, si dhe në aktivitetet komunale. Po ashtu, treguesit matin shkallën e përfaqësimit të të dy gjinive në institucionet lokale, trupat e kuvendeve komunale etj. Me gjithë progresin e komunave ndër vite në sigurimin e përfaqësimit të barabartë në trupat e kuvendeve dhe në komisionet komunale, të dhënat për treguesit e caktuar minimizojnë përqindjen në këtë fushë duke e bërë atë mjaft të ulët, 39.66%. Në vijim, është paraqitur figura e përfaqësimit gjinor sipas treguesve:




Figure 34 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor




Figure 35 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor

Përfaqësimi gjinor në procese të rëndësishme shoqërore në komunë

Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive

23.47

Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve

9.97

Figure 36 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor

Sipas të dhënave të raportuara nga 34 komuna, niveli i të punësuarve gra në institucione komunale është 78.20% në raport me kriterin 50x50. Po ashtu, Gratë të emëruara në pozita politike, është arritur 39.13% e kriterit ligjor. Sipas të dhënave të përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive, 47.21% të përmbushjes së kriterit ligjor.

Përfaqësimi gjinor tek emrat e rrugëve komunale është tejte i ulët, shprehur në 9.97% po ashtu edhe regjistrimi i pronave në emër të një grua apo dy gjinive (bashkëshortë apo vëllezër dhe motra), është i ulët, 23.47%, ose 15.68% më e lartë se në vitin 2022. Te ky tregues vërehet një ngritje gjë që tregon edhe seriozitetin e Komunave në trajtimin e pronave.

Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor ka vlerën 69.12%. Me që ky tregues ka ende vlerë të ulët të përkrahjes nga komunat, megjithatë, ka nevojë mjaft të madhe për trajnim në këtë drejtim si dhe për vullnet të komunave që të kuptojnë rëndësinë e kësaj çështje. Barazia gjinore në programet për punësim, subvencione dhe ndërmarrësi është në shkallë prej 28.76%.




Figure 37 Krahasset sipas komunave në fushën e barazisë gjinor

Nga grafiku shihet nevoja që Komunitat duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të investuar në programet për barazi gjinore dhe për të pëmbushur obligimet ligjore në aspektin e përfaqësimit institucional dhe politik. Kjo mund të shihet në grafikun më lartë

Fusha 14 - Arsimi Parauniversitar

Kjo fushë synon rezultate në hapësira për çerdhe dhe shkolla të pajisura me kabinete për internet, masa të efikasitetit të energjisë, rekrutimin e personelit arsimor, licencimin e mësuesve, mjetet e konkretizimit, pajisjet e shkollave me mjete mësimore, kabinete të TIK-ut, si dhe kushtet e sigurisë në shkollë. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme në nivel prej 48.78%. Në përgjithësi, në treguesit e arsimit të dhënat e raportuara nga komunitet nuk kanë qenë të plota, kështu që përqindjet e fituara mund të paraqesin një vlerë relative të saktësisë.




Figure 38 % e treguesve në fushën e arsimit parauniversitar në nivel vendi




Figure 39 % e treguesve në fushën e arsimit parauniversitar në nivel vendi

Fusha e arsimit ka me shume tregues por në grafikun me lart do ti paraqesim disa nga treguesit sipas përqindjes. Treguesi, braktisja e shkollës nga nxënësit, ku paraqitet shkalla inverse ka shënuar vlerën në 75.72%, Ndersa shkalla e realizimit te orëve te planifikuara sipas kalendarit vjetor te arsimit është përmbushur 79.09%. Kalueshmëria ne testin e maturës kombëtare ka vlerën 61.72. Fëmij që vijnë kopshtet ne zona rurale dhe urbane 14.22, kjo mbetet e ulet edhe përkundër përpjekjeve nga komunat. Shkolla me masa te efiqences së energjisë 64.38% edhe ky tregues vit pas viti po përmbushet nga komunat. Sikurse treguesi siguria në institucionet e arsimit parauniversitar 49.21%, ky tregues ende ka nevojë të përmbushet nga ana e komunave.




Figure 40 Krahaset sipas komunave në fushën e arsimit parauniversitar

Në grafikun Nr.40 mund të shihni rezultatet përmbushjen e treguesve e shprehur në përqindje për secilën komunë. Komuna e Fushë Kosovës ka nivel maksimal të përmbushjes së treguesve. Mbi mesataren e vendit janë renditur 22 komuna, ndërsa nënë mesataren e vendit janë 12 komuna.

Fusha 15 – Kujdesi Primar Shëndetësor

Kjo fushë matë infrastrukturën dhe hapësirat e destinuara për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunave, kjo fushë ka nivel të ulët të performancës në përgjithësi, apo 68.61%. Në vijim është paraqitur figura me % e performancës sipas treguesve në këtë fushë:




Figure 41 % e treguesve në fushën e shëndetësisë primare

Treguesit nga kjo fushë janë shumë numër, por ne do ti prezantojmë ne paraqitje grafike disa nga këta tregues, sepse janë mjaft specifik dhe me shume interes për komunat. Treguesi, fëmijë të përfshirë në programin e imunizimit është përmbushur 74.62%, kjo është një përqindje e kënaqeshme, por duhet të shkoj në tendencë të rritjes në vitet e ardhshme. Sikurse ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra e fëmijë është përmbushur 58.82%. Ndërsa tregues që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit të kushteve infrastrukturore janë si vijon: Objekte të KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike janë përmbushur 65.17%. Kurse niveli i pajtueshmërisë me raportin një mjek familjar edhe dy infermier për 2000 banorë, në nivel të komunave është arritur 73.69%, krahasuar me vitin 2022 është më e lartë për 17.12 %.

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figure 42 Krahasimet sipas komunave në fushën e shëndetësisë primare

Fusha 16– Zhvillimi Ekonomik Lokal

Kjo fushë matë aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësim i rregullt i regjistrimit të tatimpaguesve si dhe shkallë e lartë e inkasimit të tatimit në prone. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme prej 56.75% në vitin 2023.




Figure 43 e treguesve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

Fusha e Zhvillimit Ekonomik Lokal është prezantuar nga 4 tregues ne grafikun me lartë. Plani pe zhvillim ekonomik lokal është përmbushur nga komunat 25.47%. Kurse niveli i mbledhjes se faturës se tatimit ne prone pa borxhe interes dhe ndëshkime është përmbushur në 47.23%. Përgatitja dhe publikimi i listës se pronave komunale ne shfrytëzim është përmbushur ne 82.35%. Kurse niveli i azhurnimit te regjistrimit te tatimit ne prone është përmbushur ne 71.97%.




Figure 44 Krahasset sipas komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

Në paraqitjen grafike në grafikun Nr. 44 janë prezantuar rezultatet e arritura nga komunat për fushën e zhvillimit ekonomik, vlen të theksohet se mbi mesataren e vendit për vitin 2023 janë 21 komuna, kurse nënë mesatare janë 13 komuna. Komuna e Hani të Elezit ka arritur rezultatin maksimal prej 100% të treguesve për këtë fushë, renditet e dyta komuna e Vushtrrisë me 89.99%. Kurse e fundit ne realizimin e treguesve mbetet komuna e Mitrovicës së Veriut.

Konkluzione dhe rekomandime

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2023, nxjerr të gjetura të shumta për 16 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

1. Vlerësimi i performancës së komunave për vitin 2023 është bërë për 34 komuna⁵. Disa nga të dhënat e raportuara nga komunat me shumicë serbe, në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat nuk korresponduan me ofrimin e shërbimeve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës, janë shpallur nule dhe u aplikua vlera 0% e performancës. Matja dhe vlerësimi i performancës është obligim ligjor i të gjitha komunave, të cilat duhet t'i përgjigjen kërkesave për informata konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Sistemin e Menaxhimit të Performancës komunale dhe grantit për performancë. Komunat, Novobërdë, Zubin Potok, Leposaviq, dhe Zveçan nuk kanë raportuar për vitin 2023.
2. Komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje të gjitha të dhënave të prezantuara për raportim, në mënyrë që vlerat e fituara të paraqesin vlerësimin sa më objektiv të performancës për çdo tregues. Dokumentimi i të dhënave është kusht i domosdoshëm. Gjatë përgatitjes së të dhënave dhe informatave, komunat duhet të përgatisin dosjen për secilën fushë. Vlerësimi i komunave për vitin 2023 është bërë dhe është bazuar në dokumentin e rishikuar të SMPK-së.
3. Procesi i sigurimit të cilësisë ka evidentuar një numër të të dhënave të pasakta, të cilat në shumë raste janë shpallë të pavlefshme, përveç atëherë kur është bërë dokumentimi i tyre. Cilësia e raportimit duhet të rritet në të ardhmen, ashtu që raportimi të jetë i drejtë, i saktë, objektiv dhe të paraqes gjendjen sa më reale të performancës së komunave.
4. Performanca është kategorizuar në dy grupe me tregues të cilës pasqyrojnë veprimet e komunave në funksion të qeverisjes së mirë dhe ofrimit të shërbimeve. Në kuadër të grupit të indikatorëve të qeverisjes, Shërbimet Administrative renditet e para, megjithëse treguesi për pasqyrimin e rezultateve të konsultimeve publike duhet të trajtohet seriozisht nga autoritetet lokale. 26.08% e komunave kanë filluar me hartimin e këtyre raporteve, por edhe mbetet i ulët ky tregues të realizohet. Raportet e proceseve të konsultimeve publike duhet të përpilohen dhe të publikohen në platformën qeveritare të konsultimeve publike, me qëllim për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në politikë bërje dhe marrjen e opinionit të tyre për çështje publike.
5. Prezenca e qytetarëve në konsultimet publike ka vazhduar të jetë e ulët. Komunat duhet të shfrytëzojnë teknika dhe mjete efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrësit, me fjalë tjera komuant duhet të marrin më shumë parasysh kërkesat e qytetarëve dhe që kjo të shërbejë si rritje e besimit të qytetarëve në raport me komunat.
6. Performancë e ulët është treguar në fushën e përfaqësimit gjinor edhe në vitin 2023. Komunat duhet të ndërmarrin veprime për ta rritur numrin e grave në pozita vendimmarrëse, politike dhe në këshillat lokale. Po ashtu, duhet të përmirësohen dokumentet planifikuese dhe financiare duke marrë për bazë elementin gjinor.
7. Një pjesë e komunave kanë filluar aplikimin online të shërbimeve administrative, performanca në këtë segment duhet të përmirësohet, për të ngritur efikasitetin në shërbime dhe me kosto sa më të ulët. Këto shërbime duhet të aplikohen në të gjitha komunat dhe për numër më të madh të shërbimeve, përfshirë aplikimin online për leje ndërtimore, leje mjedisore, pagesat e tatimit në pronë, apo faturat për shërbime komunale etj.

5 Komunat: Novobërdë, Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan..

8. Të dhënat për barazinë në punësim dhe shërbimet sociale tregojnë se drejtoritë komunale duhet të bëjnë përpjekje për përfshirje të të gjitha kategorive në nevojë në politikat e punësimit. Gjithashtu efikasiteti duhet të rritet në vlerësimin e familjeve në banim social, në mënyrë që të objektet e banimit social të shfrytëzohen nga familjet në nevojë dhe të ketë shqyrtim të plotë të kërkesave të parashtruara;
9. Planifikimi hapësinor kërkon trajtim më të gjerë për të rregulluar të gjithë sipërfaqet e nevojshme me plane rregulluese të hollësishme ose me harta zonale. Të dhënat flasin për një shkallë mjaft të ulët të këtyre planeve të cilat janë tejet të rëndësishme për rregullimin e komunës;
10. Infrastruktura rrugore duhet të kompletohet, si në aspektin e asfaltimit të rrugëve, ashtu edhe me infrastrukturë përcjellëse përfshirë trotuare dhe ndriçim publik. Komunitat duhet të rrisin cilësinë e të dhënave për nivelin e asfaltimit të rrugëve, trotualet, ndriçimin e tyre, e sidomos tek të dhënat për shtigjet e biçiklistëve. Po ashtu, nevojitet planifikim më i mirë në mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, në mënyrë që shtrirja me këtë shërbim të jetë e plotë.
11. 7.38% e të dhënave për shtigje të biçikletave në zonat urbane, është vlerë që tregon se komunitat duhet të punojnë në avancimin e infrastrukturës rrugore përmes krijimit të shtigjeve të biçikletave.
12. Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunitat duhet të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kriterëve ligjorë. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy gjinitë. Kërket promovim më i madh i politikave gjinore në këshillat e lokale. Komunitat duhet të të hartojnë planet për barazi gjinore. Po ashtu kriteri i barazisë gjinore duhet të forcohet edhe në kuadër të pozitave të emëruara politike, si dhe të promovohet e drejta për regjistrimin e pronësisë në të dy gjinitë e cila qëndron në vlerë mjaft të ulët.
13. Komunitat duhet të fillojnë të investojnë në çerdhe/kopshte në zona rurale ku ka nevojë, për shkak të rëndësisë së këtyre institucioneve në zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
14. Drejtoritë komunale të arsimit duhet të planifikojnë që shkollat të plotësojnë kushtet e infrastrukturës përcjellëse, masat e energjisë efikase, si dhe të jenë të pajisura me kabinate me internet në masë më të madhe. Krijimi i hapësirave shkollore sidomos në zonat urbane kërkon trajtim të veçantë për të eliminuar mësimin në më shumë turne dhe aplikimin e mësimi gjithë-ditor. Edhe në fushën e arsimit, është e domosdoshme të rritet cilësia e raportimit dhe saktësisë së të dhënave.
15. Planifikimi formal për zhvillim ekonomik lokal duhet të zgjerohet në komuna. Komunitat duhet të hartojnë Planet për Zhvillim Ekonomik Lokal. Raportimi për realizimin e planeve të tilla duhet të jetë temë e diskutimit në kuvendet komunale, në mënyrë që të aktivitetet në këtë fushë të gjejnë zbatim më të lehtë dhe të renditen sipas kërkesave të shumicës.
16. Duhet të inkurajohen komunitat që të resepektohen rregullat ligjore, për ta ngritur cilësinë e raportimit dhe ngritjen e cilësisë së referencimit sa i përket dokumenteve adekuate për çështje të caktura.
17. Duhet tu bëhet me dije të gjitha komunave të Republikës së Kosovës se, përfromanca si instrument përveç që është mundësi për marrje të fondeve, është edhe obligim ligjor që të aplikohet raportimi i plotë për të gjithë treguesit.
18. Komunitat duhet të kenë parasysh hartimin e raporteve dhe dokumenteve ashtu qysh kërket me ligjet në fuqi dhe specifikisht për nevojat e raportimit në SMPK.

Shtojcë: % e treguesve sipas fushave

SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	87.62
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	84.79
	1.1.3	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	67.58
TRANSPARENCA KOMUNALE	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	72.15
	2.1.2	Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët	77.44
	2.1.3	Përmbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	80.59
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës	86.11
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës	81.64
	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	65.29
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	67.60
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	55.88
	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	26.08
	3.1.4	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	40.69
	3.1.5	Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxheti me pjesëmarrje	84.21
	3.1.6	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	28.91
	3.1.7	Funksionimi i këshillave lokal	19.36
	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	75.29
	3.2.2	Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	72.79
	3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal	60.29
	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	69.20
	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	89.50
	3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	73.94

	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	46.05
	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	52.94
	3.4.2	Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	93.87
BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	26.88
	4.1.2	Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale	44.31
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social	43.32
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	73.71
KULTURË, RINI DHE SPORT	5.1.1	Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve	67.58
	5.2.1	Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	57.82
MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent	59.68
	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	78.91
PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore të komunës.	50.72
	7.2.1	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	92.68
	7.2.2	Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit	77.49
HAPËSIRAT PUBLIKE	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në m2 publike për kokë banori	26.15
	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	62.78
	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	65.84
INFRASTRUKTURA RRUGORE	9.1.1	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	47.38
	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	41.45
	9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	28.43
	9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	48.69
	9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	54.73
	9.3.1	Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	9.24

	9.3.2	Rrugë lokale të riasfaltuara	61.38
TRANSPORTI PUBLIK	10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit)	12.54
	10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	65.23
	10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	63.01
SHËRBIMET PUBLIKE	11.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	35.29
	11.1.2	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	49.12
	11.1.3	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	41.92
	11.1.4	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	88.04
	11.1.5	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	75.87
MBROJTJA E MJEDISIT	12.1.1	Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis	48.69
	12.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	45.47
	12.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	63.52
PËRFAQËSIMI GJINOR	13.1.1	Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale	78.20
	13.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	47.23
	13.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	39.13
	13.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	91.18
	13.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	6.00
	13.2.1	Buxheti dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor	69.12
	13.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	28.76
	13.2.3	Pjesëmarrja e grave në konsultime publike	54.73
	13.2.4	Plani komunal për barazi gjinore	47.06
	13.3.1	Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve	9.97
	13.3.2	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	23.47

ARSIMI PARAUNIVERSITAR	14.1.1	Shkolla me masa të efçencë së energjisë	34.88
	14.1.2	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	49.21
	14.1.3	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	64.38
	14.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës	41.01
	14.3.1	Fëmijë që vijnë kopshtin - përgjithësi dhe rural	14.22
	14.3.2	Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta	48.42
	14.3.3	Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë)	61.72
	14.3.4	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	75.72
	14.3.5	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	79.09
KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR	15.1.1	Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	65.17
	15.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	73.96
	15.2.2	Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit	74.62
	15.3.1	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	58.82
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL	16.1.1	Strategjia për zhvillim ekonomik lokal	25.47
	16.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	82.35
	16.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	71.97
	16.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	47.23



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.08.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. Prot. 02/4547/24 i datës 01.08.2024 dhe i jepet **pëlqimi** për ndarjen e mjeteve financiare, në shumën prej 10,000.00 (dhjetë mijë euro), Shoqatës Zona e Pashtrikut.
2. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi jepet për arsye të mbështetjes financiare për realizimin e projektit për ngritjen e shtatores së dëshmorit të atdheut, Tahir Sinani, në qytetin e Prizrenit, i cili ka kontribuar në organizimin e njësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në operacionet luftarake të njësive të UÇK-së, në rrugën e gjatë të përgatitjes për rezistencë të armatosur, ku roli i tij për të përgatitur njësitet për ideal dhe dashuri ndaj atdheut është vlerësuar nga bashkëluftëtarët, nga ushtarakët dhe oficerët e tjerë që iu bashkëngjiten luftës për çlirimin e Kosovës. Tahir Sinani, si një oficer aktiv i Ushtrisë së Republikës së Shqipërisë, mori pjesë drejtpërdrejt në luftën për çlirimin e pjesës së pushtuar të atdheut, duke udhëhequr njësi të ndryshme, për t'u dëshmuar si njëri nga komandantët e shquar të UÇK-së, po ashtu, u bë pjesë edhe në luftën për çlirimin e Kosovës Lindore (UÇPMB), në vitin 2000, si dhe në luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, në vitin 2001.
3. Ndarja e mjeteve financiare do të bëhet nga mjeteve do të bëhet nga kodi i subvencioneve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC


01-Nr. ____/24
Më datë: 23.08.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13, nenit 17, shkronja s) dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), nenit 74, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika 2.9 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, si dhe nenit 4, paragrafi 5 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, Nr. 1427, të datës 28.4.2017 dhe kërkesës me Nr. Prot. 2069, të datës 4.7.2024, kryetari i Komunës, u:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro) Shoqatës “Zona e Pashtrikut”.
2. Shuma e cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jepet për arsye të mbështetjes financiare për realizimin e projektit për ngritjen e shtatores së dëshmorit të atdheut, Tahir Sinani, në qytetin e Prizrenit, i cili ka kontribuar në organizimin e njësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në operacionet luftarake të njësive të UÇK-së, në rrugën e gjatë të përgatitjes për rezistencë të armatosur, ku roli i tij për të përgatitur njësitet për ideal dhe dashuri ndaj atdheut është vlerësuar nga bashkëluftëtarët, nga ushtarakët dhe oficerët e tjerë që iu bashkëngjiten luftës për çlirimin e Kosovës. Tahir Sinani, si një oficer aktiv i Ushtrisë së Republikës së Shqipërisë, mori pjesë drejtpërdrejt në luftën për çlirimin e pjesës së pushtuar të atdheut, duke udhëhequr njësi të ndryshme, për t’u dëshmuar si njëri nga komandantët e shquar të UÇK-së, po ashtu, u bë pjesë edhe në luftën për çlirimin e Kosovës Lindore (UÇPMB), në vitin 2000, si dhe në luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, në vitin 2001.
3. Propozimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me propozim të njoftohen:

1. *Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,*
2. *Sekretaria e Kuvendit, dhe*
3. *Arkivi.*



**Kryetarit të Komunës
Asamblesë Komunale të Komunës
në Rahovec**

K Ë R K E S Ë

Ne, Grupi vullnetar i punës për realizimin e projektit për ngritjen e shtatores së dëshmorit të atdheut Tahir Sinani, parashtrojmë pranë kësaj Komune kërkesën si vijon:

Tahir Sinani lindur më 25 maj 1964 në fshatin Gri, afër Bujanit, rrethi i Tropojës në Shqipëri dhe ra dëshmor në frontin e luftës në radhët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare më 29 korrik 2001, në vendin e quajtur "Zabeli i Kukulit" afër qytetit të Gostivarit, në Maqedoni.

Ishte oficer i ushtrisë së Shqipërisë dhe një nga komandantët e shquar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili mori pjesë në Luftën e Kosovës, në Luftën e Kosovës Lindore dhe në Luftën Çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni në vitin 2001.

Më 24 maj të vitit 2002, trupi i dëshmorit Tahir Sinani varroset në Varrezat e Dëshmorëve në Landovicë të Prizrenit ku përjetësisht pushon së bashku me dëshmorët e tjerë të kombit.

Vlerësuar si një luftëtar me vlera dhe me kontribute të veçanta në çështjen kombëtare dhe në luftën e drejtpërdrejtë kundër pushtuesve të trojeve shqiptare, është vlerësuar me vend që të ketë edhe një mjedis me emrin e tij dhe një shtatore të tij pranë atij mjedisi.

Tahir Sinani është vlerësuar nga bashkëluftëtarët për kontributin e madh në organizimin e njësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në trajnimin e luftëtarëve, në planëzimin e luftimeve dhe në realizimin me sukses të detyrave luftarake. Ka gëzuar nderimin dhe respektin e gjithë hierarkisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, prandaj edhe gjatë luftës ka udhëhequr njësi të ndryshme, si dhe me përfundimin e luftës merr detyrën e komandantit të Zonës së Pashtrikut me qendër në Prizren.

Pikërisht për këtë edhe mendimi dhe propozimi i grupit të punës për udhëheqjen e veprimtarisë për jetësimin e nderimit për këtë figurë të madhe luftëtar të kombit, është kërkuar që shtatorja e Tahir Sinanit të ngrihet në qytetin e Prizrenit.

Për këtë ne kemi kërkuar nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Prizren, të miratojë këtë projekt duke përcaktuar si mjedis të përshtatshëm, Parkun e qytetit të Prizrenit.

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Prizren, ka miratuar këtë projekt dhe i ka bërë kërkesë Kryetarit të Komunës Asamblesë Komunale të Komunës në Prizren, prej ku nga Institucionet e Komunës është miratuar projekti dhe është dhënë leja për të shtatoren e dëshmorit.

Në plotësimin e këtij projekti ne, grupi i punës për realizimin e tij, kemi planifikuar që për figurën e dëshmorit të atdheut Tahir Sinani të mbahet edhe një konferencë shkencore.

Emërtimi dhe tezat mbi të cilat mendojmë se mund të ndërtohen kjo konferencë shkencore, vlerësojmë se mund të paraqiten si më poshtë:

Titulli i Konferencës mund të jetë:

Veprimtaria ushtarake dhe luftarake e Tahir Sinanit në shërbim të atdheut e kombit

Disa nga tezat mbi të cilat do të mbështeten përpiluesit mund të jenë:

- **Ushtria Çlirimtare e Kosovës në historinë kombëtare shqiptare,**
- **Ndikimi i fillimit të Luftës Çlirimtare në Kosovë në viset e Republikës së Shqipërisë,**
- **Tahir Sinani si figurë përbashkuese e idealeve të shqiptarëve për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare,**
- **Tahir Sinani – figurë e ushtarakut model në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës,**
- **Trajnimi i njësive të UÇK-së dhe roli i Tahir Sinanit në këtë veprimtari,**
- **Tahir Sinani** njeriu që dha çdo gjë për çlirimin e trojeve të pushtuara të atdheut tonë,
- Operacionet luftarake të njësive të UÇK-së dhe Tahir Sinani,
- Vlerat e figurës së Tahir Sinanit për historinë shqiptare,
- Tahir Sinani si vlerë kombëtare,
- për lëvizjen tonë çlirimtare shqiptare në tërësi,
- për rrugën e gjatë të përgatitjes për rezistencë të armatosur,
- për Luftën Çlirimtare dhe drejtimin e saj,
- për gatishmërinë e njerëzve që të sakrifikohen për idealet e dashurisë ndaj atdheut, pa të cilat jeta jonë nuk do të kishte ecje vertikale,
- Vlerat e kuadrove ushtarakë për drejtimin e luftimeve të UÇK-së,
- Roli i Tahir Sinanit në edukimin atdhetar,
- Shfrytëzimi i përvojave në luftën e UÇK-së,
- Mbi metodën e punës së Tahir Sinanit në komunikim me luftëtarët, vartësit dhe eprorët, si dhe gjatë zbatimit të planeve e detyrave,
- Tahir Sinani dhe vendlindja e tij etj.

Shënim: Këto teza nuk janë detyruese për pjesëmarrësit, por janë orientuese, gjithsecili që merr përsipër të përgatisë një kumtesë për këtë figurë ose edhe për çështje që lidhen me të, mund të përzgjedhë vetë sipas mendimit dhe idesë që ka.

Duke besuar se ngritja e shtatores së dëshmorit është një akt nderimi që mund e duhet të bëhet për dëshmorin, kemi besimin e plotë se për realizimin e këtij projekti kemi bindjen se do të kemi mbështetje nga të gjithë institucionet shtetërore e organizatat shoqërore.

Prandaj ju drejtohem me këtë kërkesë, për të ju lutur që të na mbështetni me ndihmë financiare për realizimin e këtij projekti.

Sasia e mbështetjes financiare nga institucioni juaj do të jetë sipas mundësive që keni.

Shpenzimi i burimeve do të bëhet sipas ligjeve dhe në mënyrë plotësisht transparente.

Duke qëndruar në pritje të një përgjigje mbështetëse nga ana e atij Institucioni, me shumë nderim e konsideratë të lartë,

Grupi i punës për udhëheqjen e realizimit të projektit

1. Prof. Dr. Kudusi Lama – Gjeneral në pension – kryetar,
2. Gjeneral Selim Abdyl Krasniqi – Zv/kryetar,
3. *ACUSH SHALA* – anëtar,
4. *SKENDER V. HOTI* – anëtar,
5. *Bekim Morina* – anëtar,
6. *Fetoh Bekolli* – anëtar,
7. *BEQE BERISHA* – anëtar,
8. *Shemsi Krasniqi* – anëtar,
9. – anëtar,
10. – anëtar,
11. – anëtar,

[Handwritten signatures of group members]

Prizren, më 20.03.2024



Shoqata Zona e Pashtrikut

PriBank

Nr. I llogarisë 2440130500003932



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8, paragrafi 1, pika 1.2 dhe nenit 14, paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.08.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë

1. **Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës, Nr. 02/4554/24, i datës 05.08.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë personit juridik-Drejtorisë për Arsim, për ushtrimin e veprimtarisë arsimore, respektivisht për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekura në pikën 1, të këtij propozimi janë:
2.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02680-1, në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur *Kraishta*, me kulturë kullosë e klasës V, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5259 m² (pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
2.2. Pjesa e parcelës P-71510057-02680-1, në sipërfaqe prej 2227 m², planifikohet të bëhet parcelimi - të ndahet dhe në këtë pjesë të parcelës të ndërmerren veprimet ndërtimore për ndërtimin e çerdhes.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është përmirësimi i infrastrukturës - ndërtimi i objektit të çerdhes së fëmijëve për zhvillimin e aktiviteteve edukativo-arsimore për fëmijët e komunës së Rahovecit.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatgjatë.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020, për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
7. Obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënie të pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënie të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/24
Me datë: 23.08.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4554 Nr. i faq./Br.str./No.pg 159

Data/Datum/Date 05/8/24

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, u:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, personit juridik – Drejtorisë për Arsim, për ushtrimin e veprimtarisë arsimore, respektivisht për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve.
2. Prona e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim, sipas pikës 1 të këtij propozimi, është:
 - 2.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02680-1, në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur *Kraishta*, me kulturë kullosë e klasës V, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5259 m² (pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
 - 2.2. Pjesa e parcelës P-71510057-02680-1 në sipërfaqe prej 2227 m², planifikohet të bëhet parcelimi – të ndahet dhe në këtë pjesë të parcelës të ndërmerren veprimet ndërtimore për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve.
3. **Qëllimi** është përmirësimi i infrastrukturës - ndërtimi i objektit të çerdhes së fëmijëve për zhvillimin e aktivitetit edukativo-arsimor për fëmijët e Komunës së Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij propozimi kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Me propozim të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit,
- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, dhe
- Arkivi.



Smajl Latifi

Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510057-02680-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0030838/24
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	05.08.2024 - 11:36
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Rahovec / Orahovac / Rahovec
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510057-02680-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	5259	Nr.919-2022RfP, m.141-2022	23.09.2022	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
KRAJISHTA			23.09.2022	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Bujqësore/Pojtoprivredno/Agriculture	Kullosat/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 5/Pasnjak 5 Klase/5th Class Pasture	5259

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Druzina / Single possessor	Komuna e Rahovecit	600535233	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC /		DËSHMORËT E PASHTRIKUT	1/1		27.09.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rahovec

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510057-02680-1	Parcelë / Parcela / Parcel	5259



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1578

Punoi/Obradio/Created: Albina Durguti

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 05.08.2024

Koha/ Vreme/ Time: 11:36:48




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë

Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu


Department of Cadastre



Skica e terrenit

Z.K. Rahovec

P/1:1000



Rahovec me 05.08.2024

Miftar Krasniqi gjeom.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6, paragrafi 1, pika 1.2, nenit 8, paragrafi 1, pika 1.2 dhe nenit 14, paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 23.08.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë

1. **Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës Nr. 02/4595/24, i datës 13.08.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë deri në 40 (dyzet) vjet.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Gradish, me kulturë: kullosë e klasës së 5-të, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P -71510033-00772-10, në sipërfaqe prej 2350m² (dy mijë e treqind e pesëdhjetë metra katror), e cila merret nga sipërfaqja e përgjithshme prej 20000 m² (njëzet mijë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është destinimi prodhim tretësor - shërbimi kulturor, argëtues dhe rekreativ.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatgjatë në periudhën prej 40 (dyzet) vjet.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020, për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
7. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për

dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

8. Obligohet kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit e pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/24
Me datë: 23.08.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6, paragrafi 1, pika 1.1 dhe nenit 8, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5, paragrafi 1, pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 00.00.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës Nr. 02/4541/24, i datës 31.07.2024 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur *Krajishte*, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P - 71510057-05058-0, në sipërfaqe prej 1276m² (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim, i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë, si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim, cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej ____ (_____) vjet.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020, për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, t'i përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/24
Me datë: 23.08.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 00.00.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim, **formohet** komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë deri në 40 (dyzet) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, 01 Nr. 000/24, i datës 23.08.2024, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510033-00772-10.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.2. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.3. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.4. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.5. _____, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë deri në 40 (dyzet) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
5. Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.

6. Administrata e Komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdoherë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të komisionit ad hoc,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.____/24
Datë:23.08.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.08.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 0000/24, i datës 23.08.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P -71510057-05058-0.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.2. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.4. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.5. _____, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, të pronës së paluajtshme të komunës, janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdoherë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr. ____/24
Datë: 23.08.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit